



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 218 Akti

Nr. 281 Vendimi
Tiranë, më 27.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Brunilda Bektoshi	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në datën 23.7.2020, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Blerona Hasa**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektoshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i

rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 15.11.2018, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.11.2018, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit znj. Blerona Hasa, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin z. Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 24.4.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë, deklaroi përmes postës elektronike marrjen dijeni për njoftimin dhe trupin gjykues dhe në datë 15.10.2019, deklaroi dhe mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 18.5.2020 Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Po në datën 18.5.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën brenda 10 (dhjetë) ditëve, i përlllogaritur, nga dita e nesërme të heqjes së

pezullimit apo e përfundimit të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, përcaktuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”. Në zbatim të Aktit Normativ, nr. 21, miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 27.5.2020, i publikuar në fletoren zyrtare, nr. 98, datë 29.5.2020, për disa ndryshime në Aktin Normativ nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, në datën 29.5.2020, subjekti u njoftua se afati brenda të cilit duhet të paraqiste shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit, ishte data 11.6.2020, si dhe në vijim do të njoftohej për datën dhe orën e seancës dëgjimore, duke respektuar masat mbrojtëse nga COVID-19, të miratuara sipas udhëzimeve të autoriteteve përkatëse shtetërore. Po në këtë datë subjekti i rivlerësimit dërgoi prapësimet/observacionet në mënyrë elektronike.

8. Në datën 2.6.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, për shkaqe të paraqitjes së disa rrethanave/indicieve të reja vendosi rihapjen e hetimit, duke e njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi këtë vendim në datën 29.6.2020.

9. Në datën 8.7.2020, Komisioni, me vendimin nr. 4, vendosi mbylljen e hetimit dhe në të njëjtën datë njoftoi subjektin e rivlerësimit: (i) mbi rezultatet e hetimit administrativ pas rihapjes së hetimit; (ii) të drejtën për të paraqitur, pretendimet brenda datës 14.07.2020; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative. Brenda afatit të përcaktuar¹ nga Komisioni subjekti i rivlerësimit më anë të postës elektronike dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ pas rihapjes.

10. Në datën 17.7.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 5, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 23.7.2020, në orën 14:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerona Hasa. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 23.7.2020, për të rifilluar në datën 27.7.2020, për shpalljen e vendimit.

¹ E-mail i datës 14.7.2020, përmes adresës ****@gmail.com konfirmuar nga subjekti për shkaqe teknike të postës elektronike, saktësuar nga Komisioni dhe subjekti që në momentin e konstatimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Blerona Hasa ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe kreun IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja, është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/20176 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja, me raportin nr. (***), datë 12.1.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, e cila është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2003, me nr. (***) indeksi, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2003 – 2016 dhe në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrative; si dhe (dh) argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 25.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi ka rezultuar, si vijon:

1. Në lidhje me pasurinë apartament banimi, pasuritë numër (***) (apartament me sip. 94 m²) dhe nr. (***) (apartament me sip. 187 m²), z. k (***), me adresë: Lagja nr. (***), Rr. “(***)”, Durrës (sot Rr. “(***)”), në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Këto pasuri janë kati i 3-të dhe papafingo banesë private 3-katëshe dhe papafingo, për të cilën vjehri im, z. I. Sh., është pajisur me lejen e ndërtimit nr. (***) datë 26.2.1998, të KRRT-së, Durrës – me qëllim përfundimin e objektit të nisur, nga ana ime dhe b/shortit janë marrë fillimisht dy kredi nga NBG-ja nr. (***) datë 30.3.2007, në vlerën 30.000 euro dhe nr. (***) datë 5.7.2007, në vlerën 10.000 euro – kryesisht me këto para u bë përfundimi i ndërtimit të këtyre pasurive dhe përshtatja për banim e pasurive nr. (***) (papafingo) në dhjetor të vitit 2007 – me vendimin nr. (***) datë 22.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, bashkëshorti im u njoh pronar i këtyre pasurive. Në bazë të tij u bë regjistrimi i tyre në ZVRPP-në Durrës, datë 24.3.2011, me numër hipotekor (***) dhe numër (***) – më pas në datën 22.1.2013 u lëshuan certifikata e pronësisë përkatëse – me qëllim përshtatjen për banim të pasurisë nr. (***) datë 3.6.2016 është marrë prej nesh kredi tek ‘Alpha Bank’, në vlerën 59.000 euro. Me një pjesë të saj u bë shlyerja e kredive të marra në NBG dhe pjesa tjetër prej rreth 30.000 euro u përdor për përshtatje banimi, të kësaj pasurie.” Rezulton se në mbështetje të deklaratimit subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.*

³Kontratë shitje nr. (***) datë 25.7.1997; leje ndërtimi KRRT-ja Durrës, nr. (***) datë 26.2.1998; procesverbal datë 14.4.1999; vendim nr. (***) datë 22.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Durrës; vërtetim hipotekor nr. (***) datë 24.3.2011; vërtetim hipotekor nr. (***) datë 24.3.2011; certifikatë pronësie nr. (***) në emër të L. Sh., për apartamentin me sip. 187 m²,

1.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjet e ZVRPP-së Durrës dhe të NBG-së.*

Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit

1.2 Komisionit, nga hetimi administrativ, i ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2010 me përshkrimin “*banesë private nr. (***) z. k. (***), me adresë: lagjja. (***), Rr. ‘(***) Durrës’*”. Kjo pasuri përbëhet nga tre kate + bodrum + papafingo, hipotekuar në datën 17.9.2010 në emër të vjehrrit, I. Sh. . Me vendim nr. (***) datë 22.2.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka njohur pronar bashkëshortin e subjektit L. Sh. mbi një pjesë të kësaj pasurie, kati i tretë + papafingo (vendim ende i paregjistruar në ZVRPP), pasuri e ndërtuar me të ardhurat e përfituara nga dy kreditë e marra në NBG në vlerën totale 40.000 euro.

1.3 Po periodikisht, në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “*Pasuria nr. (***) z. k. (***) me sip. 187 m², me adresë: lagjja (***) Rr. ‘(***) apartament nr. (***) k. (***) shk. 1, sipas vërtetimit hipotekor datë 7.4.2011 të ZVRPP-së Durrës, është riregjistruar në regjistrat hipotekorë me nr. (***) datë 24.3.2011; pasuria nr. (***) z. k. (***) me sip. 94 m², me adresë: lagjja (***) Rr. ‘(***)’ apartament nr. (***) k. (***) (papafingo), sipas vërtetimit hipotekor, datë 7.4.2011, të ZVRPP-së Durrës, është riregjistruar në regjistrat hipotekore me nr. (***) datë 24.3.2011. Këto dy pasuri bashkëshortore kanë qenë të regjistruara në emër të vjehrrit I. Sh. dhe në bazë të vendimit nr. (***) datë 22.02.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës janë riregjistruar në emër të bashkëshortit L. Sh. . Këto dy pasuri janë ndërtuar mbi bazën e dy kredive në vlerën 40.000 euro, marrë prej meje deklarueses dhe bashkëshortit tim në NBG në vitin 2007”*.”

1.4 Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti ka deklaruar pasuritë me përshkrimet specifike: “*Pasuria nr. (***) z. k. (***) h. (***) ap. (***) me sip. 94 m², me adresë: lagjja (***) Rr. ‘(***)’*”. Certifikatë pronësie, datë 22.1.2013, të ZVRPP-së Durrës; pasuria nr. (***) z. k. (***) h. (***) ap. (***) me sip. 187 m², me adresë: lagjja (***) Rr. ‘(***)’”. Certifikatë pronësie, datë 22.1.2013, e ZVRPP-së Durrës.”

Nga korrespondenca e mbajtur me institucionet publike dhe verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje ka rezultuar, si vijon:

1.5 ZVRPP-ja Durrës⁴ ka konfirmuar faktin se pasuritë nr. (***) z. k. (***) h. (***) ap. (***) sip. 94 m², me adresë: lagjja (***) Rr. ‘(***)’ Durrës dhe nr. (***) z. k. (***) h. (***) ap. 2, sip. 187 m², me adresë: lagjja (***) Rr. ‘(***)’ Durrës, janë të regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit, z. L. Sh. .

1.6 Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike⁵ (OSHEE), ka informuar Komisionin se me gjeneralitetet L.Sh. identifikohen dy abonentë në instancën e Durrësit, përkatësisht me nr.

ap. 2, adresa: lagjja ***, Rr. ‘(***)’ Durrës; certifikatë pronësie nr. (***) kontratë kredie me NBG-në nr. (***) datë 30.3.2007; kontratë kredie me NBG-në nr. (***) datë 5.7.2007; kontratë huaje me “Alpha Bank”, me nr. (***) datë 3.6.2016; kontratë hipoteke nr. (***) datë 3.6.2016; nxjerrje llogarie në “Alpha Bank”, datë 8.6.2016; fatura tatimore për shpenzimet e kryera në banesë, të gjitha në total kapin vlerën prej rreth 2.762.720 lekësh + 4.573 euro (referojuni Aneksit nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴Aneks 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 7.5.2019.

kontratë (***) , me datë hapje 19.9.2007, me adresë Rr. “(***)” dhe nr. kontratë (***) , me datë hapje 19.9.2007, adresa Rr. “(***)”. Po ashtu, në komunikimin elektronik⁶ me subjektin për qartësimin e kontratave, subjekti ka depozituar dy librezat e energjisë elektrike në emër të bashkëshortit, nga verifikimi i të cilave konstatohet se librezat pasqyrojnë të njëjtat numra kontrate dhe njëkohësisht pagesat e kryera prej vitit 2013 e në vijim.

1.6.1 Në kushtet që Ujësjetillës Kanalizime Tiranë (UKT) në korrespondencën e mbajtur me Komisionin nuk konfirmoi kontratë të regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit⁷, pas kërkesës së Komisionit, përmes komunikimit elektronik⁸ depozitoi librezën me nr. (***) , lëshuar në emër të babait të bashkëshortit të subjektit, z. I. Sh. .

1.7 Komisioni, për qartësimin e fakteve dhe verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve, i kërkoi shpjegime subjektit⁹ lidhur me kohën e ndërtimit të këtyre dy pasurive dhe kohën kur ishin bërë funksionale për të banuar, për të cilat subjekti paraqiti dokumentacion dhe deklaroi se:

1.7.i Në datën 25.7.1997, vjehri i subjektit, shtetasi I. Sh., kishte nënshkruar kontratën¹⁰ e shitjes nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 25.7.1997, me palë shitëse shtetasit S. N., H. Q., M. D., M. D., I. B. dhe L. B., si dhe palë blerëse I. Sh., me objekt shitblerje të një sipërfaqe trualli prej 170 m², me vendndodhje lagjja (***) , Rr. “(***)”, Durrës, në vlerën 1.360.000 lekë. Me vendimin nr. (***) , datë 26.2.1998, të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit Durrës, ishte miratuar leja e ndërtimit të objektit banesë 3-katëshe, sipas sheshit të miratuar me vendim nr. (***) , datë 24.11.1997, të KRRT-së. Objekti kishte përfunduar së ndërtuari si karabina, në vitin 1999, konfirmuar kjo me procesverbal datë 14.4.1999 të Seksionit të Urbanistikës të Këshillit të Rrethit Durrës. Subjekti ka sqaruar: *“Kati i parë dhe kati i dytë, kanë përfunduar dhe kanë qenë funksional, në vitin 2000, ku kanë banuar bashkëshorti, dy prindërit dhe motra e tij. Në dhjetor të vitit 2000, kishte nisur bashkëjetesa martesore mes saj dhe bashkëshortit, në të njëjtën banesë. Kati i tretë i banimit dhe papafingo, u lanë në fazën karabina. Unë dhe bashkëshorti, (vijon të deklarojë subjekti), me qellim vënien në funksionim të katit të tretë dhe papafingos, kemi marrë kredi nga ‘Banka Kombëtare e Greqisë’ Durrës, fakt i konfirmuar me dy kontratat e vitit 2007, në shumën e përgjithshme 40.000 euro. Në nëntor të vitit 2007 përfundoi si ambient i përshtatshëm për banim, vetëm papafingo, ku kemi nisur të banojmë unë, bashkëshorti dhe fëmija ynë i parë, më pas edhe fëmija i dytë. Kati i tretë kaloi nga faza karabina, në objekt të përfunduar, por të pabanueshëm, për shkak se nuk u mobilua”*. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar¹¹ se objekti i identifikuar në deklaratën periodike të vitit 2010 dhe në pyetësorit nr. 2, datë 31.1.2020 (banesë 3-katëshe + bodrum + papafingo), për herë të parë është hipotekuar në shtator të vitit 2010, fakt i konfirmuar me vërtetimin hipotekor, datë 17.9.2010, lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës. Po ashtu, ka sqaruar se i është referuar këtij dokumenti hipotekor në deklaratimet e saj të vazhdueshme. Subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin hipotekor lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës, në datën 17.9.2010.

⁶Referojuni e-mail-it të datës 5.3.2020.

⁷Me e-mail të datës 3.3.2020.

⁸Me e-mail datë 5.3.2020.

⁹Pyetësor nr. 2, datë 31.1.2020.

¹⁰Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së dhe pyetësor nr. 2, datë 31.1.2020.

¹¹Referuar përgjigjeve të dhëna në mënyrë elektronike në datën 7.4.2020, pas dërgimit të pyetësorit datë 26.3.2020.

1.8 Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se Këshilli i Qarkut Durrës, Drejtoria e Administrimit Mbrojtjes së Territorit dhe Urbanistikës (në vijim DAMTU), me vendimin nr. (***) , datë 28.5.2010, ka miratuar lejen e shfrytëzimit të objektit “banesë individuale 3-katëshe”. Në lejen e shfrytëzimit, ndër të tjera, citohet se: “*Këshilli Teknik, në mbështetje të aktkollaudimit, vendosi të lejojë shfrytëzimin e objektit ndërtimor banesë individuale 3-katëshe*”. Gjithashtu, me shkresën nr(***)prot., datë 29.7.2010, DAMTU-ja e Këshillit të Qarkut Durrës, ka konfirmuar zyrtarisht për ZVRPP-në Durrës, përfundimin e punimeve të ndërtimit “*banesë individuale 3-katëshe*” në lagjen nr. (***) , Durrës, me investitor z. I. Sh. .

1.9 Me vendimin nr. (***) , datë 22.2.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka miratuar pajtimin ndërmjet paditësit L. Sh. (bashkëshorti i subjektit), me të paditurin I. Sh., duke i njohur bashkëshortit të subjektit/paditësit, të drejtën e pronësisë mbi katin e tretë dhe papafingon e pasurisë nr. (***) , ndërsa vjehrrit/të paditurit të drejtën e pronësisë mbi katin e parë, të dytë dhe bodrumin e pasurisë nr. (***) , z. k. (***) , Durrës, së bashku me truallin nën të, me sip. 170 m².

1.10 Në bazë të vendimit gjyqësor, ZVRPP-ja Durrës, ka regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit, pasuritë nr. (***) me sip. 187 m² (kati i tretë), për të cilën është lëshuar certifikatë pronësie, datë 22.1.2013, nga ZVRPP-ja Durrës dhe nr. (***) me sip. 94 m² (papafingo) është lëshuar certifikatë pronësie në datën 22.1.2013, nga ZVRPP-ja Durrës.

1.11 Komisioni i ka kërkuar gjykatës dosjen gjyqësore që i përket zhvillimit të këtij procesi gjyqësor për të verifikuar regjimin juridik të pronësisë mbi të cilin është zhvilluar procesi gjyqësor. Ndër të tjera, në dokumentacionin e administruar nga gjykata¹² gjatë procesit gjyqësor ku është zgjidhur përfundimisht pronësia e secilës palë (bashkëshorti i subjektit në cilësinë e palës paditëse dhe babai në cilësinë e palës së paditur, me objekt: “*njohjen pronar me ndërmjetësim*”, rezultoi se ishte administruar i njëjti vërtetim hipotekor i depozituar nga subjekti në shpjegimet e saj, lëshuar në datën 17.9.2010).

1.12 Rezulton se pasuria e përshkruar në vërtetimin hipotekor me sipërfaqe 170 m², në të cilën është ngritur ndërtesë 3-katëshe, bodrum dhe papafingo, me sip, ndërtimore 189 m², është regjistruar po në shtator të vitit 2010, kohë në të cilën, gjithashtu, është lëshuar vërtetimi hipotekor. Ndërkohë, referuar të dhënave të pasqyruara në vërtetimin hipotekor, rezulton të ishte regjistruar origjina e pasurisë që nënkuptonte regjistrimin e parë të truallit me nr. hipotekimi (***) , datë 23.7.1997, në emër të shitësve dhe, më tej, sipas kontratës së shitblerjes së truallit ishte bërë edhe regjistrimi i truallit në emër të babait të bashkëshortit të subjektit me nr. hipotekimi (***) , datë 25.7.1997. Në kushte të tilla, vërtetimi hipotekor, lëshuar në datën 17.9.2010, dukej se nuk konfirmonte kohën se kur është regjistruar ndërtimi i objektit.

1.13 Gjithashtu, Komisioni i kërkoi edhe ABI Bank (ish-NBG-ja) praktikën e kredisë së marrë në shumën 40.000 euro, në vitin 2007, për të verifikuar regjimin juridik të pronës në kohën e aplikimit dhe përfitimit të saj. Në praktikën e kredisë¹³ konstatohej se vërtetimi hipotekor i depozituar me qëllim përfitimin e kredisë, ishte lëshuar në datën 12.3.2007, me të njëjtat të

¹²Referuar shkresës shoqëruese të dosjes gjyqësore, nr. (***) , datë 30.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në dosjen e Komisionit.

¹³Referuar shkresës shoqëruese të praktikës së kredisë me nr. (***) prot., datë 25.3.2020, të ABI Bank.

dhëna për sa i përkiste numrave hipotekorë të regjistrimit, sikurse citohet më sipër, por pa përshkrim të banesës. Në këto rrethana, nga verifikimi i dokumentacionit të praktikës bankare, u vërejt se mund të identifikohej fakti se, ndërtimi nuk ishte regjistruar deri në mars të vitit 2007.

1.14 Nga verifikimi i akteve/dokumentacionit të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale¹⁴ e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, mbi të cilin ishte regjistruar ky objekt, Komisioni konstatoi se:

a) për këtë objekt ishte dhënë leje për sheshndërtimi për banesë 2-katëshe me garazhe në pronën e z. I. Sh., sipas sheshit të miratuar, me sip. 169 m²;

b) me vendimin nr. (***), datë 26.2.1998, KRRT-së Rrethit Durrës, ishte miratuar leja e ndërtimit për banesë individuale 3-katëshe në pronën të z. I. Sh.;

c) me procesverbalin e datës 14.9.1999 të Seksionit të Urbanistikës të Këshillit të Rrethit konfirmohej fakti se objekti 3-katësh në pronën e z. I.Sh. ishte ndërtuar si karabina;

ç) në aktverifikimin e ZVRPP-së Durrës, datë 19.3.2008, citohej se: *“në lidhje me regjistrimin e objektit tre kate karabina, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se mungon shkresa përcjellëse e dërguar nga institucioni përkatës për regjistrimin e karabinasë, gjatë kontrollit dolën probleme hartografike në bazë të udhëzimit nr. (***), datë 26.7.1994, pika 9, planvendosja dhe projekti janë të pa firmosura nga kryetari i KRRT-së dhe se për mangësitë e verifikuara nuk mund të hapen kartelat për pasuritë”*. Paraprakisht, Komisioni konstatoi se këto akte ishin depozituar në praktikën e Drejtorisë Rajonale të ASHK-së, dhe nga verifikimi i tyre vërehej se planvendosja nuk ishte miratuar nga kryetari i KRRT-së dhe seksioni i urbanistikës, dhe planimetritë/projekti i objektit i skicuar nga arkitekti pasqyrore tri kate dhe papafingo, por sikurse citohej në aktin e verifikimit, nuk ishin miratuar nga sektorët përgjegjës;

d) me shkresën nr. (***) prot., datë 6.6.2008, DAMTU-ja e Këshillit të Qarkut Durrës, i drejtohej ZVRPP-së Durrës për kryerjen e regjistrimit provizor, se ishin përfunduar punimet e karabinasë të banesës individuale 3-katëshe, me investitor I. Sh., ku pjesë përbërëse e praktikës ishin edhe vendimi i sheshit të ndërtimit, leja e ndërtimit, plani i vendosjes së objektit, si dhe procesverbali i konstatimit ku përfshiheshin aktet e kontrollit të objektit;

dh) në procesverbalin e konstatimit, datë 22.5.2008, citohej: *“nga verifikimi në vend nga grupi i specialistëve të sektorit të urbanistikës u konstatua se objekti 3 katëshe + bodrum + papafingo ka përfunduar¹⁵”* dhe po ashtu pasqyroheshin edhe funksionet e secilit kat;

e) sipas fletës së regjistrimit hipotekor pasqyrohet transkriptimi nga shitësit e truallit të blerësi z. I. Sh. në datën 25.7.1997 dhe po në këtë transkriptim citohet se mbi këtë truall ishte ndërtuar

¹⁴ Në mënyrë elektronike me e-mail datë 16.4.2020.

¹⁵ Neni 54, i ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën” i ndryshuar parashikon: *“Në lejen e ndërtimit përcaktohet detyrimi për pranimin e kontrollit të realizimit të ndërtimit nga drejtoria e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, nga seksioni i urbanistikës në qark dhe në qytetet e kategorise së parë, nga zyra e urbanistikës në bashki e komunë, të cilat duhet të njoftojnë me shkrim sekretarinë teknike të KRRT-së për çdo kontroll. Kontrolli bëhet me dokument për: - pikehimin e objektit; - përfundimin e themeleve; - përfundimin e karabinasë për të gjithë objektin; - përfundimin e sistemit të jashtëm në sheshin e ndërtimit sipas projektit. Çdo akt kontrolli depozitohet në dosjen e objektit”*.

objekt 3-katësh me bodrum dhe papafingo sipas lejes së shfrytëzimit. Po ashtu, Komisioni administroi edhe praktikën e ndërtimit të objektit 3-katësh, nga Këshilli i Qarkut Durrës¹⁶.

1.15 Në analizë të këtyre dokumenteve sipërcituar, konstatohet se në qershor të vitit 2008 nga DAMTU-ja e Këshillit të Qarkut Durrës, institucionit të ZVRPP-së, i kishte konfirmuar përfundimin e karabinasë së banesës individuale 3-katëshe, duke i kërkuar regjistrimin provizor të saj, ndërsa një muaj më parë këtij konfirmimi procesverbali konstatonte përfundimin e objektit. Ky konfirmim në referim të nenit 54 të ligjit nr. 8504/1998 (dispozitë që citohet pikërisht në këtë akt), qartësonte kontrollin mbi përfundimin e karabinasë. Nga aktet e ZVRPP-së nuk rezultonte që në vitin 2008 të ishte bërë regjistrimi provizor, ndërsa në praktikën e Këshillit të Qarkut Durrës ishte administruar regjistrimi hipotekor i karabinasë. Në këtë praktikë, vërehej se akti i kolaudimit pasqyrore ndërtimin e një banese 3-katëshe + papafingo + Bodrum, ndërsa vërtetimi hipotekor i regjistrimit të karabinasë nr(***), datë 16.6.2008, lëshuar në emër të shtetasit I. Sh., pasqyrore regjistrimin e pasurisë me përshkrimin “*banesë trekatëshe me sipërfaqe ndërtimore, kati përdhe 169 m²*”. DAMTU-ja vetëm pas dy viteve, pra, në 2010 i ka konfirmuar ZVRPP-së përfundimin e banesës individuale 3-katëshe, sipas lejes së shfrytëzimit të dalë po në këtë vit dhe sikurse u citua më sipër edhe në fletën e regjistrimit citohet se: “*Mbi truall është ngritur një objekt tre kate me papafingo dhe bodrum ...me leje shfrytëzimi.*”.

Komisioni në referim të legjislacionit¹⁷ që vepron në këtë fushë, ku parashikohen konfirmimet e përfundimit të karabinasë dhe, po ashtu, edhe të ndërtimit që duhen bërë nga institucionet përkatëse në nivel bashkie/qarku, etj., për ZVRPP-në Durrës, vërejtje që në rastin konkret këto parashikime nga institucionet përkatëse të ngarkuara me ligj ishin përmbushur përkatësisht në vitin 2008 dhe 2010. Në analizë të të gjithë deklaramëve dhe dokumentacionit të administruar, konstatohet se, ndërsa subjekti deklaroi në vitin 2010 pasurinë më përshkrim 3-katësh + bodrum + papafingo, hipotekuar në datën 17.9.2010 në emër të vjehrrit të subjektit, z. I. Sh., dokumentacioni tërësor që i përket lejes së ndërtimit prej vitit 1998 dhe gjithë veprimeve të

¹⁶ Shkresë nr. (***) prot., datë 24.4.2020, në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Neni 12/1 Autoriteti përkatës i planifikimit dërgon zyrtarisht në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme: (a) kërkesën për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe ose lejen e zhvillimit të lëshuar nga autoriteti përkatës i planifikimit, brenda 10 ditëve nga data e pajisjes së investitorit ose pronarit me këtë leje; (b) kërkesën për *regjistrimin e përkohshëm të karabinasë në fazën e përfundimit të saj, brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të certifikatës përkatëse*. “Regjistrimi” është regjistrimi deri në përfundim të ndërtimit të objektit, i cili është i vlefshëm për efekt të kreditimit të investitorit ose të regjistrimit të kontratave paraprake. .. *Për kryerjen e regjistrimit të përkohshëm të objektit zyra e urbanistike e njësisë vendore përkatëse dërgon në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dokumentacionin e mëposhtëm: (a) konfirmimin e përfundimit të punimeve të karabinasë, në përputhje me projektin dhe kushtet urbanistike, të miratuara në lejen e ndërtimit*. Ky konfirmim bëhet nga autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, i cili lëshon procesverbalin e përfundimit të karabinasë brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së të interesuarit; (b) vendimin për sheshin e ndërtimit; (c) lejen e ndërtimit; (ç) planin e vendosjes së objektit; (d) aktin e pikëtimit të objektit. Neni 13/ dhënia e lejes së përdorimit behet nga autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit brenda 30 ditëve pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit. *Autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit i dërgon zyrtarisht zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në juridiksionin e së cilës ndodhet objekti konfirmimin zyrtar të përfundimit të punimeve të ndërtimit të objektit në përputhje me ligjin, projektin dhe kushtet urbanistike të miratuara për sheshin e ndërtimit*. Këtij dokumenti i bashkëngjiten kopjet e akteve vijuese: - leja e zhvillimit; - leja e ndërtimit; - procesverbali i kolaudimit të objektit; - leja e përdorimit; - plani i vendosjes së objektit; - dokumente të tjera që përcaktojnë dhe individualizojnë objektin e ndërtuar. Me paraqitjen e këtij dokumentacioni, zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në përputhje me dispozitat ligjore, kryen veprimet përkatëse të regjistrimit të objektit dhe lëshon certifikatën e pronësisë së të interesuarit.

tjera institucionale deri në regjistrimin hipotekor në vitin 2010, pasqyron ndërtim individual në tri kate.

1.16 Në vijim, subjekti ka deklaruar¹⁸ gjatë hetimit se: “Pasuria nr. (***) (kati i tretë), u përshtat për banim në vitin 2016. Për këtë qëllim u mor kredi nga ‘Alpha Bank’, Dega Durrës. Në këtë fazë punimet përfshinë: vendosje vetrata duralumin, dyer të brendshme, shtrim me pllaka, sistem kondicionimi, hidrosanitare, elektroshtëpiake, ndriçim, mobilim, për të cilat u shpenzuan rreth 25.500 euro. Ky apartament (kati i tretë) është bërë funksional për tu banuar nga ne, në janar 2017”. Për ndërtimin e këtyre pasurive (pas fazës karabina, deri në fazën e të bërit të tyre funksionale për banim), janë përdorur shumat e marra kredi. Lidhur me pagesat e kryera për këto punime, nuk kam dokumentacion justifikues (mandate, fatura) dhe për këtë arsye rezulton objektivisht e pamundur të përcaktoj shumën e saktë të paguar. I vetmi dokumentacion që disponoj lidhet me shpenzimet e vitit 2016.”

Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre pasurive

1.17 Subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këto dy pasuri, kreditë e marra në NBG dhe në “Alpha Bank”.

1.18 Komisioni hetoi në lidhje me secilin prej burimeve të deklaruara dhe për këtë ka mbajtur korrespondencë me bankat, nga ku i rezultoi se:

1.18.i NBG-ja ka nënshkruar kontratë kredie¹⁹ nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 30.3.2007, me kredidhënës NBG-në dhe kredimarrës bashkëshortin e subjektit, z. L. Sh. dhe subjektin Blerona Hasa me dorëzanës shtetasit I. dhe K. Sh., për kredi në vlerën 30.000 euro marrë me qëllim rikonstruktimit e apartamentit me adresë: lagja nr. (***), Rr. “(***)”, Durrës, me kolateral të pasqyruar: prona me nr. (***), vol. (***), f. (***), të ndodhur në z. k. (***) me adresë: lagjja (***), Rr. “(***)”, Durrës. Prona është e reregjistruar në ZVRPP-në Durrës, në regjistrin hipotekor me nr. (***), datë 25.7.1997, në pronësi të z. I. Sh., që vërtetohet nga vërtetimi i pronësisë lëshuar në datën 12.3.2007.

1.18.ii NBG-ja ka nënshkruar kontratë kredie²⁰ nr. (***) rep., nr(***) kol., datë 5.7.2007, me kredidhënës NBG dhe kredimarrës bashkëshortin e subjektit, z. L. Sh. dhe subjektin Blerona Hasa, me dorëzanës shtetasit I. dhe K. Sh., për kredi në vlerën 10.000 euro me qëllim rikonstruktimit e ndertësës me adresë: lagjja nr. (***), Rr. “(***)”, Durrës, me kolateral të pasqyruar: prona me nr. (***), vol. (***), f. (***), të ndodhur në z. k. (***)me adresë: lagjja (***), Rr. “(***)”, Durrës. Prona është e regjistruar në regjistrin nr. (***), datë 25.7.1997, në ZVRPP-në Durrës, në pronësi të z. I. Sh., që vërtetohet nga vërtetimi i pronësisë lëshuar në datën 12.3.2007.

1.19 Nga hetimi u vërejt se kreditë e marra në NBG ishin disbursuar dhe tërhequr sipas pasqyrimin të të dhënave (data/vlerat) në tabelat, si vijon:

¹⁸Referojuni pyetësorit nr. 2, datë 31.1.2020, në dosjen e Komisionit.

¹⁹Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

Disbursimi i kredive	
Data	Shuma/euro
30.3.2007	9,000
24.4.2007	10,500
25.5.2007	10,500
6.7.2007	3,000
16.8.2007	7,000
Total	40,000

Tërheqjet e kredive	
Data	Shuma/euro
3.4.2007	8,625
25.4.2007	10,313
28.5.2007	3,000
4.6.2007	7,300
11.7.2007	2,500
17.8.2007	7,000
Total	38,738

Në lidhje me përdorimin e kredisë së marrë në vitin 2007 në shumën 30.000 euro dhe 10.000 euro në NBG

1.20 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitin 2007 marrjen e këtyre dy kredive.

1.20. i Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* ndërtimin e pasurive në dhjetor të vitit 2007.

1.21 Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2007 dhe deri në deklaratën *Vetting* kohën e ndërtimit të këtyre pasurive.

1.22 Sipas kontratave përkatëse të cituara edhe më sipër është pasqyruar se destinacioni i kredisë në vlerën 30.000 euro do të shkojë me qëllim rikonstruktimin e apartamentit me adresë: Lagja nr. (***) , Rr. “(***)”, Durrës, dhe destinacioni i shumës 10.000 euro. Pas *disburësimit* të kredive në vitin 2007 rezultojnë se subjekti i rivlerësimit i ka tërhequr kreditë dhe, më tej, përdorimi i tyre duket të jetë bërë në *cash*. Subjekti i rivlerësimit nuk deklaron gjendje *cash* në vitin 2007, por nuk ka deklaruar as edhe përdorimin e kredive.

1.23 Konstatohet se deklarimi i destinacionit të kredive është bërë në deklaratën për vitin 2010, 2011 në të cilën, po ashtu, subjekti ka deklaruar edhe mënyrën e fitimit të pronësisë për katin e tretë dhe papafingon në emër të bashkëshortit, si rezultat i zhvillimit të një procesi gjyqësor civil (përfunduar me pushim gjykimi për shkak të zgjidhjes me ndërmjetësim të çështjes) me palë ndërgjyqëse bashkëshortin dhe babanë e tij.

Në lidhje me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e këtyre pasurive

1.24 Subjekti i rivlerësimit, sikurse është cituar edhe më sipër, ka deklaruar gjatë hetimit se për këto pasuri është përdorur shuma e marrë kredi në vitin 2007, në tërësi 40.000 euro dhe se kati i tretë prej këtij viti (2007) kishte mbetur i pamobiluar.

1.25 Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion që të provonte përfundimin e punimeve në vitin 2007. Në këto rrethana, referuar deklaratimeve të subjektit se: “... për këto punime, nuk ka dokumentacion justifikues (mandate, fatura) dhe për këtë arsye rezultojnë objektivist e pamundur të përcaktoj shumën e saktë të shpenzuar,..... se kredia e marrë në vitin 2007 ka pasur si destinacion përfundimin e karabinasë së katit të tretë dhe papafingos....”, si dhe në mbështetje të akteve shkresore zyrtare: (i) mbi konfirmimin dhe regjistrimin e karabinasë në vitin 2008;(ii) mbi përfundimin dhe regjistrimin e objektit në vitin 2010 ngriti dyshime mbi destinacionin e kredisë së marrë në vitin 2007, me qëllim përfundimin e objektit.

1.25.i Komisioni i kërkoi shpjegime²¹ subjektit lidhur me koston e ndërtimit karabina të të gjithë ndërtimit por edhe të pjesës së saj takuese, për të cilën subjekti deklaroi²² se: *“Vjehri i saj I. Sh., ka konfirmuar faktin se nuk disponon dokumente që vërtetojnë sa ka kushtuar objekti deri në fazën karabina. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit, e konsideroj objektivisht të pamundur saktësimin e shumës respektive. Për të njëjtën arsye (mungesë dokumentacioni), rezulton objektivisht i pamundur saktësimi i shumës për ndërtimin e pjesës së objektit, për të cilin zotëroj titull pronësie.”*

1.25.ii Komisioni i është drejtuar²³ edhe EKB-së për të disponuar informacion mbi masën e përqindjes (%) të shpenzimit të ndërtimit në fazën karabina dhe asaj së fazës së përfundimit të ndërtimit të objektit, i cili/EKB-ja²⁴, informoi komisionin se: *“...rast pas rasti, në varësi të llojit të punimeve të ndërtimit që do kryhen, për objekte me struktura, tipologji dhe sipërfaqe të ndryshme ndërtimi, për qindja që zë faza karabina në një ndërtim, nuk ka një vlerë fikse.”*

1.26 Në të tilla kushte (mungesë të dhënash, informacioni të plotë, dhe dokumentacioni nga ana e subjektit për vlerën e ndërtimit të objektit, arsyetuar në pikën 1.25, i, ii), Komisioni kreu vlerësimin duke përcaktuar masën 30% të ndërtimit karabina të vlerës së ndërtimit dhe në këtë drejtim ka kryer edhe përlllogaritjet. Komisioni, në përcaktimin e kësaj për qindjeje, ka marrë në konsideratë: (i) parashikimin²⁵ e përkufizimit të ndërtimit “karabina”, bërë në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, ku, ky ndërtim cilësohet *si një objekt i ndërtuar plotësisht në volum dhe në forme, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturën e plotë të objektit*. Pra, nënkuptohej që kishim të bënim relativisht me një ndërtim që ka marrë formën e plotë dhe se vlera 30% mund të ishte një logjikë krahasimore e drejtë. Po ashtu, fakti që ky lloj ndërtimi deri në këtë fazë mund të regjistrohët në hipotekë, si një ndërtim provizor deri në përfundimin e ndërtimit të plotë, përbënte një arsye më shumë për të kuptuar që zë një vlerë të caktuar në raport me ndërtimin përfundimtar; (ii) arsyetimin e bërë në vendimin nr. 34, datë 2.12.2019, në pikat 67.1, 67.2 dhe 67.3, të Kolegjit; (iii) pasjen në vëmendje të një rasti të mëparshëm të hetuar, thuajse të ngjashëm, lidhur me ndërtimin deri në fazën karabina, ku ndër të tjera konstatoi se subjekti në një deklaratë të depozituar nga ndërtuesi, ky i fundit deklaronte se *punimet karabina kapin 27-30 %, të vlerës së përgjithshme të ndërtimit të objektit*. Komisioni vlerësoi këtë standard, në rrethanat e paraqitura dhe referencat e sipërcitura, deri në fazën e hetimit, për të kryer llogaritjet, por njëkohësisht qartësoi subjektin në rezultatet e hetimit, që në vijim, ishte e drejtë e subjektit të provonte dhe ta kundërshtonte duke paraqitur edhe dokumentacion referues.

1.27. Komisioni në analizë të të gjithë dokumentacionit të depozituar dhe dyshimet e ngritura për vitin e përfundimit të ndërtimit (viti 2010), si dhe për destinacionin e kredisë, paraprakisht vlerësoi se kati i 3-të ka qenë në fazën karabina, ndërsa papafingo nuk ka qenë e ndërtuar. Duke kryer përlllogaritjet, bazuar në referencat ligjore sipas Udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, të EKB-së, kosto për sipërfaqe ndërtimi lekë/m² për vitin 2010 në Durrës ishte në vlerën 29.005 lekë,

²¹ Referuar komunikimit elektronik, datë 26.3.2020.

²² Me e-mail datë 7.4.2020.

²³ Referojuni shkresës nr. (***)prot, datë 20.2.2020, të Komisionit.

²⁴ Shkresë nr(***)prot., datë 3.3.2020, nga EKB-ja.

²⁵ Pavarësisht se ky parashikim është shtuar në ligj në vitin 2004, me ndryshimet që ky i fundit ka pësuar, por gjithsesi konteksti se çfarë kuptohet me *karabina* do të ishte në përmbajtje po i njëjtë.

si dhe pasqyroji kostot e ndërtimit nga faza karabina deri në përfundim për dy pasuritë, në tabelën si vijon:

Tabela nr. 1

Përshkrimi	Sip./m ²	Çmim sip. ndërtimi lekë/m ² , Durrës	Vlera
Pasuria nr(***), z. k. (***), h. (***), ap. 3, sip. 94 m ² , lagja(***), Rr. “(***)”	94	29,005	2,726,470
Pasuria nr. (***), z. k. (***), h. (***), ap. 2, sip.187 m ² , lagja (***), Rr. “(***)”	187	20,304 (29.005 lekë x 70%) ²⁶	3,796,755
Total	281		6,523,225

Komisioni, bazuar në të dhënat në pikën 1.27, deri në fazën e hetimit²⁷ të procesit, kreu analizën financiare për këtë vit, duke iu referuar vlerës së përlogaritur sipas kostove të ndërtimit të EKB-së.

1.28. Mbi këto konstatime, në rezultatet e hetimit²⁸, subjektit iu kalua barra e provës²⁹, pasi mbetej i paqartë viti i përfundimit të objektit, që për rrjedhojë do të derivonte në dyshime mbi deklaratimet dhe burime, të tilla si; (i) pamundësi financiare në vitin 2010 për të investuar në këto dy pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare; (ii) mospërputhje midis deklaratimit të subjektit gjatë hetimit administrativ se pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* kishin përfunduar së ndërtuari në vitin 2007, me deklarinimin për vitet 2007, 2008 dhe 2009, ku nuk deklaroheshin këto fakte dhe me konstatimet gjatë hetimit që ndërtimi i objektit ka përfunduar në vitin 2010; (iii) mosdeklarim në deklaratën për vitin 2007 të destinacionit të dy kredive të marra; (iv) dyshime për deklaratimet e kohës së përfundimit të karabinasë, të ndërtimit të pjesës takuese dhe të destinacionit të kredisë; (v) ndërtimin në tejkalim të lejes së ndërtimit të përcaktuar dhe miratuar për tre kate; (vi) mospërputhje në regjistrimin e pasurisë midis përshkrimit dhe numrit të kateve të saj, të adresuar nga DAMTU-ja e Këshillit të Qarkut Durrës, me shkresën e saj nr. (***)prot., datë 29.7.2010, për ZVRPP-së Durrës.

Në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie dhe shpenzimin e kryer për përshtatjen e pasurisë nr. (*) (apartament), në shumën rreth 25.500 euro, me burim krijimi kredinë e marrë në “Alpha Bank” në vitin 2016**

1.29 Nga hetimi ka rezultuar se “Alpha Bank”, ka nënshkruar kontratë huaje³⁰ nr. (***), datë 1.6.2016 dhe nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 3.6.2016, me huadhënës “Alpha Bank” dhe huamarrës Blerona Hasa dhe L. Sh., për hua me interes në shumën 59.000 euro. Qëllimi i marrjes së huas: (i) transferimin e huave nga NBG-ja dhe konkretisht huan në shumën 30.000 euro, si dhe huan në shumën 10.000 euro; (ii) ristrukturimin e apartamentit me sip.187 m² me nr. pasurie (***), vol. (***), f. (***), z. k. (***), në Rr. “(***)”, Durrës.

²⁶Aplikuar 70 % e kostos së ndërtimit sepse objekti ishte i ndërtuar deri në fazën karabina.

²⁷ Duke vlerësuar se këto dy pasuri (kati i tretë + papafingo) janë përfunduar në vitin 2010.

²⁸ Referojuni analizës dhe të dhënave në rezultatet e hetimit administrativ.

²⁹Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

³⁰Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

1.30 “Alpha Bank” ka nënshkruar kontratë hipoteke³¹ nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 3.6.2016, për – apartament me sip. 94 m² të regjistruar me nr. pasurie (***), vol. (***), f. (***), z. k. (***), në pronësi të z. L. Sh., Durrës si dhe apartament me sip. 187 m² të regjistruar me nr. pasurie (***), vol. (***), f. (***), z. k. (***), në pronësi të L.Sh., Durrës.

1.31 Rezulton se kredia e marrë në “Alpha Bank” është *disbursuar* në datën 7.6.2016 dhe është transferuar dhe tërhequr sipas të dhënave në tabelën, si vijon:

Tabela nr. 2

Datë	Vlera në euro	Përshkrim
8.6.2016	21,783.82	Lik. kontratë kredie nr. (***), datë 5.7.2007
8.6.2016	7,216.18	Lik. kontratë kredie nr. (***) , datë 30.3.2007
16.6.2016	29,940.00	Tërheqje nga L. Sh.
Total	58,940.00	

1.32 Në deklaratën për vitin 2016 subjekti ka deklaruar se ka investuar për të përshtatur për banim pasurinë nr. (***) (apartament) e cila përfshin vendosje vetrata duralumin, dyer të brendshme, shtrim me pllaka, sistem kondicionimi, hidrosanitare, elektroshtëpiake, ndriçim, mobilim, etj, në shumën rreth 25.500 euro. Burimi i krijimit: kredi në “Alpha Bank”.

1.33 Komisioni e ka pyetur³² subjektin në lidhje me arredimin e apartamentit, nga ku ka shpjeguar se ka shpenzuar rreth 25.500 euro për ta përshtatur këtë pasuri për banim, nga të cilat 1.100.000 lekë janë përdorur për arredimin e saj. Subjekti ka depozituar të njëjtat fatura që më parë i kishte depozituar në ILDKPKI me deklaratën “Vetting”. Nga verifikimi i tyre rezulton se faturat e depozituara (kryesisht TVSH-je) janë konform ligjit me të gjithë elementët përbërës dhe pasqyrojnë shpenzimet e kryera për qëllimin e deklaruar.

1.34 Komisioni, bazuar në faktet konstatuara gjatë hetimit, si dhe rrethanat e paraqitura, konstatoi se qëllimi i dhënies së kredisë përputhej me deklarinimin e subjektit që kredia në “Alpha Bank” ka shërbyer për mbylljen e dy kredive të marra në NBG. Po ashtu, dukej se pjesa e mbetur e kredisë, e tërhequr më 16.6.2016, ishte përdorur për ristrukturimin dhe mobilimin e apartamentit, pasi subjekti ka depozituar 38 fatura³³ të cilat datonin pas marrjes së kredisë, konkretisht nga 15.7.2016 – 12.1.2017.

1.35 Në lidhje me përshtatjen e pasurisë nr. (***) (apartament), Komisioni kreu analizën financiare të pasqyruar në tabelën, si vijon:

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	2016
1	TË ARDHURA	1,810,092
	Të ardhura nga paga subjektit	1,224,550
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	545,542
	Të ardhura nga shitja e automjetit për pjesë këmbimi	40,000

³¹Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

³²Referojuni pyetësorit nr. 2, datë 31.1.2020, në dosjen e Komisionit.

³³Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së dhe pyetësor nr. 2, datë 31.1.2020.

2	SHPENZIME	(1,519,012)
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	940,368
	Shpenzime shkollimi djali në shkollën (***)	155,070
	Shpenzime TIMS	875,873
	Shpenzime mjekësore djali	84,138
	Shpenzime të tjera kredia në NBG	10,470
	Kredia NBG (principal+interes) (marrë në vlerën 30.000 euro)	3,041,808
	Kredia NBG (principal+interes) (marrë në vlerën 10.000 euro)	998,040
	Kredia “Alpha Bank” (principal+interes) (59.000 euro)	(7,624,779)
3	PASURI	3,785,457
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Banesë private nr(***), z. k(***), kati 3-të + papafingo (hipotekuar 17.9.2010) (përshtatur për banim)	3,449,385
	Automjet “Smart for Four” (bashkëshorti) (targa (***))	204,000
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	132,072
	DIFERENCA (1-2-3)	-456,353

1.36 Mbi këto konstatime në rezultatet e hetimit, konkretisht nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni, sipas tabelës së mësipërme subjektit iu kalua barra e provës³⁴, pasi dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 456.353 lekë për të kryer investimet e vitit 2016, si dhe për të përballuar të gjitha shpenzimet e tjera familjare.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.37 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, si dhe në seancën dëgjimore, paraqiti prova dhe dha shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimi. Ndër të tjera, subjekti ka parashtruar se rezultatet e Komisionit, për të cilat i ka kaluar edhe barra e provës³⁵ ishin rrjedhojë e konkluzionit të tij, se: “ndërtimi i objektit ka përfunduar në vitin 2010” të cilën subjekti e ka kontestuar duke qëndruar në deklarin e saj në deklaratën *Vetting*, deklarin periodik të marrjes së kredisë në vitin 2007, deklarin dhe destinacionin në deklaratat periodike 2010 dhe 2011, si dhe në deklarinet gjatë hetimit se objekti ishte ndërtuar në vitin 2007, për sa vijon:

1.38 Ka parashtruar se të gjitha problematikat që kishte ngritur Komisioni, ishin të lidhura me sqarimin e përshkrimit të objektit të banimit, si objekt 3-katësh, apo si objekt 3 katësh + bodrum + papafingo, duke përshkruar në këtë drejtim, të gjitha fazat e ndërtimit dhe përfundimit të tij, siç renditen në vijim:

- i. në datën 25.7.1997, vjehri i subjektit, shtetasi I. Sh., ka nënshkruar kontratë shitje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 25.7.1997, me objekt shitblerjen nga ish-pronarët D., etj., të një sipërfaqeje trualli 170 m², me vendndodhje: lagjja (***), Rr. “(***)”, Durrës;

³⁴Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

³⁵ Përshkruar në pikën 1.27 të vendimit.

- ii. në cilësinë e pronarit të truallit shtetasi I. Sh. ka investuar Këshillin e Rregullimit të Territorit të Rrethit Durrës, me kërkesë për pajisje me leje sheshi ndërtimi për “banesë 5-katëshe”;
- iii. sipas projektidesë, pjesë integrale e kërkesës, evidentohet ky përshkrim: “*objekti ndërtohet me kërkesë të zotit I. Sh. në konturet ekzistuese të shtëpisë së zotit D., objekti është parashikuar 3-kate + Sofito³⁶....*”;
- iv. në fletën e parë të projektit, gjenden vulat e institucioneve shtetërore (KRT-ja Durrës, UKT-ja, OSHEE-ja, Telekom etj.);
- v. me vendimin nr. (***), datë 26.2.1998, të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit Durrës, vjehrrit të subjektit i është miratuar leja e ndërtimit për: “*banesë individuale 3- katëshe në pronën e tij*”;
- vi. në kohën e disponimit nga KRT-ja e Rrethit Durrës, të lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit, në fuqi ka qenë ligji nr. 7693, datë 6.4.1993, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, dhe në projektidenë e paraqitur me kërkesën për pajisje me leje sheshi ndërtimi, në përshkrimin e objektit, përfshihej edhe “sofito”/papafingo, dhe sipas projektit teknik bashkëngjitur kërkesës për pajisje me leje ndërtimi, objekti përshkruhet: 3 kate + bodrum + papafingo. Sipas subjektit bazuar në situatën ligjore dhe faktike, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Rrethit Durrës, duke disponuar vendimin nr. (***), datë 26.2.1998, për pajisje me leje ndërtimi, ka miratuar njëherësh projektin e këtij objekti, hartuar nga arkitekti V. Dh.;
- vii. nga kqyrja e fletëve të projektit, rezulton mjaft qartë se objekti është projektuar: 3 kate + bodrum+ papafingo;
- viii. projekti përshkruan në fletë të veçanta planin e papafingos dhe planin e bodrumit;
- ix. edhe skicat e përgjithshme të objektit tregojnë mjaft qartë strukturën e tij, evidentuar me: 3 kate + bodrum + papafingo;
- x. kopjet e projektit, të dërguar nga secili institucion, përputhen ndërmjet tyre;
- xi. në të gjitha fletët e projektit dërguar Komisionit nga ZRPP-ja Durrës (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) dhe Këshilli i Qarkut Durrës, evidentohet vula e Arkivit të Këshillit të Qarkut Durrës;
- xii. akti i kolaudimit në paragrafin e fundit të faqes nr. 3, konfirmon ndër të tjera se projekti është i nënshkruar dhe vulosur edhe nga përgjegjësi i urbanistikës inxh. S.K.;
- xiii. në procesverbalin, datë 14.4.1999, të Seksionit të Urbanistikës së Këshillit të Rrethit Durrës, evidentohet fakti se: “*Kontrolluesit konkludojnë se është ndërtuar prej subjektit juridik, shoqërisë ‘M.’, sipas projektit të hartuar nga autori V. Dh.*”;
- xiv. projekti i arkitektit V. Dh. miratuar bashkë me lejen e ndërtimit, pasqyron objekt të projektuar me: 3 kate + bodrum + papafingo;
- xv. ky procesverbal mban vulën e Këshillit të Rrethit Durrës, vendosur mbi nënshkrimin e Përgjegjësit të Seksionit të Urbanistikës, z. S. K.;
- xvi. nën të njëjtën cilësi, z. S. K., kishte nënshkruar edhe fletët e projektit të miratuar, fakt i konfirmuar edhe nga kolaudatori në paragrafin e fundit të faqes nr. 3 të aktkolaudimit;

³⁶ “Sofito”, fjalë në gjuhën italiane, që përkthehet në gjuhën shqipe: papafingo/çati.

- xvii. në dokumentacionin e tërhequr prej Komisionit nga Këshilli i Qarkut Durrës, gjendet, ndër të tjera, edhe deklarata noteriale nr. (***)rep., nr(***)kol., datë 23.4.1999, e z. I. Sh., nëpërmjet të cilës konfirmohet se: *“...në bazë të lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. (***), datë 26.2.1998, të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Rrethit Durrës, mbi truallin që kam të regjistruar në pronësinë time..., sipas skicave të miratuara nga organet kompetente kam ndërtuar një banesë trekatëshe.....Banesa ndodhet në lagjen nr. (***) rruga “(***)”, kufizohet....dhe ka një përbërje: kati përdhe prej një sipërfaqe ndërtimi 150 m², nënkatin përdhe (bodrum) 60 m², kati i parë prej një soxhorno, një dhomë gatimi, dy dhoma fjetje, tre ballkone dhe një korridor, dy banja me sipërfaqe ndërtimi 170 m², kati i dytë po me të njëjtën përbërje dhe sipërfaqe ndërtimi, dhe papafingo prej një sipërfaqe ndërtimi 80 m²”;*
- xviii. deri në vitin 2008, shtetasi I. Sh. vazhdonte të kishte të regjistruar në emër të tij, në regjistrat e ZVRPP-së Durrës, vetëm pasurinë e paluajtshme “truall”, përfituar me kontratë shitjeje në vitin 1997 (cituar më lart);
- xix. mbi kërkesën e shtetasit I. Sh., Këshilli i Qarkut Durrës ka përpiluar procesverbalin e konstatimit të datës 22.5.2008, duke konstatuar nëpërmjet tij se: *“U bë verifikimi në vend nga grupi i specialistëve të sektorit të urbanistikës dhe u konstatua që objekti tri kate + bodrum + papafingo, ka përfunduar. Vihet re që kuota 00 është 108 cm mbi kuotën e terrenit të sistemuar. Dimensionet e objektit në katin përdhe (dimensione aksiale) janë si më poshtë: përgjatë akseve(A-D13 Mx(1-6) 13 M;-bodrumi me funksion shërbime S=70 m², kati përdhe me funksion shërbime me sipërfaqe S=169 m², kati tip me funksion banimi me sipërfaqe 187 m² dhe papafingo me funksion banimi me sipërfaqe 94 m²”;*
- xx. detajet e pasqyruara në procesverbal tregojnë qartësisht se specialistët kanë këqyruar objektin në terren dhe kanë kryer matje të detajuara, duke konkluduar mbi respektimin e kuotave dhe të dimensioneve aksiale për bodrum, kat përdhe, kat tip dhe papafingo;
- xxi. të dhënat mbi kuotat dhe dimensionet e evidentuara në këtë procesverbal, përputhen me ato të evidentuara në projektin e miratuar me lejen e ndërtimit, hartuar nga arkitekti V. Dh.;
- xxii. ky procesverbal është nënshkruar, ndër të tjera, edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Administrimit, Mbrojtjes së Territorit dhe Urbanistikës, z. M. K.;
- xxiii. me shkresën nr. (***) prot., datë 6.6.2008, Këshilli i Qarkut Durrës i ka përcjellë ZVRPP-së Durrës praktikën e plotë për kryerjen e regjistrimit provizor të objektit: “banesë individuale 3 kate”, me investitor z. I. Sh.;
- xxiv. kësaj shkrese, Këshilli i Qarkut Durrës i ka bashkëngjitur: vendimin për sheshin e ndërtimit; lejen e ndërtimit; planin e vendosjes së objektit; si dhe procesverbalin e konstatimit, ku përfshihen aktet e kontrollit të objektit;
- xxv. për sa më sipër, në datën 16.6.2008, ZVRPP-ja Durrës ka kryer regjistrimin provizor (karabina) të objektit, me nr. hipotekor (***), duke hapur për këtë qëllim dosjen me nr. reference (***);
- xxvi. në dokumentin “inventari i brendshëm i dosjes”, listohen të gjitha dokumentet në bazë të të cilave është kryer regjistrimi provizor (karabina), gjithsej 17 fletë;

- xxvii. me numër rendor 5 të listës së inventarit, përshkruhet dokumenti “projekt” në “5 fletë”;
- xxviii. projekti me 5 fletë të cilin KRT-ja e ka përcjellë në ZVRPP-në Durrës, rezultoi nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Administrimit, Mbrojtjes së Territorit dhe Urbanistikës, z. M. K. dhe mban vulën e Arkivit të Këshillit të Qarkut Durrës;
- xxix. projekti i nënshkruar nga z. M. K. është i hartuar nga arkitekti V. Dh. dhe i miratuar me lejen e ndërtimit nr. (***) , datë 26.2.1998;
- xxx. ZVRPP-ja Durrës, bazuar në praktikën dokumentare të përcjellë me shkresën nr. (***) prot., datë 6.6.2008, të Këshillit të Qarkut Durrës, e ka pajisur shtetasin I. Sh. me vërtetim hipotekor, datë 16.6.2008;
- xxxi. mbi kërkesën e shtetasit I. Sh., Këshilli i Qarkut Durrës ka përpiluar procesverbalin e konstatimit, datë 27.4.2010, duke konstatuar pas verifikimit në vend, faktin se: “objekti 3 kate + bodrum + papafingo’ ka përfunduar dhe është vënë në shfrytëzim”;
- xxxii. aktkolaudimi është përpiluar nga studio “U. E.”;
- xxxiii. Këshilli Teknik i KRRT-së, Qarku Durrës, ka disponuar vendimin nr. (***) , datë 28.5.2010, që konsiston në miratimin e lejes së shfrytëzimit të objektit: “banesë individuale 3 kate” në Durrës me investitor z. I.Sh., sipas sheshit të miratuar me vendim të KRT-së nr(***) , datë 24.11.1997 dhe lejes së ndërtimit me vendim nr. (***) , datë 26.2.1998”, bashkëngjitur edhe leja e shfrytëzimit.

1.39 Subjekti ka qartësuar se në kohën e disponimit të vendimit nr. (***) , datë 28.5.2010, në fuqi ka qenë ligji nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin e disiplinimit e punimeve të ndërtimit”, dhe për pasojë janë zbatuar parashikimet ligjore të tij dhe gjithashtu ka specifikuar dispozitat dhe nenet përkatëse zbatuese³⁷ të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, në bazë të të cilave kanë dalë aktet e institucioneve përkatëse. Sipas subjektit, leja e ndërtimit nr. (***) , datë 26.2.1998, ishte titulli i pronësisë së shtetasit I. Sh., në bazë të të cilit u krye regjistrimi i pasurisë në ZVRPP-në Durrës. Zbatimi i nenit 193³⁸ të Kodit Civil, diktohej në këtë rast nga neni 24³⁹ i ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, dhe neni 41/a, i ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (në fuqi deri në vitin 2012), që parashikonte lidhur me regjistrimin e ndërtimeve të reja⁴⁰.

1.40 Pasi subjekti ka parashtruar veprimet kronologjike të ndjekura dhe të analizuar në raport me legjislacionin ekzistues në kohën e disponimit të tyre, ka konkluduar se objekti me investitor shtetasin I. Sh., pavarësisht se etiketohej objekt 3-katësh, është objekt i ndërtuar me lejen e ndërtimit të vitit 1998 sipas projektit teknik për 3 kate + bodrum + papafingo, të arkitektit

³⁷ Referojuni parashtrimeve të subjektit, dërguar në Komision në datën 11.6.2020.

³⁸ “Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:

dh) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjesëtimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përbarimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankant të tyre...

³⁹Regjistruesi, një person ose çdo grup i ngarkuar nga Kryeregjistruesi kërkon që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen duke përdorur kriteret e mëposhtme:

a) pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil... ”.

⁴⁰ Ku parashikohej se “Pas përfundimit të objektit, për regjistrimin përfundimtar të tij, zbatohet neni 13 i ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin e disiplinimit e punimeve të ndërtimit”.

V. Dh., zbatimi me përpikëri i të cilit përbën fakt të konfirmuar nga institucionet shtetërore të ngarkuara me ligj për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit dhe administrimin e territorit.

1.41 Subjekti, lidhur me destinacionin e kredisë, ndër të tjera,⁴¹ ka parashtruar se në vitin 2007 e ka deklaruar kredinë e marrë. Në kontratën e kredisë së marrë në vitin 2007, pasqyrohet se qëllimi i kredisë është rikonstruksion i banesës së ndodhur në adresën: lagjja (***), Rr. “(***), Durrës, përshkrim i cili përputhet me punimet e kryera për katin e tretë dhe papafingon. Në vitin 2007, subjekti dhe bashkëshorti kishin qenë në marrëdhënie pune, rrjedhimisht, i vetmi person në familje i angazhuar me ndjekjen e punimeve të ndërtimit dhe përfundimin e objektit kishte qenë vjehri. Në datën 11.02.2011, bashkëshorti kishte vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me padi, me objekt “detyrim njohje pronar”. Me vendimin nr. (***), datë 22.2.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, kishte miratuar marrëveshjen me pajtim të arritur mes palëve ndërgjyqëse duke konfirmuar faktet mbi kontributin e bashkëshortit në vlerën 40.000 euro, hua e marrë në vitin 2007 në NBG, si dhe të drejtën për t’u njohur pronar, pikërisht në bazë të kontributit të vitit 2007, pjesë e pretendimeve të bashkëshortit të subjektit.

1.42 Subjekti ka trajtuar të drejtat reale mbi këtë objekt duke shpjeguar se deri në momentin e krijimit të titullit të pronësisë mbi katin e tretë të objektit dhe papafingon, gëzonte vetëm të drejtën e banimit, pra, të drejtën e përdorimit, në kuptim të nenit 259 të Kodit Civil. E drejta reale e përdorimit të papafingos dhe katit të tretë, nuk konfirmohet në vitin 2010, por në vitin 2007, pikërisht, në kohën e përfundimit të tyre. Ky fakt sipas subjektit konfirmohet me të dhënat e dokumentuara, kontratat e lidhura me OSHEE-në, nr. kod (***), në instancën e Durrësit, me datë hapje 19.9.2007, me adresë: lagjja (***), Rr. “(***), dhe nr. kontrate (***), me datë hapje 19.9.2007, me adresë: lagjja (***), Rr. “(***).”

1.43 Sipas subjektit, duke pranuar ndonjë pasaktësi që lidhej me mosdeklarimin e qëllimit të kredisë nuk duhej të interpretoheshin nga Komisioni ngushtësisht, por duhet analizuar edhe në raport me anën subjektive, materializuar në përpjekjet e saj për të fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë.

1.44 Lidhur me konstatimin e Komisionit se nga analiza financiare e vitit 2016, dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 456.353 lekë për të kryer investimet e vitit 2016, si dhe për të përballuar të gjitha shpenzimet e tjera familjare, subjekti ndër të tjera, ka parashtruar disa kontestime të lidhura me fakte të tilla, si vijon:

1.44.i Fitimi i disponueshëm i Subjektit Fizik, L. Sh., me NIPT (***), në datën 31.12.2016, ka qenë në vlerën 49.010 lekë, më i lartë se fitimi *neto*, për shkak se disa detyrime të subjektit (*tvsh-ja e muajit dhjetor 2016 dhe sigurimet shoqërore të muajve tetor, nëntor, dhjetor të vitit 2016*), të lindura dhe të kontabilizuar gjatë vitit 2016, janë paguar në janar të vitit 2017, fakt i cili provohej edhe nga të dhënat e *statmentit* bankar të “Raiffeisen Bank”.

1.44.ii Shpenzimet e kryera për mobilimin e banesës së katit të tretë janë deklaruar përafërsisht në shumën 25.500 euro ose e përlllogaritur nga Komisioni në lekë në shumën 3.449.385 lekë. Në deklaratën *Vetting* kishte paraqitur fatura të cilat provojnë shumën e shpenzuar. Ndër faturat e paraqitura në ILDKPKI, gjenden edhe faturat nr. (***), datë 12.1.2017 dhe nr. (***), datë

⁴¹ Për më tepër, në këtë pikë, por edhe në tërësi të qartësimeve të detajuara të subjektit, referojuni parashtrimeve të saj dërguar në Komision me datë 11.6.2020.

12.1.2017, të lëshuara nga “M. T.” sh.p.k., ku vërehej se këto fatura ishin të janarit 2017, në shumën 210.800 lekë, të paguara me *kasë*, po në janar të vitit 2017.

1.44.iii Ka deklaruar se shuma 25.500 euro e mobilimit ishte deklaruar me përafërsi prej saj (sepse disa fatura janë lëshuar në lekë dhe disa në euro). Sipas faturave të depozitura, në përlllogaritjet me saktësi të tyre, vlera e plotë rezultoi 2.877.973,02 lekë dhe 3.704 euro, nga të cilat vlera 210.800 lekë (vlera e faturave të mallrave të blera në vitin 2017) përfaqëson shpenzim të vitit 2017. Ky fakt kishte diktuar përlllogaritjet e shpenzimeve të saj, me përafërsi.

1.44.iv Në analizën financiare të vitit 2016 kursi i këmbimit i përdorur duhet të ishte i datës së disbursimit të kredisë 138.45 lekë/euro. Shpenzimi i kryer për shlyerjen e kredisë në vlerën 30.000 euro, në vitin 2016 kishte qenë në vlerën 21,783,86 euro - 536 euro = 21,247.82 euro, e cila shumëzuar me kursin e këmbimit 138.45 = 2,941,761 lekë.

1.44.v Ka kontestuar vlerën *neto* të kredisë të përfituar në “Alpha Bank” në vitin 2016, të përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 7.624.779 lekë, pasi kjo vlerë duke zbritur komisionin fillestar dhe shumën e kësteve të paguara gjatë vitit 2016, arrinte në vlerën 56.720 euro (e shumëzuar me kursin e këmbimit 138.45) ose 7.852.884⁴² lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.45 Trupi gjykues, nisur nga analizimi i provave të administruara në dosje, deklaratimet e subjektit përpara dhe gjatë hetimit administrativ, konstatimet e bëra në rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në seancën dëgjimore, në tërësi të kësaj çështjeje për këtë pasuri, arsyetoi si vijon:

1.46 Referuar deklaratimeve në deklaratën *Vetting*, atyre periodike dhe provave të administruara ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka kontribuar për ndërtimin dhe përfundimin e kësaj pasurie, katin e 3-të dhe papafingo të një banese private trekatëshe dhe papafingo, për të cilën vjehri i saj, z. I. Sh., ishte pajisur me lejen e ndërtimit nr. (***) datë 26.2.1998, të KRRT-së.

1.47 Në analizën juridike të kësaj çështjeje, trupi gjykues mban në vëmendje rrethanat ligjore dhe faktike që janë të lidhura me pozicionin e subjektit në raport me këtë pasuri dhe që, për rrjedhojë, janë vlerësuar për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në këtë drejtim trupi gjykues, ashtu sikurse janë referuar në mënyrë të detajuar faktet e konstatuara, arsyetuar në (*pikat 1.2-1.36*), hetimin administrativ e thelloi për të ushtruar kontroll mbi saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaratimeve të subjektit, specifikisht për kohën e ndërtimit të objektit, destinacionin e kredisë bankare të përdorur si burim, përlllogaritjet e vlerës së shpenzuar, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj pasurie.

1.48 Lidhur me vërtetësinë e deklaratimit të subjektit për kohën e përfundimit të objektit dhe destinacionin e kredisë, trupi gjykues në analizë të dokumentacionit të administruar, vlerëson se janë fakte të provuara se veprimet juridike që në momentin e fitimit të pronësisë së truallit dhe deri në regjistrimin hipotekor të objektit, janë kryer nga vjehri i subjektit. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues ka vlerësuar të verifikojë historikun e tij që në origjinë dhe më tej, për sa

⁴² Referojuni parashtrimeve të subjektit, paraqitur edhe në formë tabelare vlerat e kredisë *neto* (derdhjet, *disbursimet* dhe komisionet e *disbursimit* të kredisë).

kohë që subjekti ka investuar në këtë pasuri, ka pasur të drejta përdorimi, si dhe për të verifikuar sjellje të subjektit për të pranuar investime në një objekt të ligjshëm ose jo.

1.49 Për sa më sipër, referuar dokumentacionit të administruar nga hetimi dhe të paraqitur nga subjekti, trupi gjykues konstaton se këto prova⁴³ faktojnë ndërtimin e objektit sipas lejes së miratuar me vendimin nr. (***) , datë 26.2.1998, dhënë nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Rrethit Durrës, banesë 3-katëshe, sipas sheshit të miratuar me vendim nr. (***) , datë 24.11.1997, të KRRT-së. Trupi gjykues, vëren se pavarësisht se nga njëra anë në lejen e ndërtimit është cituar “objekt banesë 3-katëshe”, nga ana tjetër në procesverbalin e datës 14.4.1999, të Seksionit të Urbanistikës të Këshillit të Rrethit Durrës, konfirmohet ndërtimi karabina dhe pasqyrohet se objekti ka përfunduar sipas projektit të hartuar nga autori V. Dh. . Trupi gjykues këtë fakt, si dhe veprimet e tjera të ndjekura nga vjehri i subjektit dhe të konfirmuara nga institucionet në nivel bashkie/qarku/zvrrp, i ka vlerësuar në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi në kohë, të referuara edhe nga subjekti. Kështu, ka rezultuar se në kohën e disponimit të lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit, nga KRRT-ja e Rrethit Durrës, në fuqi kanë qenë dispozitat ligjore të ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993, “Për urbanistikën”, i ndryshuar (tashmë i shfuqizuar), i cili ka parashikuar se:

- Neni 22 i tij parashikonte: “...kërkesa për shesh ndërtimi bëhet sipas formularit nr. 1 që i bashkëngjitet këtij ligji. Me kërkesën për shesh ndërtimi të bashkëlidhet plani i vendosjes dhe projektideja e objektit që ndërtohet, si dhe infrastruktura përkatëse...”;

- Neni 28: “.....çdo person fizik e juridik, vendas apo i huaj që do të ndërtojë duhet të pajiset me leje ndërtimi, e cila është dokumenti ligjor që lejon piketimin e objektit. Piketimi bëhet nga zyra e urbanistikës në bashki e komunë ose nga persona të autorizuar prej tyre.....”.

-Neni 31: “...kërkesa për leje ndërtimi bëhet sipas formularit nr.3, që i bashkëngjitet këtij ligji, dhe paraqitet për miratim bashkë me: - vendimin për dhënien e sheshit të ndërtimit të miratuar nga këshilli i rregullimit të territorit, këshilli i bashkisë apo komunës, - dokumentacionin për azhornimin e rrejtit inxhinierik nëntokësor, ujësjellës, kanalizime, elektrik e telefoni, si dhe miratimin nga instancat përkatëse për lidhjen e tyre me objektin e ri, - projektin teknik të objektit të hartuar nga një organizatë projektimi që e ka këtë të drejtë ose nga projektues privatë që kanë marrë licencë projektimi nga organi i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Të gjitha këto materiale përgatiten nga i interesuari dhe së bashku me kërkesën për leje ndërtimi paraqiten në zyrën e urbanistikës të pushtetit lokal, ku është kërkuar sheshi, e cila pasi shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm, jep mendimin e saj dhe ia përcjell këshillit të rregullimit të territorit në rreth...”.

1.50 Sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara, rezulton se nga dokumentacioni i administruar provohen faktet se sipas projektidesë së kërkesës për pajisje me leje sheshndërtimi, në përshkrimin e objektit, përfshihej edhe “sofito”/papafingo, dhe se sipas projektit teknik bashkëngjitur kërkesës për pajisje me leje ndërtimi, objekti përshkruhej: 3-katëshe + bodrum + papafingo, si dhe skicat e përgjithshme të objektit pasqyronin një strukturë të objektit me 3-katësh + bodrum + papafingo. Këto fakte rezultojnë të evidentuara edhe në procesverbalin, datës 14.4.1999, të Seksionit të Urbanistikës të Këshillit të Rrethit Durrës, të pranuar e

⁴³ Referojuni dosjes së Këshillit të Qarkut Durrës, procesverbaleve të konstatimit, projektit, aktkolaudimit.

miratuara nga sektorët përgjegjës të institucionit të Këshillit të Rrethit Durrës ku pasqyrohet se: “Kontrolluesit konkludojnë se është ndërtuar prej subjektit juridik, shoqërisë “M.”, sipas projektit të hartuar nga autori V. Dh. i cili ka pasqyruar objekt të projektuar me: 3 kate + bodrum, +papafingo”.

1.51 Gjithashtu, edhe gjatë verifikimit të dokumentacionit të mbajtur nga këto institucione konfirmohen faktet e ndërtimit të objektit 3-katësh + bodrum + papafingo dhe më konkretisht: a) deklaratë noteriale nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 23.4.1999, e z. I. Sh.; (b) procesverbali i konstatimit të datës 22.5.2008, i përpiluar nga Këshilli i Qarkut Durrës ku përkrahëj se: “U bë verifikimi në vend nga grupi i specialistëve të sektorit të urbanistikës dhe u konstatua që objekti tre kate + bodrum + papafingo, ka përfunduar. Vihet re që kuota 00 është 108 cm mbi kuotën e terrenit të sistemuar. Dimensionet e objektit në katin përdhe (dimensione aksiale) janë si më poshtë: përgjatë akseve(A-D13 Mx(1-6) 13 M;-bodrumi me funksion shërbime $S=70\text{ m}^2$, kati përdhe me funksion shërbime me sipërfaqe $S=169\text{ m}^2$, kati tip me funksion banimi me sipërfaqe 187 m^2 , dhe papafingo me funksion banimi me sipërfaqe 94 m^2 .”

Ky procesverbal është nënshkruar edhe nga drejtori i Drejtorisë së Administrimit Mbrojtjes së Territorit dhe Urbanistikës, duke vijuar me konfirmimet përkatëse të institucioneve, fillimisht në vitin 2008 me regjistrimin provizor të objektit, me përshkrimin: “banesë individuale 3-katëshe” duke e pajisur shtetasin I. Sh. me vërtetim hiptekor, datë 16.6.2008, deri në regjistrimin e plotë të tij në vitin 2010, me miratimin e dhënies së lejes së shfrytëzimit sipas vendimit⁴⁴ nr. (***), datë 28.5.2010, për objekt: “Banesë individuale 3 katëshe, në Durrës me investitor zotin I. Sh., sipas sheshit të miratuar me vendim nr. (***), datë 24.11.1997, të KRRT-së dhe lejes së ndërtimit me vendim nr. (***), datë 26.2.1998”, bashkëngjitur edhe leja e shfrytëzimit.

1.52 Aktet e tjera të mbajtura nga institucionet përkatëse, trupi gjykues i vlerëson se janë rrjedhojë e detyrimeve ligjore vijuese të subjektit investues (vjehri i subjektit) dhe institucioneve përkatëse, të ndërmarra me qëllim regjistrimin e objektit referuar dispozitave ligjore në fuqi, Kodit Civil, si dhe ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar (në fuqi deri në vitin 2012), që parashikonte lidhur me regjistrimin e ndërtimeve të reja.

1.53 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe arsyetuar sa më sipër, vlerëson se pavarësisht se nga njëra anë disa akte të mbajtura nga institucionet e ngarkuara me ligj, nuk pasqyrojnë detaje në konfirmimet e tyre, nga ana tjetër të analizuara në harmoni me dokumentacionin e plotë në dosje dhe kërkesat e kërkuara nga ligji, lidhur me veprimet e mëtejshme mbi konfirmimet e tyre për regjistrimin e kësaj pasurie, vlerëson se këto prova dëshmojnë fakte për deklaram të saktë të subjektit në deklaratën *Vetting*, për përfundimin e objektit në dhjetor të vitit 2007 dhe se destinacioni i kredisë ka qenë ndërtimi dhe përfundimi i kësaj pasurie.

1.54 Në këtë drejtim, trupi gjykues arrin në këtë konkluzion duke e ndërthurur këtë vlerësim edhe më fakte të tjera, për sa arsyeton në vijim:

⁴⁴ Bazuar edhe në procesverbalin e konstatimit, datë 27.4.2010, të Këshillit të Qarkut Durrës, që kishte konstatuar se: “objekti 3-katësh + bodrum+ papafingo” kishte përfunduar dhe është vënë në shfrytëzim.

1.54.1 Të drejtat reale të përdorimit të papafingos dhe katit të tretë, nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2007, konfirmohen edhe nga faktet e dala të lidhjes së kontratave⁴⁵ të energjisë elektrike në vitin 2007 me OSHEE-në, ku konfirmohen kontratat me kod (***) në emër të abonentit L.Sh., e lidhur më 9.9.2007 dhe kontrata me kod (***) në emër të abonentit L. Sh. e lidhur po më 19.9.2007⁴⁶. Mbi këto fakte të dala nga koha e lidhjes së kontratave të energjisë në emër të bashkëshortit të subjektit, trupi gjykues vlerëson se dëshmojnë paralelisht edhe faktin e ndërtimit të objektit në vitin 2007, sipas deklaramit të subjektit, për sa kohë i gjen të bazuara në rregullat e miratuara në vendimin nr. (***), datë 19.12.2001, të Këshillit Drejtues të ERE-s, “Mbi miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, në të cilin konstatohet dhe çmohet se: *“Përdorues të energjisë elektrike janë personat fizikë dhe juridikë, zotërues të objektit,⁴⁷ ku janë vendosur pajisje që punojnë me energji elektrike dhe janë apo duan të lidhen në rrjetin elektrik, si dhe kriterëve⁴⁸ që duhet të përmbushë një aplikues, ku ndër të tjera nevojitet të paraqitet a) planimetria e vendosjes së objektit (gent-plani), b) projekti i instalimeve elektrike të objektit të kryer nga specialistë me liçencë, organizma shtetërore apo privatë të miratura për këtë qëllim, ku të përcaktohet fuqia e instaluar dhe e kërkuar e objektit.”*

1.55 Dyshimet e ngritura nga Komisioni ishin të lidhura me faktin se subjekti ka deklaruar marrjen e kredisë në vitin 2007, por jo destinacionin e saj në këtë vit, të cilën e deklaroi në vitet 2010 dhe 2011, kur fiton titujt e pronësisë, si dhe për faktin se prej saj nuk disponohej dokumentacion për vlerën e shpenzuar. Në këtë drejtim Komisioni pavarësisht dyshimeve të ngritura, konstatoi se nga hetimi nuk rezultuan pasuri të tjera veç dy pasurive të ndodhura, të deklaruara nga ana e saj, me vendndodhje në, lagjja (***), Rr. “(***)”, Durrës, sot Rr.” (***)”, si dhe nuk evidentoi ndonjë rrethanë për të dalë në konkluzion të ndryshëm, duke i gjetur të drejta shpjegimet e subjektit për sa referohet.

1.56 Sikurse dhe subjekti ka shpjeguar në prapësimet e saj, siç dhe evidentohet edhe në rezultatet e hetimit, është fakt se edhe në kontratën e kredisë së marrë në vitin 2007, pasqyrohet se, qëllimi i kredisë është rikonstruksion i banesës së ndodhur në adresën: lagjja (***), Rr. “(***)”, Durrës. Po ashtu, në këtë drejtim trupi gjykues gjen bindës edhe deklaramit e subjektit se: *“...në vitin 2007 (koha e marrjes së kredisë), unë dhe bashkëshorti kemi qenë në marrëdhënie pune, rrjedhimisht i vetmi person në familje i angazhuar me ndjekjen e punimeve të ndërtimit përfundimin e objektit ishte vjehri im I. Sh., i cili rezultoi ushtrues aktiviteti privat me objekt ndër të tjera, import, eksport dhe tregtim të makinerive dhe materialeve në fushën e ndërtimit...”*, pasi rezultoi se nga dokumentacioni i administruar në dosje⁴⁹ subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë nga viti 2002 – 2009 dhe po ashtu edhe bashkëshorti i saj për vitet 2003 dhe 2004 ka ushtruar funksionin e tij në Doganën Tre Urat Përmet, për vitet 2004 – 2006 në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe, më tej, detyra të ndryshme në administratën shtetërore në Durrës.

⁴⁵ Shkresë nr. (***) prot., datë 8.6.2020, lëshuar nga OSHEE-ja Drejtoria Rajonale Durrës.

⁴⁶ Referuar faturimeve për këto kontrata në tetor të vitit 2007.

⁴⁷ Referuar kapitullit të parë pika 1.3 në vendimin nr. (***), datë 19.12.2001, të Këshillit Drejtues të ERE-s.

⁴⁸ Kapitulli i dytë, pika 2/ b, c, e vendimit nr. (***), datë 19.12.2001, të Këshillit Drejtues të ERE-s.

⁴⁹ Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

1.57 Në këtë drejtim, edhe shpjegimet e subjektit, referuar përmbajtjes së kërkesë padisë të cilat kishin parashtrime të rrethanave të njëjta të deklaruara prej saj, të tilla si: “..... unë paditësi dhe bashkëshortja ime, në datat 30.3.2007 dhe 5.7.2007 kemi lidhur me subjektin tregtar NBG, dy kontrata kredie respektivisht për shumat 30.000 dhe 10.000 euro. Për garantimin e detyrimeve të marra përsipër nëpërmjet këtyre dy kontratave është hipotekuar në favor të Bankës trualli prej 170 m² mbi të cilin ishin ngritur, deri në momentin e marrjes së kredisë, dy kate të banesës së cituar më lart. Qëllimi i marrjes së kredisë ka qenë përfundimi i objektit të sipërcituar, konkretisht të katit të tretë dhe papafingos...”, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka disponuar me vendimin nr. (***) , datë 22.2.2011, për njohje pronar bashkëshortin e saj, trupi gjykues i gjen bindëse, pasi mbështesin vlerësimin dhe konkluzionet lidhur me këtë çështje, objekt vlerësimi.

1.58 Trupi gjykues, bazuar në arsyetimin e mësipërm për këtë pasuri, konkludon se subjekti ka kryer deklarim të saktë për kohën e ndërtimit dhe përfundimit në dhjetor të vitit 2007 të objektit/pasuri e disponuar prej saj, si dhe destinacionin e kredisë. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në të njëjtat referenca të arsyetuara gjatë hetimit administrativ, si dhe çmimeve të Entit Kombëtar të Banesave, kreu përlllogaritjet sipas udhëzimit nr. (***) , datë 4.4.2007, të EKB-së, ku kosto për sipërfaqe ndërtimi lekë/m² për vitin 2007 në Durrës ishte në vlerën 25.141 lekë dhe pasqyroi në tabelën e mëposhtme kostot e ndërtimit nga faza karabina në atë të përfunduar për dy pasuritë.

Tabela nr. 4

Përshkrimi	Sipërfaqe/m ²	Çmim sip. ndërtimi lekë/ m ² , Durrës	Vlera
Pasuria nr. (***) , z. k. (***) , h. (***) , ap. 3, sip. 94 m ² , lagja (***) , Rr. “(***)”	94	25,141	2,363,254
Pasuria nr. (***) , z. k. (***) , h. (***) , ap. 2, sip.187 m ² , lagja (***) Rr. “(***)”	187	17,599 (25.141 lekë x 70%) ⁵⁰	3,290,957
Total	281		5,654,211

Mbi këto kosto, Njësia e Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare⁵¹ për vitin 2007.

Tabela nr. 5

Nr.	Përshkrimi	2007
1	TË ARDHURA	1,309,438
	Të ardhura nga paga subjekti	671,767
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	637,671
2	SHPENZIME	(3,452,553)
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	409,860
	Shpenzime TIMS	338,548

⁵⁰Aplikuar 70 % e koston së ndërtimit sepse objekti ishte i ndërtuar deri në fazën karabina.

⁵¹ Pavarësisht se subjekti ka depozituar aktekspertizën e kryer nga inxh. E. M., i cili ka përlllogaritur vlerën e punimeve të kryera gjatë vitit 2007, në shumën 3.578.415 lekë, Komisioni i ka qëndruar çmimeve të EKB-së për sa kohë që subjekti nuk depozitoi asnjë dokumentacion provues për vlerën e shpenzuar për këtë pasuri.

	Shpenzime jashtë vendit karta e kreditit	130,985
	Shpenzime të tjera kredia në NBG	112,603
	Kredia “Tirana Bank” (principal + interes) (marrë në vlerën 500.000 lekë)	144,110
	Kredia NBG (principal+interes) (marrë në vlerën 30.000 euro)	(3,414,280)
	Kredia NBG (principal+interes) (marrë në vlerën 10.000 euro)	(1,174,381)
3	PASURI	4,809,607
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Banesë private nr. (***)ZK. (***), kati 3-të + papafingo (hipotekuar 17.9.2010)	5,654,211
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	(844,604)
	DIFERENCA (1-2-3)	-47,616

1.59 Lidhur me shlyerjen e kësaj kredie dhe shpenzimin e kryer për përshtatjen e pasurisë nr. (***) (apartament), në shumën rreth 25.500 euro, me burim kredinë e marrë në “Alpha Bank” në vitin 2016, Komisionit, nga analiza financiare e vitit 2016, i rezultoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 456.353 lekë. Trupi gjykues nga analizimi i provave në raport me kontestimet e subjektit, lidhur me këtë çështje vlerëson për sa vijon:

1.59.i Në lidhje me pretendimin e subjektit për të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat i bashkëshortit të cilave duhej t’i shtohet edhe vlera 49.010 lekë sepse ishin shpenzime të kryera përgjatë muajit janar të vitit 2017, trupi gjykues e merr në konsideratë këtë pretendim. Kjo për faktin se viti 2016 është viti i parë i aktivitetit, çka tregon që nuk ka pasur detyrime të mbartura nga viti i kaluar të cilat të jenë kryer gjatë vitit 2016 dhe se detyrimet tatimore për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor realisht paguhen në muajin janar të vitit pasardhës, sipas legjislacionit të fushës dhe se në bilancin vjetor këto janë shpenzime/detyrime të njohura për tu paguar në vitin pasardhës. Ky zë ul fitimin real të realizuar. Pas verifikimit të *statement* bankar të aktivitetit privat të bashkëshortit, konfirmohet shuma e paguar për detyrimet tatimore dhe si rezultat kjo shumë do t’i shtohet fitimit faktik të realizuar përgjatë vitit 2016.

1.59.ii Në lidhje me vlerën reale të shpenzuar për mobilimin e pasurisë, trupi gjykues konsideron dokumentacionin e depozituar prej subjektit, ku rezulton se faturat e depozituara (kryesisht TVSH-je) janë konform ligjit me të gjithë elementët përbërës dhe pasqyrojnë shpenzimet e kryera për qëllimin e deklaruar. Pavarësisht se subjekti në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe gjatë hetimit deklaroi shpenzimin rreth 25.500 euro, trupi gjykues vlerëson ta marrë në konsideratë këtë pretendim të paraqitur në prapësime. Kjo për faktin se për sa kohë pretendimi mbështetet në dokumentacione justifikuese, vlera e deklaruar më parë nga subjekti ka qenë gjithnjë e rrumbullakosur dhe duke marrë në konsideratë edhe fitim/humbje të mundshme nga kursi i këmbimit, pasi kredia është marrë në monedhën euro dhe shpenzimet janë kryer në monedhën lekë. Shuma e faturave të depozituara është 3.173.402 lekë.

1.59.iii Në lidhje me pretendimin mbi shumën e paguar për mbylljen e kredisë së marrë në NBG, subjekti në prapësime përllëgarit si shpenzim vetëm shumën e paguar me kredinë e marrë në “Alpha Bank” për të mbyllur kreditë në “Abi Bank” (ish-NBG). Trupi gjykues nuk vlerësoi të marrë në konsideratë këtë pretendim për faktin se në zërin e shpenzimeve të kredisë, në analizën financiare të pasqyruar në rezultatet e hetimit janë përllëgaritur përveç shumës së

paguar në qershor për t'i mbyllur këto kredi, edhe pagesat/këstet e kredive të kryera gjatë muajve janar – maj 2016.

1.59.iv Në lidhje me vlerën *neto* të kredisë së përfituar në “Alpha Bank”, trupi gjykues konstaton se përlllogaritjet e kryera nga subjekti nuk janë të sakta, pasi kredia e marrë në “Alpha Bank” është marrë në qershor të vitit 2016. Gjithashtu, gjatë këtij viti janë paguar këstet për muajt korrik – dhjetor. Po ashtu, subjekti kundërshton edhe kursin e këmbimit të përdorur nga Komisioni, duke i qëndruar kursit të këmbimit të datës së marrjes së kredisë. Njësia e Shërbimit Ligjor ka aplikuar kursin mesatar të këmbimit euro/lekë të fund vitit.

Si rezultat i arsyetimeve të mësipërme, analiza e re financiare, pasqyrohet në tabelën, si vijon:

Tabela nr. 6

Nr.	Përshkrimi	2016
1	TË ARDHURA	1,859,102
	Të ardhura nga paga subjekti	1,224,550
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	594,552
	Shitur automjeti benz për pjesë këmbimi	40,000
2	SHPENZIME	(1,519,012)
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	940,368
	Shpenzime shkollimi djali në shkollën E. K.	155,070
	Shpenzime <i>TIMS</i>	875,873
	Shpenzime mjekësore djali	84,138
	Shpenzime të tjera kredia në NBG	10,470
	Kredia NBG (principal+interes) (marrë në vlerën 30.000 euro)	3,041,808
	Kredia NBG (principal+interes) (marrë në vlerën 10.000 euro)	998,040
	Kredia “Alpha Bank” (principal+interes) (59.000 euro)	(7,624,779)
3	PASURI	3,509,474
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Banesë private nr. (***) ZK. (***), kati 3-të + papafingo (hipotekuar 17.09.2010) (përshtatur për banim)	3,173,402
	Automjet “Smart for Four” (bashkëshorti) (targa (***))	204,000
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	132,072
	DIFERENCA (1-2-3)	-131,360

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse dhe nga analiza e dokumentacionit të administruar, konkludon se provohet vërtetësia dhe mjaftueshmëria për sa i takon deklarimeve të subjektit për këtë pasuri, destinacionit të kredisë dhe ligjshmërisë së burimit të përdorur për përfitimin e kësaj pasurie. Po ashtu, edhe nga analiza financiare e kryer sipas tabelës nr. 5 rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të investuar në këtë pasuri dhe për të përballuar shpenzimet e tjera në vitin 2007, për shkak se diferenca e rezultuar është e papërfillshme. Gjithashtu, edhe për balancën negative të rezultuar në vitin 2016 (tabela nr. 6), trupi gjykues është shprehur në vlerësimin tërësor të kësaj vendimmarrje.

2. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjet në disa llogari bankare, si dhe gjendje *cash*, në vlerën 105.000 lekë, si e ardhur nga ushtrimi i profesionit të avokatit prej bashkëshortit, për të cilat për sa do të arsyetohet, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë.

Subjekti ka deklaruar:

2.1 Gjendje në llogarinë bankare nr. (*)**, në “Raiffeisen Bank”, datë 25.1.2017, në vlerën 125.084 lekë. Subjekti, për të provuar këtë deklaram, i ka bashkëlidhur⁵² deklaratës – *nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank”, në emër të Blerona Hasës, gjendje në datën 25.1.2017, në vlerën 125.084 lekë*. Me shkresën nr. (***) prot., datë 2.5.2019, “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar llogari rrjedhëse në emër të subjektit Blerona Hasa me gjendje në shumën 125.084,12 lekë, në datën 25.1.2017, dhe për rrjedhojë, konkludon se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe të mjaftueshëm, pasi nga verifikimi i dokumentacionit bankar konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur.

2.2. Llogari rrjedhëse në “Alpha Bank”, në emrin e subjektit dhe të bashkëshortit (ku derdhen kështu e kredisë, tepricë e tyre mujore), në vlerën 45 euro. Për të provuar këtë deklaram subjekti i ka bashkëlidhur⁵³ deklaratës – *vërtetimin nga “Alpha Bank”, ku vërtetohet se Blerona Hasa dhe L. Sh.kanë llogari me balancë në datën 24.1.2017, në vlerën 45 euro*. Trupi gjykues ka konstatuar se nga korrespondenca e mbajtur me “Alpha Bank”, me shkresën e datës 3.5.2019 konfirmohet se Blerona Hasa dhe L.Sh. disponojnë llogari me gjendje në datën 25.1.2017, në vlerën 45 euro dhe, për rrjedhojë, konkludon se subjekti ka kryer deklaram të saktë, pasi nga verifikimi i dokumentacionit bankar konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur.

2.3. Llogari rrjedhëse nr. (*)**, në vlerën 8.860 lekë, në “Raiffeisen Bank” (biznes i vogël) nga aktiviteti i bashkëshortit. Për të provuar këtë deklaram subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës, dokumentin – *nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank”,⁵⁴ në emër të L. Sh., gjendje në vlerën 8.760 lekë, në datën 25.1.2017*. Trupi gjykues edhe për këtë gjendje llogarie, vërejtë se me shkresën nr. (***)prot., datë 2.5.2019, “Raiffeisen Bank” konfirmoi llogari biznesi në emër të L. Sh. P.F me gjendje në shumën 8.860,82 lekë, në datën 25.1.2017 dhe, për rrjedhojë, konkludon se subjekti ka kryer deklaram të saktë, pasi nga verifikimi i dokumentacionit bankar konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur nga “Raiffeisen Bank”.

2.4. Gjendje *cash*, në vlerën 105.000 lekë, si e ardhur nga ushtrimi i profesionit të avokatit prej bashkëshortit. Subjekti në lidhje me këtë deklaram ka depozituar katër fatura⁵⁵ të prera nga aktiviteti privat i bashkëshortit si avokat, L.Sh. P.F., me NIPT(***)).

Nr. serisë	Data	Nr. i faturës	Vlera me TVSH (lekë)
(***)	5.1/2017	12	50,000
(***)	5.1/2017	13	70,000
(***)	16.1.2017	14	80,000

⁵² Referojuni Aneksit nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵³ Referojuni Aneksit nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁴ Referojuni Aneksit nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁵ Aneks 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së, të evidentuar të dhënat në tabelën e sipërcituar.

(***)	24.1.2017	15	50,000
TOTALI I FATURUAR			250,000

Nga dokumentacioni i depozituar, trupi gjykues ka konstatuar se shuma e faturuar deri në datën 25.1.2017 është në vlerën 250.000 lekë. Nisur nga fakti se ushtrimi i profesionit të avokatit, është një aktivitet që ka një *marzh* të lartë fitimi dhe faturat e depozituara nga subjekti e justifikojnë gjendjen *cash* të deklaruar, trupi gjykues në analizë të dokumentacionit të depozituar ka konstatuar se është i mundur krijimi i gjendjes *cash*, dhe për pasojë çmon se deklarimi i subjektit është i saktë, si dhe ka burime të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 105.000 lekë.

3. Deklarimi i detyrimeve financiare - kontratë huaje nr(***), datë 1.6.2016, nr. (***), lidhur me “Alpha Bank”, sipas të cilës është marrë hua shuma prej 59.000 euro, me normë interesi 4 %, me këst mujor në vlerën 438 euro. Trupi gjykues ka konstatuar se sipas dokumentacionit që i përket marrjes së kësaj kredie, rezulton se shuma është parashikuar të shlyhet për 180 muaj (15 vjet). Po ashtu, është cilësuar qëllimi i huas – likuidimi i dy huave në NBG. Konkretisht, subjekti ka deklaruar se shuma prej 28.824 euro, shërbeu për transferimin e pjesës së mbetur nga huat e marra më parë në NBG, specifikisht: (a) hua në shumën 30.000 euro, sipas kontratës nr. (***), datë 30.3.2007; dhe (b) hua në shumën 10.000 euro, sipas kontratës së huas nr(***), datë 5.7.2007. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se shuma prej 30.000 euro i shërbeu qëllimit të rikonstruksionit/përshtatjes për banim të pasurisë nr. (***). Për periudhën 7.6.2016 – 24.1.2017 është shlyer shuma 3.072 euro dhe ka mbetur detyrimi në shumën 57.331 euro. Nga korrespondenca e mbajtur me “Alpha Bank”⁵⁶, me shkresën datë 3.5.2019, trupi gjykues ka konfirmuar kredinë dhe detyrimin e mbetur në shumën 57.331,51 euro deri në datën 25.1.2017. Gjithashtu, ashtu siç është pasqyruar edhe në tabelën nr. 6, nga kjo kredi shuma prej 29.000 euro është transferuar për mbylljen e dy kredive në ish-NBG dhe pjesa tjetër për rikonstruksionin e apartamentit, kati i tretë. Nga analizimi dhe verifikimi i praktikës së kredisë bankare trupi gjykues konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur nga “Alpha Bank”, duke konkluduar për deklarime të sakta të subjektit lidhur me detyrimet financiare të sipërpërmendura.

GJETJE TË TJERA

4 . Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti ka marrë një kredi konsumatore në vitin 2005 në “Tirana Bank”.

4.1 Subjekti e ka deklaruar këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 me përshkrimin “*kredi nga Tirana Bank*”, në vlerën 500.000 lekë. Shkaku i marrjes: hua.

4.2 Komisioni e ka pyetur subjektin⁵⁷ se ndaj kujt i ka këto hua dhe në përgjigje ka deklaruar se: “... *shkaku “hua” i deklaratës së vitit 2005, nuk është “marrje huaje”, por është akumulim i detyrimit të papaguar, lindur nga blerja me porosi në të njëjtin vit, e disa pajisjeve për mobilim shtëpie nga personi juridik privat “G.C.” sh.p.k., lagjja (***), Durrës*”.

⁵⁶Kontratë huaje nr. (***), datë 3.6.2016, me “Alpha Bank”; kontratë hipoteke nr. (***), datë 3.6.2016; vërtetim, datë 24.1.2017, nga “Alpha Bank” (referojuni Aneksit nr. 4/2 dhe 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵⁷Pyetësori nr. 2, datë 31.1.2020.

4.3 Me shkresën nr. (***) prot., datë 3.5.2019, “Tirana Bank” konfirmon se ka nënshkruar kontratë për hua konsumatore nr. (***), datë 29.8.2005, dhe nr. (***), datë 29.8.2005, me shtetasit L. dhe I. Sh. . Sipas kësaj kontrate qëllimi i huas ka qenë për mobilim shtëpie.

4.4 Komisioni kreu analizën financiare të vitit 2005, për kohën kur është marrë kjo kredi, treguesit e të cilës pasqyrohen në tabelë së bashku me shpenzimet përkatëse, si vijon:

Tabela nr. 7

Nr.	Përshkrimi	2005
1	TË ARDHURA	949,703
	Të ardhura nga paga subjekti	577,509
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	372,194
2	SHPENZIME	371,862
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	328,671
	Shpenzime mobilimi nga kredia “Tirana Bank”	495,000
	Kredia “Tirana Bank” (principal + interes) (500.000 lekë)	(451,809)
3	PASURI	766,305
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	766,305
	DIFERENCA (1-2-3)	-188,464

4.5 Nisur nga përllogaritjet financiare të pasqyruar në tabelën nr. 7, të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi dukej se nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 188.464 lekë në vitin 2005, që të kryente mobilimin, si dhe të përballonte shpenzime të tjera familjare.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

4.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, si dhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera, ka kontestuar përllogaritjet e Komisionit duke parashtruar se: (i) në analizën financiare të kryer për vitin 2005, nuk ishin përllogaritur saktë të ardhurat e bashkëshortit si punonjës i Drejtorisë së Antikontrabandës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave; (ii) në të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortit, përfshiheshin edhe shpërblimi bazuar në një % fikse mbi gjobat e vendosura ndaj subjekteve të ndryshme, si dhe shpërblime të ndryshme në bazë të rezultateve të arritura në punë, duke kontestuar në këtë mënyrë vlerën e të ardhurave të punës së tij, pasi sipas saj të dhënat nga “Raiffeisen Bank”, tregojnë se pagat dhe shpërblimet e tjera të bashkëshortit të përfituara nga puna si punonjës i Drejtorisë së Antikontrabandës nuk ishin në shumën 372.194 lekë, por në shumën 946.356 lekë. Ky fakt konfirmohet me vërtetimin nr. (***)prot., datë 4.6.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nga ku rezulton se të ardhurat *neto* nga paga janë në shumën 317.484 lekë, shpërblime 178.872 lekë dhe dieta në shumën 450.000 lekë. Në total vlera e të ardhurave të realizuara nga bashkëshorti për vitin 2005, janë në shumën 946.356 lekë; (iii) lidhur me dietat subjekti ka parashtruar se në vitin 2005, bashkëshorti i subjektit nuk mund të shpenzonte edhe shumën e llogaritur si shpenzim

për jetesë edhe dietat e përfituar për të njëjtin qëllim dhe, për rrjedhojë, përfshirja e shpenzimeve të bashkëshortit për jetesë në shpenzimet e përgjithshme të familjes së saj në vitin 2005, diktonte përjashtimin e përlllogaritjes së dietave, si shpenzim për jetesë. Nëse Komisioni, sipas subjektit, do të vlerësonte të përfshinte dietat e përfituara nga bashkëshorti si shumë për mbulimin e shpenzimeve të tij për jetesë në vitin 2005, atëherë duhet të zbresë nga shpenzimet e përgjithshme të familjes për këtë vit, ato të bashkëshortit që përkonin me shumën 109.557 lekë dhe për pasojë balanca do të rezultonte pozitive në vlerën 45.255 lekë. Në konsideratë të kontestimeve të saj, subjekti ka konkluduar se analiza financiare do të pasqyronte një rezultat pozitiv sipas përlllogaritjeve të paraqitura në formë tabelare prej saj.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.7 Trupi gjykues, nisur nga analizimi i provave të administruara në dosje, konstatimet e bëra në rezultatet e hetimit, si dhe kontestimet e paraqitura, në tërësi të kësaj çështjeje, nën arsyetimin e analizimit të pretendimeve të subjektit, çmon si vijon:

4.8 Lidhur me pretendimin e subjektit sikurse është referuar në pikën **4.6 (ii)**, se vlera në përlllogaritjet e Komisionit duhet të referojë vlerë më të lartë të të ardhurave të punës së bashkëshortit të saj si punonjësi i Drejtorisë së Antikontrabandës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, trupi gjykues arsyeton se dokumenti zyrtar i punëdhënësit, vërtetimi nr. (***)prot., datë 4.6.2020, i kësaj drejtorie, ka konfirmuar shumën e të ardhurave nga paga dhe shpërblimet në vlerën 496.473 lekë, që korrespondon me shumën e kreditimeve në llogarinë në “Raiffeisen Bank” të bashkëshortit dhe, për rrjedhojë, vlerësoi ta marrë në konsideratë dhe të kryejë rillogaritjet në analizën financiare të vitit 2005.

4.9 Lidhur me pretendimin e subjektit sikurse është referuar në pikën 4.6 (iii), për rillogaritje të dietave, ashtu siç është shprehur edhe Kolegji në disa vendimmarrje të tij, është një e ardhur e cila nuk mund të merret në konsideratë për faktin sepse jepet për t’u shpenzuar. Duke qenë se nuk është e qartë nëse bashkëshorti i subjektit i ka përfituar këto dieta duke qëndruar larg qendrës së banimit apo nëse është kthyer brenda ditës, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të reduktojë shpenzimet e jetesës sipas pretendimit të subjektit, meqenëse është marrë dieta, sepse shpenzimet e jetesës nuk përfshijnë në vetvete vetëm zërin e ushqimit apo fjetjes (nëse ka qëndruar larg qendrës së banimit).

Si rezultat i këtij arsyetimi, përlllogaritjet financiare sipas analizës përkatëse rezultojnë në balancë negative nga shuma 188.464 lekë në shumën 64.185 lekë. Për këtë balancë negative, trupi gjykues është shprehur në vlerësimin tërësor të kësaj vendimmarrjeje.

5. Në vijim, Komisioni ka hetuar mbi investimin e bashkëshortit të subjektit në vitin 2013 me blerjen e një automjeti tip “Daimler Chrysler” me targa (***). Komisionit, nga hetimi për këtë pasuri, i ka rezultuar se:

5.1 Në deklaratën periodike të vitit 2013 subjekti ka deklaruar automjet tip “Mercedes Benz”, i përdorur, prodhim i vitit 1996, blerë nga bashkëshorti më 10.11.2013, kundrejt vlerës 1.500 euro. Për taksën e zhdoganimit dhe taksat e tjera është paguar shuma prej 68.000 lekësh. Burimi i të ardhurave: dhuratë e shumave të përfituara nga kompensimi financiar mbi pasuritë e njohura nga AKKP-ja, nga babai i deklaruesit.

5.2 DPSHTRr-ja, me shkresën nr. (***) , datë 7.5.2019, i ka përcjellë informacionin Komisionit se ky automjet ishte zhdoganuar me deklaratë doganore(***) , datë 14.11.2013, me dërgues I.V. dhe marrës L. Sh. . Vlera e automjetit: 1.500 euro. Dogana ka bërë rivlerësim dhe e ka vlerësuar automjetin në shumën 250.000 lekë dhe mbi këtë vlerë janë përlllogaritur detyrimet tatimore. Totali i paguar për zhdoganim rezulton në vlerën 54.202 lekë.

5.3 Komisioni e ka pyetur⁵⁸ subjektin për burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave dhe, në përgjigje depozitoi *kthim përgjigje*⁵⁹ nëpërmjet portalit *e-albania* nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, ku shtetasi F. H. ishte trajtuar me 70 % të vlerës së përgjithshme të miratuar në VKM nr. 120, datë 17.2.2011, në vlerën 1.434.720 lekë, e cila ka kaluar në llogarinë bankare të z. F. H. me nr. llogarie (***) , në “Raiffeisen Bank”.

5.4 Komisioni mbajti korrespondencë me “Raiffeisen Bank”, e cila me shkresën nr(***)prot., datë 24.2.2020, i konfirmoi se shtetasi F. H. kishte qenë klient i bankës dhe kishte pasur një “numër personal” (***) , që, aktualisht, rezultonte i mbyllur dhe njëkohësisht dërgoi lëvizjet e llogarisë me nr. (***) , nga ku rezultonte me veprime fillestare nga viti 2016. Ndërkohë u vërejt se shuma e sipërcituar 1.434.720 lekë nuk konfirmohej të kishte kaluar në llogarinë e përmendur në shkresën e ATP-së.

5.5 Gjithashtu, ndër informacionet e përcjella me shkresën nr. (***)prot., datë 6.5.2019, nga ATP-ja rezultonte e administruar një shkresë me nr. (***) prot., datë 22.12.2011, drejtuar shtetasit F. H. ku, ndër të tjera, citohej se vlera që përfitohej nga ky kësht ishte në shumën 757.122,24 lekë, në numrin e llogarisë bankare IBAN (***) në “ProCredit Bank” në emër të shtetasit F. H. .

5.5.i Në këtë dosje gjendej e administruar edhe një kërkesë e shtetasit F. H. që datonte më 16.6.2013, ku ATP-ja sqarohej se numri i llogarisë në “ProCredit Bank”, ku ishte kryer pagesa, rezultonte i mbyllur dhe se shuma ishte kthyer prapa. Për këtë arsye, shtetasi F. H., nëpërmjet kësaj shkrese kishte vënë në dispozicion numrin e ri të llogarisë.

5.5.ii Komisioni mbajti korrespondencë me bankat e nivelit të dytë për të konfirmuar marrjen e shumës prej 1.434.720 lekësh nga ATP-ja. Gjatë hetimit rezultoi se babait të subjektit, shtetasit F. H., i ishte transferuar shuma prej 1.434.720 lekësh, në “ProCredit Bank”⁶⁰ përgjatë viteve 2011, 2013 dhe 2016.

5.6 Subjekti, gjatë hetimit, ka deklaruar se një pjesë të shpenzimeve për trajtimin mjekësor të djalit ia ka mbuluar babai. Më konkretisht, subjekti është shprehur: *“udhëtimi dhe të gjitha shpenzimet e tjera, për ndërhyrjet në vitet 2013 dhe 2015 janë financuar nga i ndjeri babai im”*.

5.7 Komisioni e ka pyetur për burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave dhe, në përgjigje, subjekti depozitoi dokumentacionin:

- shkresë⁶¹ nr. (***) prot., datë 17.7.2019, nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, ku shtetasi F. H. kishte përfituar shpërblime në shumën prej 270.000 lekësh nga kontrata datë

⁵⁸Pyetësor nr. 2, datë 31.1.2020.

⁵⁹Dokumentacion i depozituar në pyetësorin nr. 2, datë 31.1.2020.

⁶⁰Shkresë nr. (***)prot., datë 28.2.2020, nga “ProCredit Bank”.

⁶¹Pyetësori nr. 4, datë 21.2.2020.

15.8.2003, në projektin filmik “Mao ce Dun” dhe shumë prej 180.000 lekësh nga kontrata datë 19.8.2004, në projektin filmik “kronikë provinciale”;

- vërtetim nr. (***) prot., datë 19.7.2019, nga ISSH-ja Drejtoria Rajonale Durrës, ku shtetasi F. H. ka përfituar pension pleqërie për periudhën 1.5.1993 – 16.7.2018 dhe të ardhurat e përfituara nga pensioni në total rezultojnë në shumë 6.820.900 lekë.

5.8 Komisioni hetoi dhe analizoi dokumentacionin e depozituar, nga ku rezultoi se:

5.8.i Sipas shkresës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nuk konfirmohet saktësisht, nëse shumat e përfituara ishin tatuar apo jo. Po ashtu, Komisioni vlerësoi se duke iu referuar kohës së largët të përfitimit të shumave në vitet 2003 dhe 2004, në raport me shumën e dhuruar duket se nuk jepej mundësia e kursimit dhe ruajtjes së tyre për mbi 10 vjet.

5.8.ii Sipas shkresës së ISSH-së, u vërejt se babai i subjektit rezultonte në pension që nga viti 1993.

5.8.iii Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësitë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit, shtetasi F. H., duke përfshirë të ardhurat nga pensioni për secilin vit sipas shkresës së ISSH-së Durrës⁶² dhe të ardhurat e tjera të përfituara nga ATP-ja, si dhe honorare⁶³. Shpenzimet e jetesës u përlogaritën 70 % e të ardhurave për vitet 1993 – 1996, në vlerën 5.000 lekë për frymë/muaj, për vitet 1997 – 2001 dhe sipas shkresës së ILDKPKI-së për vitet 2002 – 2016. Dhurimet u përlogaritën sipas deklaramit të subjektit, ndërsa shpenzimet mjekësore dhe udhëtimi u llogaritën sipas metodologjisë së përdorur nga Komisioni.

Tabela nr. 8

Viti	Pensioni (1)	Pension i posaçëm (2)	Të ardhura të tjera (3)	TOTALI (4) (1+2+3)	Shpenzime jetese (5)	Dhurimet (6)	Kursimi akumulativ (4-5-6)+viti paraardhës
1993	12,146			12,146	8,502		3,644
1994	28,446			28,446	19,912		12,178
1995	35,241			35,241	24,669		22,750
1996	45,216			45,216	31,651		36,315
1997	47,616			47,616	60,000		23,931
1998	56,042			56,042	60,000		19,973
1999	70,728			70,728	60,000		30,701
2000	79,494			79,494	60,000		50,195

⁶²Shkresë nr(***) prot., datë 11.3.2020, nga ISSH-ja Drejtoria Rajonale Durrës.

⁶³Shkresë nr. (***)prot., datë 4.3.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

2001	101,382			101,382	60,000		91,577
2002	109,632			109,632	93,864		107,345
2003	119,634			119,634	93,864		133,115
2004	129,426			129,426	93,864		168,677
2005	148,283			148,283	109,557		207,403
2006	161,676	49,401		211,077	109,557		308,923
2007	167,964	202,524		370,488	136,620		542,791
2008	179,904	217,848		397,752	136,620		803,923
2009	197,444	240,428		437,872	136,620		1,105,175
2010	206,040	251,448		457,488	136,620		1,426,043
2011	213,900	261,510	962,312	1,437,722	136,620		2,727,144
2012	222,048	271,932	180,000	673,980	141,024		3,260,100
2013	231,980	284,692	204,460	721,132	141,024	711,564	3,128,645
2014	236,284	290,784	18,000	545,068	219,998		3,453,715
2015	240,107	295,859		535,966	224,276	904,636	2,860,769
2016	244,226	300,200	265,948	810,374	235,092		3,436,051

5.9 Nën arsyetimin e çdo dokumentacioni të cituar më sipër, Komisioni ka marrë në konsideratë financimet e kryera nga babai i subjektit të vlerësimit dhe, në vijim, konstatoi se i ndjeri babai i saj kishte mundësi financiare, si dhe provohej burimi i ligjshëm i tyre.

5.10 Komisioni kreu analizën financiare të vitit 2013 kur është investuar për këtë pasuri të paluajtshme, e cila pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 9

Nr.	Përshkrimi	2013
1	TË ARDHURA	2,204,372
	Të ardhura nga paga subjekti	929,084
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	563,724
	Të ardhura nga dhurimi (babai) për blerjen e mjetit + mjekimi i djalit	711,564
2	SHPENZIME	1,823,859
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	564,096
	Shpenzime zhdoganimi + taksa për automjetin "Benz"	68,000
	Shpenzime <i>TIMS</i>	478,102
	Shpenzime mjekësore djali	147,221
	Shpenzime të tjera kredia në NBG	14,470
	Kredia NBG (principal + interes) (marrë në vlerën 30.000 euro)	424,798

	Kredia NBG (principal + interes) (marrë në vlerën 10.000 euro)	127,173
3	PASURI	185,339
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet tip “Benz” (bashkëshorti) (10.11.2013) (***)	210,315
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	(24,976)
	DIFERENCA (1-2-3)	195,174

✓ Në përfundim, bazuar në provat e analizuara më sipër dhe në përlllogaritjet financiare të kryera për këtë pasuri, trupi gjykues konkludon se subjekti: (i) ka kryer deklarime të sakta, (ii) ka pasur mundësi financiare në vitin 2013 për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të përballuar të gjitha shpenzimet e tjera familjare.

6. Hetimi i Komisionit u përqendrua edhe në pasurinë e paluajtshme të investuar në vitin 2016, si dhe në mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimeve të përdorura për ristrukturimin dhe mobilimin e apartamentit në katin e tretë, kjo e fundit e trajtuar te pasuria e identifikuar me nr.1.

6.1 Për sa më sipër, rezulton se në lidhje me këto investime, në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: **(a)** blerjen e automjetit sipas faturës tatimore nr. (***) , datë 12.10.2016, lëshuar nga subjekti “M.-A.” sh.p.k., ku bashkëshorti ka blerë automjet të tipit “Smart For Four”, vit prodhimi 2005. Për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer kursimet e të ardhurave nga pagat dhe aktiviteti i bashkëshortit. Vlera: 204.000 lekë; **(b)** përshtatjen për banim të pasurisë nr. (***) (apartament), e cila përfshinte vendosje vetratash duralumini, dyer të brendshme, shtrim me pllaka, sistem kondicionimi, hidrosanitare, elektroshtëpiake, ndriçim, mobilim etj., në shumën rreth 25.500 euro. Burimi i krijimit: kredi e marrë në “Alpha Bank”.

6.2 Në lidhje me pasurinë automjet tip “Smart For Four”, blerë me faturë tatimore nr. (***) , datë 12.10.2016, lëshuar nga subjekti “M.-A.” sh.p.k., përshkruar në pikën 6.1 (a). Nga hetimi i Komisioni ka rezultuar se:

6.2.1 DPSHTRr-ja, me shkresën nr. (***) , datë 7.5.2019, ka përcjellë informacionin se automjeti tip “Smart for Four”, me targa (***) ishte blerë në shumën 204.000 lekë, me faturë nr. (***) , datë 12.10.2016, me shitës “M.-A.” sh.p.k. dhe blerës shtetasi L. Sh..

6.2.2 Ky automjet ishte shitur përpara dorëzimit të deklaratës *Vetting*, konfirmuar me kontratë shitje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 10.1.2017, me palë shitëse shtetasin L. Sh. dhe palë blerëse shtetasen M. H. . Çmimi i shitjes: 250.000 lekë.

6.3 Në lidhje me përshkrimin e pasurisë në pikën 6.2 (b), Komisioni i ka sqaruar në detaje në pikën nr. 1 faktet e dala në rezultatet e hetimit administrativ dhe e ka arsyetuar në pikën 1.59, ndaj çmon të mos përsëritet.

✓ Në përfundim, trupi gjykues konkludon se për pasurinë automjet tip “Smart For Four”, subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe se kjo pasuri konfirmohet si e blerë dhe e shitur nga DPSHTRr-ja, sipas deklarimeve të subjektit.

7. Komisioni, përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare ndër vite, nga ku në përlllogaritjet e kryera deri në rezultatet e hetimit kryesisht, rezultoi balancë negative për

vitet 2009, 2012, 2014 dhe 2015, në shumën 1.223.804 lekë dhe për këtë, subjekti është sqaruar që në rezultatet e hetimit se ai/rezultati mund të ndryshonte nëse do të justifikoheshin të ardhurat e përfituara nga babai i bashkëshortit. Përlllogaritjet e kryera iu bënë me dije subjektit sipas tabelës së mëposhtme, duke renditur në vijim edhe faktet e dala.

Tabela nr. 10

Nr.	Përshkrimi	2009	2012	2014	2015
1	TË ARDHURA	1,232,089	1,480,842	2,002,035	2,953,654
	Të ardhura nga paga subjekti	674,737	909,495	1,226,611	1,208,972
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	557,352	571,347	775,424	840,046
	Të ardhura nga dhurimi (babai) paketë udhëtimi në Norvegji (17.7.2015 - 23.7.2015) + mjekimi i djalit				904,636
2	SHPENZIME	1,675,613	1,673,045	2,155,444	3,242,110
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	409,860	564,096	879,992	897,104
	Shpenzime shkollimi djali në shkollën “E. K.”	-	-	294,231	439,285
	Shpenzime TIMS	437,885	352,793	318,750	1,308,886
	Shpenzime jashtë vendit karta e kreditit	98,745	-	-	-
	Shpenzime mjekësore për djalin	104,994	152,548	145,995	114,525
	Shpenzime të tjera, kredia në NBG	13,580	14,307	14,613	14,164
	Kredia në “Tirana Bank” (principal + interes) (500.000 lekë)	136,188	-	-	-
	Kredia në NBG (principal + interes) (30.000 euro)	364,417	462,074	374,807	349,226
	Kredia në NBG (principal + interes) (10.000 euro)	109,943	127,228	127,056	118,920
3	PASURI	(53,260)	160,905	25,872	12,693
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	(53,260)	160,905	25,872	12,693
	DIFERENCA (1-2-3)	-390,264	-353,108	-179,282	-301,150

7.1 Komisioni, në këtë analizë, paraprakisht, ka vërejtur se subjekti nuk ka kryer investime në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme gjatë këtyre viteve, por kishte shpenzime më të larta sesa të ardhurat vjetore.

7.2 Në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të trajtimeve mjekësore gjatë vitit 2013 dhe 2015 nga babai i subjektit, Komisioni, këto shpenzime i përfshiu te zëri “shpenzime mjekësore për djalin”, të cilat u morën në konsideratë pasi babai i subjektit rezultoi se kishte mundësi të financonte me burime të ligjshme sikurse është konstatuar dhe arsyetuar në pikën nr. 5.

7.3 Po ashtu, Komisioni konstatoi se në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar edhe disa dhurime të tjera: paketë udhëtimi në Norvegji në vitin 2015, dhuruar nga babai në

shumën 4.000 euro; dy këste për shkollimin e djalit në shkollën “E. K.”, paguar nga vjehri, në shumën 2.900 euro.

7.3.i Komisioni, lidhur me dhurimet e kryera, pas analizimit të dokumentacionit të depozituar, sikurse e ka trajtuar në pikën 5.8.iii, i ka rezultuar se babai i subjektit ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të dhuruar shumën 4.000 euro në vitin 2015 dhe, për pasojë, i ka përfshirë në analizën financiare.

7.3.ii Në lidhje me dhurimin e kryer nga vjehri për pagesën e shkollës së djalit në vitin 2015, Komisioni e ka pyetur subjektin për burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, e cila⁶⁴ i ka justifikuar nëpërmjet depozitimit të kontratës së shitblerjes së automjetit nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 31.5.2010, me palë shitëse shtetasin I. Sh. dhe palë blerëse shtetasin A. V. . Vlera: 6.000 euro.

7.3.ii.a Komisionit, nisur nga hetimi dhe nga korrespondenca e mbajtur me institucionet tatimore, i ka rezultuar se vjehri i subjektit, shtetasi I. Sh., ka pasur aktivitet tregtar. Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, me shkresën nr. (***) prot., datë 10.5.2019, ka informuar se shtetasi I. Sh. figuron i regjistruar me NIPT (***) , me objekt “aktivitet tregti me shumicë e artikujve të përzierë, ushqimorë dhe duhan”. Nga verifikimi i dokumentacionit, në dosjen e subjektit, rezulton “kërkesë për mbylljen e aktivitetit” me datë 25.3.2002.

7.3.ii.b Gjithashtu, po kjo drejtori informon se subjekti E.I.R., me NIPT (***) ka administrator shtetasin I. Sh., me objekt “aktivitet tregti me shumicë e artikujve të përzierë, ushqimorë, pije dhe duhan” me status të çregjistruar që më 9.3.2009.

7.3.ii.c Komisioni, nga informacioni i disponuar mbi të ardhurat e ligjshme të vjehrit të subjektit, konstatoi se ky i fundit nuk kishte të ardhura që nga viti 2009 dhe në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, si dhe nga ai i rezultuar gjatë hetimit, në raport me kohën (viti 2015) kur është kryer dhurimi dhe kohën (viti 2010) kur ishin përfituar të ardhurat, vlerësoi t’i kalojë subjektit barrën e provës, pasi: (i) mungonte dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 2.900 euro, të dhënë nga vjehri i subjektit, e cila ndikonte në analizën financiare të vitit 2015; si dhe (ii) nga analiza financiare për vitet 2009, 2012, 2014 dhe 2015 dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 1.223.804 lekë për të përballuar të gjitha shpenzimet familjare.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni, të konkluduara në pikën 7.3.ii.c

7.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka shpjeguar dhe depozituar dokumentacion, për sa referohet në vijim:

7.4.1 Mbi konstatimin e mungesës së dokumentacionit justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 2.900 euro, si financim i kryer nga vjehri për dy këstet e shkollës së djalit, përveç kundërshtimit të argumentit⁶⁵ të Komisionit si në pikën 7.3.ii.c, për të provuar të ardhurat e ligjshme të përfituara nga vjehri, subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë dhe, konkretisht:

⁶⁴ Pyetësori nr. 2, datë 31.1.2020.

⁶⁵ Referojuni parashtrimeve të subjektit, datë 11.6.2020.

a) shkresat me nr. (***) dhe nr. (***), datë 3.6.2020, të lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Durrës, në bazë të të cilave, sipas subjektit, vërtetohen të ardhurat nga pensioni i vjehrrit dhe vjehrrës, nga viti 2010 e në vazhdim;

b) kontratën e qirasë me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 18.8.2008, me objekt “dhënie me qira të ambientit me sip. 110 m², lidhur me afat 2-vjeçar, nga data e nënshkrimit të kontratës me çmim 25.000 lekë/muaj”;

c) kontratën e qirasë nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 14.9.2015, me objekt “dhënie me qira të ambientit me sip. 61 m²”, lidhur me afat 6-mujor me efekt nga data 15.9.2015 dhe çmim 19.000 lekë/muaj;

ç) *statement* të llogarisë bankare, çelur në emër të vjehrrit në “Raiffeissen Bank”, nga e cila, sipas subjektit, vërtetohet se vjehri ka përfituar shumën prej 104.999 lekësh, në datën 24.5.2010 dhe po të njëjtën shumë më 25.1.2015, në zbatim të VKM-së nr. 707, datë 23.6.2009, “Për miratimin e dëmshtëpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, botuar në Fletoren Zyrtare me nr. 95, datë 26.6.2009, nr. rendor 780. Me depozitim edhe të këtyre provave, veç atyre të dërguara gjatë hetimit administrativ, subjekti ka parashtruar se dokumentacioni i dërguar prej saj vërteton përtej çdo dyshimi se vjehri ka pasur të ardhura të mjaftueshme, të krijuara nga burime të ligjshme për të justifikuar në vitin 2015, financimin e dy kësteve të shkollës së nipit, në shumën 2.900 euro dhe, për pasojë, përllogaritja e saj në analizën financiare të vitit 2015, në përfundim rezultonte pozitive.

7.4.2 Mbi konstatimin e Komisionit se përveç vitit 2015, sipërtrajtuar, nga analiza financiare dukej se subjekti rezultonte me disa balanca negative edhe për vitet 2009, 2012 dhe 2014, si dhe në parashtrime ka kundërshtuar përllogaritjet e Komisionit, pasi sipas saj rezulton se:

7.4.2.i Për vitin 2009 shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme për trajtimin mjekësor të djalit, në Itali, ishin financuar nga i ndjeri, babai i saj, përkatësisht, vlerat e shpenzimeve mjekësore në shumën 104.994 lekë dhe vlera e shpenzimeve të udhëtimit për mjekim në shumën 318.688 lekë. Subjekti ka parashtruar në mënyrë tabelare përllogaritjet e kryera prej saj, ku shprehet se shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit, i ka referuar sipas përcaktimeve të dhëna nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim KPA), në vendimin nr. 11, datë 22.5.2019.

7.4.2.ii Për vitin 2012, subjekti ka kundërshtuar përllogaritjet e Komisionit për zërin e shpenzimeve të jetesës sipas ILDKPKI-së. Edhe për këtë vit, subjekti ka parashtruar në mënyrë tabelare përllogaritjet e kryera prej saj, ku shprehet se edhe shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i ka referuar sipas përcaktimeve të dhëna nga KPA-ja, në vendimin⁶⁶ nr. 11, datë 22.5.2019.

7.4.2.iii Ashtu si për vitin 2012, edhe për vitin 2014, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare edhe lidhur me metodologjinë e aplikuar⁶⁷ nga Komisioni sa i takon shpenzimeve të jetesës, për shkak të llogaritjes së tyre dy herë, pasi sipas subjektit, Komisioni i klasifikon

⁶⁶ Në këtë vendim përcaktohet se: “Biletat e udhëtimeve vajtje-ardhje, me destinacion Italinë, përveç fluturimeve me operatorin ajror “Al Italia”, përllogariten: (i) për të rritur (12+ vjeç) në vlerën 100 euro; (ii) për foshnjat (0- 2 vjeç) në vlerën 10 euro (10 % e biletës së të rriturit); (iii) për fëmijët (2-12 vjeç) në vlerën 75 euro (75 % e biletës së të rriturit);

⁶⁷ Referojuni parashtrimeve të subjektit f. 23 dhe 24, dërguar në datën 11.6.2020, ku pasqyrohen të detajuara e me krahasime kontestimet e metodologjisë së Komisionit për shpenzimet jetike.

shpenzimet e jetesës duke iu referuar raportit të ILDKPKI-së, që referon në Anketën e Buxhetit të Familjes dhe në Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës, të cilat i kanë shërbyer si e dhënë orientuese në përlllogaritjen e shpenzimeve mesatare për frymë, në kushtet e mosmiratimit të minimumit jetik.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.5 Trupi gjykues, nisur nga analizimi i provave të administruara në dosje, konstatimet e bëra në rezultatet e hetimit, si dhe kontestimet e paraqitura nga subjekti, në tërësi të kësaj çështjeje, arsyeton se:

Në lidhje me pretendimin se shpenzimet e udhëtimit dhe të mjekimit të djalit për vitet 2009 - 2010 janë paguar nga babai i saj, subjekti ka sqaruar se nuk është pyetur për këto vite gjatë hetimit administrativ dhe se pyetëtori standard ka qenë i përcaktuar për periudhën kohore 2011 – 2017 dhe për këtë arsye ka deklaruar vetëm vitet që ndodheshin brenda kësaj periudhe. Trupi gjykues vlerësoi ta marrë në konsideratë këtë pretendim, pasi ashtu siç është shprehur edhe në rezultatet e hetimit, babai i subjektit provonte me burime të ligjshme financimet e kryera për mjekimin e nipit të tij, si dhe shpenzimet e udhëtimit. Njësia e Shërbimit Ligjor, pasi kreu analizën e re financiare për vitin 2010, konstaton se subjekti ndodhet në balancë pozitive.

Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit mbi numrin e anëtarëve të familjes në vitin 2012, për të cilët ishin kryer përlllogaritjet financiare për shpenzimet e jetesës, pas verifikimit të dokumenteve të depozituara prej saj, Komisioni vlerësoi marrjen në konsideratë të tyre dhe pasqyrimin e këtij pretendimi në analizën e re financiare.

Në lidhje me pretendimin se shuma prej 2.900 euro, për shkollimin e djalit është paguar nga vjehri, subjekti ka depozituar dokumente mbi aktivitetet private të tij, dokumentacion për të ardhurat nga pensioni për të dhe nënën e bashkëshortit, kontrata qiraje për vitet 2015, 2016 dhe 2018, si dhe kontratën e shitjes së automjetit në vitin 2010. Trupi gjykues verifikoi provat dhe dokumentacionet e reja të depozituara për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj shume, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e ligjshme, të cilat përkonin me kohën në të cilën ishte kryer pagesa. Nga analizimi i dokumentacionit rezultoi se provohej me burim të ligjshëm shuma prej 2.900 euro, me burim krijimi nga të ardhurat e përfituara nga pensioni i të dy prindërve të bashkëshortit, të ardhurat nga dëmshpërblimi i ish-të dënuarve politikë, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit që në raport me shpenzimet e jetesës dhe dhurimin e bërë, mundësojnë krijimin e kësaj shume. Ndërsa, pretendimet për të përfshirë në analizë të ardhurat nga kontratat e qirasë nuk u morën në konsideratë, pasi datojnë pas pagesave të këstit të shkollimit.

Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën e re financiare pas marrjes në konsideratë të pretendimeve të subjektit, nga ku rezultoi:

Tabela nr. 11

Nr.	Përshkrimi	2009	2012	2014	2015
1	TË ARDHURA	1,627,198	1,480,842	2,002,035	3,352,839
	Të ardhura nga paga subjekti	674,737	909,495	1,226,611	1,208,972

	Të ardhura nga paga bashkëshorti	557,352	571,347	775,424	840,046
	Dhuratë nga babai për shpenzime udhëtimi + mjekimi i djalit	395,109	-	-	-
	Dhuruar nga babai paketë udhëtimi Norvegji (17.7.2015-23.7.2015) + mjekimi i djalit	-	-	-	904,636
	Paguar dy këste të shkollës së djalit "E. K." nga vjehri	-	-	-	399,185
2	SHPENZIME	1,675,613	1,532,021	2,155,444	3,242,110
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	409,860	423,072	879,992	897,104
	Shpenzime shkollimi djali në shkollën "E. K."	-	-	294,231	439,285
	Shpenzime TIMS	437,885	352,793	318,750	1,308,886
	Shpenzime jashtë vendit karta e kreditit	98,745	-	-	-
	Shpenzime mjekësore djali	104,994	152,548	145,995	114,525
	Shpenzime të tjera kredia në NBG	13,580	14,307	14,613	14,164
	Kredia "Tirana Bank" (principal + interes) (500.000 lekë)	136,188	-	-	-
	Kredia NBG (principal + interes) (30.000 euro)	364,417	462,074	374,807	349,226
	Kredia NBG (principal + interes) (10.000 euro)	109,943	127,228	127,056	118,920
3	PASURI	(53,260)	160,905	25,872	12,693
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme				
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	(53,260)	160,905	25,872	12,693
	DIFERENCA (1-2-3)	4,845	-212,084	-179,282	98,035

- ✓ Në përfundim, trupi gjykues, pas analizimit të provave shtesë të paraqitura nga subjekti, vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, çmon se: (i) subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të financuesve të saj (përkatësisht babait dhe vjehrit) në lidhje me shpenzimet e mjekimit, udhëtimet për vitet 2009 dhe 2010, këstin e shkollimit; si dhe (ii) për faktin se pas rillogaritjeve të kryera, balanca financiare për vitet 2009 dhe 2015 rezultoi pozitive, ndërsa për vitet 2012 dhe 2014 rezultoi negative, përkatësisht, në shumat 212.084 lekë dhe 179.282 lekë. Duke qenë se pamundësia financiare është në vlera të ulëta, por dhe e shpërndarë përgjatë dy viteve, trupi gjykues çmon se ato nuk passjellin ndonjë konkluzion për mospërmbushje të kriterëve të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Hetime të tjera

8. Në lidhje me shpenzimet e kryera gjatë kohës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare në Korçë (vitet 2002 – 2009)

8.1 Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e kryera përgjatë kohës (vitet 2002 – 2009) së ushtrimit të detyrës, në cilësinë e gjyqtares, në Korçë, pra, duke mbajtur në vëmendje këtu banimin etj.

8.2 Subjekti, në përgjigjen⁶⁸ e dhënë, ka deklaruar se nuk ka pasur shpenzime dhe se ka banuar në banesën e shtetas L. S. .

8.3 E pyetur në lidhje me marrëdhënien e saj me këtë shtetase, subjekti ka deklaruar⁶⁹ se: *“Shtetasja L. S. ishte ish-sekretarja ime gjyqësore, në kohën kur kam nisur detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.”*

8.4 Komisioni, paraprakisht, vlerësoi se shtetasja L. S. përfshihet në kategorinë e personave të tjerë të lidhur dhe, për këtë shkak, ka mbajtur korrespondencë me institucionet publike si bankat, ISSH-ja, DRT-ja, ASHK-ja dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë etj.

8.5 Nga korrespondencat e mbajtura, Komisioni vërejti se shtetasja L. S. ka qenë e punësuar deri në prill të vitit 2014 dhe, më pas, ka dalë në pension⁷⁰. Kjo shtetase ka qenë sekretarja e subjektit të rivlerësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë⁷¹ për periudhën 24.10.2002 – 8.6.2004.

8.6 Komisioni ka vlerësuar t’i kërkojë subjektit edhe dokumentacionin justifikues të pasurisë së shtetas L. S., certifikatën e gjendjes familjare në kohën e përfitimit të pasurisë, si dhe dokumentacionin justifikues lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

8.7 Subjekti, në përgjigjen⁷² e saj, deklaroi se: *“... shtetasja L. S. (P.), referuar përmbajtjes së pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, nuk ka asnjë arsye të kategorizohet person tjetër i lidhur, për sa kohë nuk ka dhe as nuk ka pasur ndonjëherë me mua lidhje interesi, të karakterit pasuror apo marrëdhënie biznesi, fakt ky që as nuk ka ndodhur dhe as nuk duket të ketë ndodhur. Shtetasja L. S., në kohën kur unë nisa punën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, nuk ushtronte asnjë aktivitet/biznes, në kontekstin e të cilit të vendoste të më strehonte në banesën e saj, pa kundërshtim. Megjithatë, vlerësoj se nuk kam shkaqe të mos ju bëj me dije faktin se referuar të dhënave me burim znj. L. S., kjo e fundit, ish-rezidente në qytetin e Elbasanit, ka nisur të jetojë në qytetin e Korçës pas trazirave të vitit 1997, duke u shpërngulur familjarisht me bashkëshortin dhe dy fëmijët. Në qytetin e Korçës, znj. L. S. është sistemuar familjarisht në banesën e vëllait të saj, shtetasit B. P., përfituar prej tij nga Komunale Banesa dhe financiar me kredi të butë afatgjatë nga Bashkia Korçë, si person i pastrehë (larguar nga banesa e ish-pronarit), në kushtet kur i vëllai në atë kohë kishte emigruar familjarisht. Pra, shtetasja L. S. (P.), nuk ka qenë pronare e banesës ku unë kam jetuar gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës së gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (p. s.: Nëse do ju interesonte të dinit rrethanat rastësore të sistemit tim në familjen e znj. L. S., unë nuk do të ngurroja t’jua bëja me dije).”*

⁶⁸ Referojuni pyetësorit nr. 4, në dosjen e Komisionit.

⁶⁹ Referojuni e-mail-it, datë 3.3.2020.

⁷⁰ Shkresë nr. (***)prot., datë 11.3.2020, nga ISSH-ja.

⁷¹ Shkresë nr. (***)prot., datë 27.3.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁷² Me e-mail-in, datë 7.4.2020.

8.8 Lidhur me rrethanat e paraqitura, trupi gjykues, në analizë të provave të tilla, si konfirmimi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë⁷³, se shtetasja L. S. nuk ka ndonjë pasuri në emër të saj, në përgjigje të pyetësorit⁷⁴, datë 24.4.2020, subjekti i rivlerësimit depozitoi dy skica planimetrike të EKB-së, ku ndër të tjera, citohej edhe emri i qytetarit B. P., vlerësoi se deklarimi i subjektit “... *znj. L. S. nuk ka qenë pronare e banesës dhe se ajo ishte sistemuar familjarisht në banesën e vëllait të saj, shtetasit B. P., përfituar prej tij nga Komunale Banesa dhe financuar me kredi të butë afatgjatë nga Bashkia Korçë, si person i pastrehë*”, ishte i saktë, si dhe pas konfirmimit edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë⁷⁵ se subjekti i rivlerësimit nuk kishte gjykuar çështje civile, penale, familjare, tregtare, etj., ku palë ndërgjyqëse të ketë qenë shtetasi B. P., konkludoi se nuk kishte më dyshime për këtë pasuri.

9. Komisioni ka hetuar mbi disa të dhëna të konstatuara gjatë hetimit administrativ nga aksesimi në sistemin TIMS dhe AMF, mbi udhëtime të subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve të saj.

9.1 Nga hetimi ka rezultuar se në policat e sigurimit, administruar në dokumentacionin e AMF-së, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit figuronte i regjistruar si përdorues: (a) në periudhën 1.10.2016 – 30.9.2017, së bashku me shtetasin I. S., për automjetin tip “Volkswagen”, me targa (***) , me shasi (***) ; (b) në periudhën 12.2.2016 – 11.2.2017, për automjetin tip “Lincoln Navigator”, me targa (***) ,(***) dhe (***) , me shasi (***) ; (c) në periudhën 21.1.2015 – 20.1.2016, për automjetin tip “Jaguar S-Type”, me targa (***) , me shasi (***) ; (ç) në periudhën 31.1.2017 – 30.1.2018 edhe për automjetin tip “Range Rover”, me targa (***) , me shasi (***) ; si dhe (d) për automjetin tip “Jaguar Xj6”, me targa (***) (i cili është blerë nga bashkëshorti i subjektit në gusht të vitit 2017).

9.2 Në rrethanat e mësipërme, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti nuk kishte deklaruar përdorimin e automjeteve të përshkruara në geramat (a) dhe (b) në deklaratat periodike vjetore (viti 2016) dhe as në deklaratën *Vetting*. Subjekti nuk kishte deklaruar përdorimin e automjetit të përshkruar në germën (c) në deklaratën periodike vjetore (vitet 2015 dhe 2016).

9.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë arsyen e përdorimit të këtyre automjeteve, e cila deklaroi se: “... *shtetasi I. S. është kushëri i bashkëshortit (djali i hallës). Konkretisht, nëna e shtetasit I. S. është shtetasja A. S. (Sh.), motra e shtetasit I. Sh. (babai i bashkëshortit dhe vjehrrri im).*” Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti depozitoi vendimin e datës 17.3.2015, të çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore nga trashëgimtari I. Sh. për prindërit e tij, ku nga verifikimi i aktit, Komisioni vërejtë se deklarimi i subjektit, për marrëdhënien e këtij të fundit me shtetasen A. S., ishte i saktë.

9.4 Në vijim të përgjigjes, subjekti ka cituar se: “... *shtetasi I. S. është pronari i këtyre automjeteve. Emri i bashkëshortit rezulton të jetë pasqyruar nga vetë pronari, si përdorues potencial i këtyre automjeteve, për shkak se z. S., ka qenë i vetmi person i afërm, që ka pasur vazhdimisht në pronësi më shumë se një automjet. Në këtë kontekst, bashkëshorti është pasqyruar përdorues i tyre, për të shmangur situata të paparashikuara pamundësie përdorimi të automjetit tonë (prodhim i vitit 1996), në situata të tilla si, vajtja në punë, udhëtim drejt Rinasit për fluturimet, përgjithësisht të orëve të para të mëngjesit, për trajtimet lazer të djalit*

⁷³ Shkresë nr. (***) prot., datë 4.5.2020.

⁷⁴ Dërguar në rrugë elektronike.

⁷⁵ Shkresë nr. (***) , datë 23.4.2020.

*në Milano (rrethana të sqaruara prej meje në raport me pyetëtorët e mëparshëm) e të tjera situata të kësaj natyre. Por, pavarësisht pasqyrimin të bashkëshortit si përdorues i tre mjeteve të identifikuar në pyetësor, bashkëshorti nuk mban mend t'i ketë përdorur ato automjete në ato periudha, as për qëllimet e sipërcituara, as për ndonjë qëllim tjetër. Arsyeja e përdorimit të dy mjeteve të fundit bazohet edhe në faktin tjetër se viti 2017 përkon me kohën e nisjes së procedurave aplikuese të shkollimit të djalit në Gjermani, çka nuk përjashtonte mundësinë e udhëtimit tonë jashtë vendit për këtë qëllim (siç rezultoi në fakt), në një kohë kur në këtë periudhë, ne nuk kishin automjet. Pavarësisht këtij fakti, ne kemi përdorur automjetet e këtij shtetasi në këto raste: (a) në gusht të vitit 2015, për udhëtim në Greqi me qëllim pushimi, automjetin me targa (***) ; (b) në dhjetor të vitit 2017, për udhëtim në Gjermani, me qëllim shoqërimin e djalit, M. Sh., pas përfundimit të sezonit shkollor, automjetin me targa (***) .”*

9.5 Në analizë të deklaramin se bashkëshorti ishte pasqyruar i regjistruar si përdorues i automjeteve, për të shmangur situata të paparashikuara pamundësie përdorimi të automjetit prodhim i vitit 1996, Komisioni konstatoi se megjithëse subjekti në dhjetor të vitit 2017, kohë kur deklaroi që ka udhëtuar për në Gjermani, ishte bërë pronar i automjetit tip “Jaguar Xj6”, blerë në gusht të vitit 2017, përsëri për këtë udhëtim ka përdorur automjetin tip “Range Rover”, për të cilën kishte të drejtën e përdoruesit.

9.6 Edhe pse nga hetimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë informoi Komisionin⁷⁶ se subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë zhvilluar procese gjyqësore me palë ndërgjyqëse shtetasin I. S., për faktet dhe rrethanat e konstatuara të pasqyruara më sipër, Komisioni i kaloi subjektin barrën e provës duke i kërkuar shpjegime të tjera bindëse, pasi dukej se kishte kryer deklaramin të pasaktë në deklaratën *Vetting* sepse nuk kishte deklaruar përdorimin e automjeteve të përshkruar në pikën 7.7.1.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

9.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka parashtruar se që gjatë hetimit administrativ kishte qartësuar arsyet e përfshirjes së bashkëshortit të saj në policat e sigurimit si përdorues i automjeteve me të dhënat e mësipërme. Pavarësisht përfshirjes së emrit të bashkëshortit në policat e sigurimit, në cilësinë e përdoruesit, ata i kishin përdorur automjetet e këtij shtetasi, në këto raste: (a) në gusht të vitit 2015 për udhëtim në Greqi, me qëllim pushimi, automjetin me targa (***) ; (b) në dhjetor të vitit 2017, për udhëtim në Gjermani, me qëllim shoqërimin e djalit M. Sh., pas përfundimit të sezonit shkollor, automjetin me targa (***) .

9.7.1 Sipas subjektit, në kushtet e përdorimit *vetëm në dy raste* në vlerësimin e saj duhej të bëhej dallimi ndërmjet cilësisë së përdoruesit potencial të një automjeti (evidentuar në policën e sigurimit) me përdoruesin real të tij. Përdorimi në dy raste sporadike me distancë kohore 2-vjeçare nga njëra-tjetra, vlerëson se përbën rrethanë, së cilës nuk i përkon ndonjë rubrikë deklarimi në deklaratën *Vetting* apo DPV. Sipas subjektit, detyrimi për të deklaruar përdorimin, lidhet me rastet kur mjete është në përdorim dhe jo kur është përdorur ndonjëherë dhe se në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* apo DPV-ve, nuk i kishte pasur në pronësi, zotërim apo përdorim, automjetet në policat e sigurimit, për të cilat bashkëshorti rezultonte përdorues

⁷⁶ Shkresë nr. (***) prot., datë 30.4.2020.

potencial, pra, person që mund t'i përdorte, por që nuk i ka pasur në përdorim në kohën e dorëzimit të deklaratës.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

9.8 Trupi gjykues, nisur nga konstatimet e bëra në rezultatet e hetimit, në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti, në tërësi të kësaj çështjeje, çmon se:

Edhe pse nga njëra anë deklarimi i subjektit se i ka përdorur automjetet, vetëm në dy raste, është në nivel deklarativ dhe nga ana tjetër as Komisioni nuk ka një referencë për të provuar shpeshësinë e përdorimit të tyre, trupi gjykues arsyeton se përderisa nga policat e sigurimit, lëshuar nga AMF-ja, bashkëshorti i subjektit rezultonte se kishte të drejta përdorimi të paktën për automjetin tip “Volkswagen”, me targa (***), me periudhë sigurimi 1.10.2016–30.9.2017, periudhë e cila përfshin brenda saj kohën e depozitimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, në datën 25.1.2017, subjekti ka mbartur detyrimin për deklarimin e këtij automjeti. Ky detyrim rridhte në zbatim të përcaktimeve të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në të cilin jepet përkufizimi i fjalës “pasuri”, duke u përcaktuar se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*. Ky parashikim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”*, detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij automjeti si një pasuri me të drejta reale përdorimi.

- ✓ Në tërësinë e rrethanave të paraqitura për këtë çështje, trupi gjykues, pavarësisht kualifikimit për një deklarim të pasaktë të subjektit, vlerëson se kjo pasaktësi në vetvete nuk afekton burime të krijimit të kësaj pasurie, apo krijon dyshime për ndonjë pasuri të fshehur.

Në përfundim, lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues mbi konstatimet e: (i) diferencave në vlera të vogla të shtrira ndër vite; (ii) rrethanave të përdorimit të automjetit, duke vënë në balancë pasojat e tyre, në raport me vlerësimin tërësor të procesit të kontrollit të pasurisë, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, çmon se nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore në kuptim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. (***) prot., datë 30.10.2017,

i deklasifikuar me vendim të KDZH-së nr. (***), datë 8.4.2020, për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Blerona Hasa. Në vijim të këtij përfundimi, në përgjigje të shkresës nr. (***), datë 30.1.2020, pasi subjekti ishte njohur me rezultatet e hetimit administrativ, DSIK-ja ka përcjellë raportin nr. (***)prot., datë 2.7.2020 të përditësuar, të deklasifikuar pjesërisht, nga ku rezultoi se ishte ndryshuar konstatimi fillestar për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës. Komisioni, në kushtet e paraqitjes nga ky institucion të disa informacioneve me *indicie* të reja, vendosi edhe rihapjen e hetimit administrativ. Në raportin e paraqitur, të deklasifikuar me vendimin nr. (***) prot., datë 3.7.2020, DSIK-ja⁷⁷ ka parashtruar se për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerona F. Hasa, disponohen të dhëna mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe të ndërveprimit korruptiv. Në këtë drejtim ishte regjistruar edhe kallëzimi penal, i shqyrtuar nga prokurori z. E. N., i cili me vendimin e datës 23.5.2019, bazuar në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 290, të Kodit të Procedurës Penale, kishte disponuar për mosfillimin e procedimit penal.

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.1 Komisioni, për të konkluduar mbi konstatimet e DSIK-së në raportin e përcjellë, ka kërkuar⁷⁸ në Gjykatën e Lartë dosjen gjyqësore, që i përket çështjes administrative me palë paditëse kompaninë e hidrokarbureve “D. O.A.” sh. a., dhe palë të paditur Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë dhe Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë, me objekt: (i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, njoftim vlerësim tatimor nr(***), datë 11.8.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë dhe vendimit nr. (***), datë 27.10.2015, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë; (ii) pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, njoftim vlerësimi tatimor nr. (***), datë 11.8.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, bazuar në nenet 115, 116, 117/2 e në vijim të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe ligjeve përkatëse në fushën tatimore.

1.2 Në funksion të hetimit për këto dyshime, Komisioni administroi nga Gjykata Administrative e Apelit⁷⁹ vendimet përkatëse të kësaj çështjeje gjyqësore: (a) vendimin nr. (***), datë 6.7.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit; (b) vendimin nr. (***), datë 21.9.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, “Mbi sqarimin dhe interpretimin e një vendimi”, si dhe nga Gjykata e Lartë⁸⁰ dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje, duke kryer verifikimet përkatëse pas së cilave konstatoi, sa parashtrohet në vijim.

1.3 Në tërësi, rrethanat e çështjes, deri në ushtrimin e veprimtarisë së organit tatimor janë fokusuar në ushtrimin e kontrollit tatimor që i është bërë palës paditëse, sa i përket kryesisht tatimit mbi vlerën e shtuar, tatim fitimit, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe taksës kombëtare, nga ku pala paditëse “D. O. A.” sh. a., ka rezultuar me detyrime tatimore të papaguara. DRTTM-ja Tiranë ka konkluduar pas kontrollit të njoftuar dhe të ushtruar pranë

⁷⁷ Referojuni raportit të deklasifikuar vendimi nr. (***) prot., datë 3.7.2020, të DSIK-së.

⁷⁸ Shkresë nr. (***) prot., datë 24.6.2020.

⁷⁹ Mbi kërkesën nr. (***) prot., datë 24.6.2020, të Komisionit, me shkresën nr. (***) prot., datë 25.6.2020.

⁸⁰ Shkresë nr. (***) prot., datë 29.6.2020.

palës paditëse, me njoftim vlerësimin objekt i këtij procesi gjyqësor sipas të cilit, pala paditëse detyrohej të paguante detyrimet e papaguara.

1.4 Me vendimin nr. (***) , datë 30.11.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur rrëzimin e padisë së shoqërisë “D. O. A.” sh. a., si të pabazuar në ligj dhe prova. Në tërësi, në këtë vendim është arsyetuar mbi pavlefshmërinë absolute të kërkuar nga pala paditëse, të cilën gjykata e referon të paligjshme, bazuar në parashikimet shteruese të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative (ligji nr. 8485, datë 12.5.1999), i cili ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ. Gjykata ka arsyetuar në lidhje me të tria parashikimet ligjore (a), (b) dhe (c) të kësaj dispozite, duke konkluduar se: (i) akti administrativ është nxjerrë nga një organ i identifikuar siç është në këtë rast DRTTM-ja Tiranë, organ i ngarkuar me ligj që ka të drejtë të nxjerrë njoftim vlerësimin për detyrime tatimore për tatimpaguesit e mëdhenj të regjistruar në administratën tatimore; (ii) akti është nxjerrë brenda kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 70, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; (iii) aktet janë nxjerrë në përputhje me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, duke u përcaktuar në akte organi që i nxjerr, duke u identifikuar palët të cilëve u drejtohet akti, në të cilin janë shpjeguar rrethanat dhe faktet që janë bërë shkas për nxjerrjen e tij, baza ligjore ku është bazuar nxjerrja e aktit, e drejta e ushtrimit të ankimit nga palët, si dhe nënshkrimi nga drejtuesit e DRTTM-së Tiranë. Çështja është rekursuar në datën 31.3.2016, nga DRTTM-ja Tiranë, si dhe Avokatura e Shtetit në Gjykatën e Lartë⁸¹, e cila deri aktualisht e ka në proces.

1.5 Pas analizimit të dosjes, mbi rrethanat e konstatuara, Komisioni ngriti dyshime⁸² se dukej se: (i) në aktet e administruara nuk rezultonte kërkesë për ndjekjen e procedurës së përshpejtuar⁸³ dhe çështja ishte gjykuar brenda 4 (katër) muajve nga regjistrimi i saj; (ii) gjykata nuk kishte ndërmarrë veprime për të konkluduar nëse kishte ekzistuar apo jo akti i dhënies së kompetencës personit që kishte nënshkruar aktin administrativ *njoftim i vlerësimit tatimor*, ndërsa në vendimmarrje citohet se mungon; (iii) nuk dukej që në arsyetimin e vendimit gjykata të kishte kryer veprime gjyqësore dhe, për pasojë, të jetë shprehur edhe lidhur me dyshimet, nëse nënshkruesi i aktit administrativ ka qenë i legjitimuar në kryerjen e këtij veprimi procedural; (iv) me këtë vendim ishte ndaluar marrja e masave shtrënguese ndaj palës paditëse (pra, pamundësia për t’u vendosur bllokimet e lëvizjeve bankare, tjetërsimi i pasurive, etj., sigurisht nëse ka pasur të tilla), duke mbajtur në vëmendje vlerën e konsiderueshme të detyrimit tatimor të papaguar si dëm i konsiderueshëm i shkaktuar buxhetit të shtetit; (v) referuar arsyetimit të vendimit të gjykatës nr. (***) , datë 6.7.2017 (shihni pikat 33⁸⁴ dhe 34, paragrafi 4), duket se vendimmarrja ishte arrirë edhe nën arsyetimin se edhe akti i kontrollit tatimor nuk është miratuar nga urdhëruesi i kryerjes së tij; (vi) vendimi nr. (***) , datë 21.9.2017, “Mbi sqarimin dhe interpretimin e vendimit”, dhënë ndaj vendimit nr. (***) , datë 6.7.2017, ishte në kontradiktë me arsyetimin e bërë (në pikat 33 dhe 34, paragrafi 4, të vendimit të gjykatës nr. (***) , datë 6.7.2017), për të cilin subjektit iu kërkuan shpjegime.

⁸¹ Dërguar në Gjykatën e Lartë me shkresën datë 8.2.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

⁸² Referojuni rezultateve të hetimit shtesë të Komisionit.

⁸³ Komisioni mban në vëmendje pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, faktin që subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjyqësor, por ka konkluduar në këtë raport krahasuar me çështjet, të cilat gjykoheshin në të njëjtën periudhë kohore.

⁸⁴ Është arsyetuar megjithëse pavlefshmëria e aktit të kontrollit nuk ka qenë objekt i padisë.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.6 Sipas subjektit, përkundër konstatimit të Komisionit, Gjykata Administrative e Apelit, duke zbatuar detyrimin për marrjen në analizë të kërkesave të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative, kishte verifikuar kompetencën, procedurën dhe formën e akteve objekt gjykimi, jo përmbajtjen e tyre. Kompetenca, procedura dhe forma e aktit administrativ lidhej me analizën e shkaqeve që provokonin pavlefshmërinë absolute, ndërsa përmbajtja e aktit lidhej me analizën e shkaqeve që provokonin pavlefshmërinë relative, në kuptim të nenit 118 të Kodit të Procedurave Administrative, që parashikonte se: *“1. Aktet administrative do të quhen relativisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij kodi, kur ato janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, por megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshme”*.

1.7 Mbi konstatimet e Komisionit, sipas subjektit, faktet nuk i kishin shpëtuar pa kapur Gjykatës Administrative të Apelit, për sa kohë që, investimi i gjykatës me padi, në rastet e mosshterimit të rrugës administrative të ankimit (refuzimi nga Drejtoria e Apelimit Tatimor i marrjes në shqyrtim të ankimit, njehsohet me mosshterimin e ankimit administrativ), diktonte marrjen në shqyrtim prej saj, vetëm të rasteve të parashikuara në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative: (i) të kompetencës së organit që disponoi aktin; (ii) të procedurës së nxjerrjes së aktit; dhe (iii) të formës së këtij akti, sikurse ka ndodhur në rastin konkret. Pra, sipas subjektit, vendimi i Gjykatës së Apelit Administrativ ku ka qenë pjesë e trupit gjykues, nuk përmbante ndonjë kontradiktë në raport me faktin që pala paditëse ka pranuar mospagimin e detyrimit, si dhe konstatimet e Komisionit binin në kontradiktë me argumentet dhe konkluzionet e vendimit nr. 00-2016-2568, datë 26.5.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, disponuar për të njëjtën çështje. Lidhur me analizën e elementëve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, parashikuar në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative, gjykata e nis analizën e aktit objekt gjykimi edhe pa pasur kërkim nga pala paditëse dhe kjo nuk konsiderohej disponim nga gjykata, në tejkallim të kërkimeve objekt padie.

1.8 Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka referuar edhe disa vendime të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. (***)⁸⁵, datë 28.2.2017 (çështja “A.” sh.p.k. kundër DRTTM-së), vendimin nr. (***)⁸⁶ (56), datë 5.2.2015 (çështja “S.” sh.p.k. kundër Bashkia Berat), duke argumentuar dhe konkluduar se:

⁸⁵ Ku arsyetohet se: *“Kolegji Administrativ çmon se Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë nuk ka respektuar afatet procedurale të parashikuara në nenin 83 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 dhe në pikën 83.1, të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, gjatë nxjerrjes së aktit administrativ, raport kontrolli datë 29.3.2011. Mosrespektimi i procedurës e bën aktin absolutisht të pavlefshëm, në këndvështrim të nenit 116, të Kodit të Procedurës Administrative.*

*Në mbështetje të kësaj dispozite, Kolegji çmon se ka arsyetuar drejt gjykata, ku ka konstatuar kryesisht se akti administrativ, raport kontrolli datë 29.3.2011, është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm për shkak se është nxjerrë nga pala e paditur në shkelle të procedurës së parashikuar në nenin 83, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 dhe pika 83.1 e Udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, duke qenë se aktet administrative, njoftim-vlerësimi për detyrimet tatimor nr. (***)prot., datë 30.3.2011 dhe urdhër bllokimi nr. (***) prot., datë 4.10.2013, kanë dalë në bazë të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, siç është raport kontrolli datë 29.3.2011, atëherë gjykata konkludon se dhe këto akte administrative janë absolutisht të pavlefshëm. Ky konkludim gjen mbështetje në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen”.*

⁸⁶ *“29. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se vullneti i shprehur nga ana e palës së paditur, nëpërmjet nxjerrjes së urdhër zhdëmtimit nr. (***) , datë 19.8.2010, rezulton të jetë bërë në kapërcim të kompetencave ligjore që i njeht ligji, pasi në çështjen objekt gjykimi, kompetencën për të vendosur detyrimin ndaj paditësit për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes datë 25.1.2010, e ka vetëm gjykata. Për këtë arsye, ky Kolegj, çmon se,*

Ky përfundim i Gjykatës Administrative të Apelit, në bazë të neneve 116 dhe 117 të Kodit të Procedurës Administrative nuk ka favorizuar palën paditëse, për sa kohë që detyrimet e konstatuara nga administrata tatimore nuk i ishin nënshtruar shqyrtimit gjyqësor.

1.9 Sipas subjektit konstatimet e Komisionit do të qëndronin vetëm në rast se pavarësisht objektit të padisë për konstatim pavlefshmërie absolute, gjykata do të kishte marrë në shqyrtim me iniciativën e saj, pa kërkim nga paditësi, shkaqet e pavlefshmërisë relative të njoftim vlerësimit, me gjithë mosparapagimin e detyrimit, duke e deklaruar një akt të disponuar në kundërshtim me ligjin, çka nuk kishte rezultuar në rastin konkret. Subjekti përmend këtu faktin e disponimit prej Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, pas një muaji nga dita e disponimit të njoftim-vlerësimit tatimor nr. (***), datë 11.8.2015, të aktit administrativ nr. (***), datë 25.9.2015, “Njoftim për miratimin e *rimbursimit* të TVSH-së”, në vlerën 1.234.602.150 lekë.

1.10 Sipas subjektit⁸⁷ misioni i gjykatës nuk është mbledhja e taksave, por disiplinimi i administratës tatimore nëpërmjet vendimeve gjyqësore, lidhur me mënyrën se si duhen interpretuar dhe zbatuar prej kësaj të fundit dispozitat e legjislacionit tatimor, si dhe detyrimi për të vendosur njësoj për të gjitha çështjet e ngjashme, pa u lidhur me objektin material të padisë, i konsiderueshëm ose jo.

1.11 Lidhur me verifikimin e kompetencës⁸⁸ për nënshkrimin e akteve, subjekti ka parashtruar se në kushtet kur miratimi i raport-kontrolleve tatimore dhe nënshkrimi i njoftim-vlerësimeve tatimore përbënte kompetencë/pushtet ekskluziv të titullarit të DRTTM-së, akti që e delegonte këtë kompetencë/pushtet te një person tjetër duhej të botohej në Fletoren Zyrtare, për sa kohë kanë mision të vetëm publikimin, si dhe janë akte të aksesueshme në faqen elektronike të Qendrës së Botimeve Zyrtare, të cilat Gjykata Administrative e Apelit i kishte verifikuar dhe kishte konstatuar se nuk kishte një akt delegimi kompetencash të titullarit të DRTTM-së, të botuar në Fletoren Zyrtare.

1.12 Në funksion të analizës së konstatimeve të Komisionit, sipas subjektit duhet evidentuar të qenurit e vendimmarrjes që i konstaton absolutisht të pavlefshme njoftim-vlerësimet tatimore kur janë nënshkruar nga një person i ndryshëm nga titullari, pa u pajisur me aktin respektiv të

ai është një akt absolutisht i pavlefshëm dhe me të drejtë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, është konstatuar si i tillë, referuar nenit 116 të Kodit të Procedurës Administrative.

30. Vlen të theksohet se një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, prezumohet se ka shkelje të tilla thelbësore të ligjës, sa konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Një akt i tillë, që nga momenti i nxjerrjes së tij, nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike për të cilat ai është nxjerrë. Një akt absolutisht i pavlefshëm nuk është akt, ai është një nulitet i plotë, i cili konsiderohet se nuk ka hyrë në fuqi asnjëherë. Për shkak të shkeljes së rëndë thelbësore të ligjës, pavlefshmëria absolute e një akti nuk mund të rregullohet në të ardhmen, as nga palët dhe as nga organi që ka lëshuar aktin, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si i tillë, ai nuk mund të ketë fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve, të cilëve iu kundrejtohet dhe as ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore.

31. Në këto kushte, si organet e administratës shtetërore dhe subjekteve të cilëve ai iu drejtohet, kanë të drejtë të refuzojnë përmbushjen e detyrimeve apo urdhërimeve që rrjedhin nga ky akt, pa qenë nevoja që për pavlefshmërinë e tij, të shprehet patjetër ndonjë organ shtetëror. Për shkak të kësaj veçorie që ka akti absolutisht i pavlefshëm, ligjvënësi ka parashikuar që, çdo palë e interesuar ka të drejtë të kërkojë nga ana e gjykatës konstatimin e pavlefshmërisë absolute dhe jo deklarimin e saj. Prandaj, kur gjykata gjatë gjykimit të çështjes, konstaton qoftë dhe kryesisht se akti është absolutisht i pavlefshëm, ajo duhet ta konstatojë atë dhe të zgjidhë pasojat juridike që vijnë për palët, nga ky akt absolutisht i pavlefshëm”.

⁸⁷ Referojuni parashtrimeve të subjektit të shprehura në formë të hollësishme, datë 14.7.2020.

⁸⁸ Referojuni nenit 27 të Kodit të Procedurave Administrative viti 1999, që ka parashikuar: “1. Organet administrative kompetente mund të delegojnë kompetencat e tyre te një organ tjetër i administratës. 2. Organet administrative kompetente mund të delegojnë këto kompetenca tek organet e tyre vartëse”.

publikuar, të delegimit të kësaj kompetence, praktikë që është ndjekur edhe nga kolegje të tjera të Gjykatës së Apelit Administrativ.

1.13 Për të mbështetur shpjegimet dhe arsyetimet ligjore, subjekti ka bashkëlidhur disa vendime të ngjashme më të njëjtin organ administrativ të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj⁸⁹, apo me të paditur organe të tjera administrative⁹⁰, si dhe referenca⁹¹ të çështjeve të reflektuara, përgjithësisht, nga organet administrative dhe institucionet shtetërore në zbatim të nenit 29 të Kodit të Procedurave Administrative.

1.14 Lidhur me dyshimet e Komisionit se dukej se vendimi nr. (***) , datë 21.9.2017, “Mbi sqarimin dhe interpretimin e vendimit”, të dhënë ndaj vendimit nr. (***) , datë 6.7.2017, dukej në kontradiktë me arsyetimin e bërë (në pikat 33 dhe 34, paragrafi 4, të vendimit të gjykatës nr. (***) , datë 6.7.2017), subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se sqarimi i interpretimit të vendimit ishte bërë në respektim të nenit 6⁹² të Kodit të Procedurës Civile, duke rirreferuar arsyetimin⁹³ e vendimit nr. (***) , datë 28.2.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

1.15 Lidhur me konkluzionet e DSIK-së, subjekti paraprakisht ka përshkruar dispozitat ligjore mbi bazën e të cilave duhet të kryhet kontrolli i figurës, parashikuar në nenet 34 dhe 39/1 të ligjit nr. 84/2016, që në referencë të tyre, DSIK-ja, do të duhej që edhe raportin e dytë ta kishte përpiluar duke u bazuar në objektin dhe kufijtë ligjorë të sipërreferuar.

1.16 Sipas subjektit, informacioni lidhur me personin e saj ishte bërë objekt hetimi nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, e cila ka disponuar me vendim datë 23.5.2019 për “Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. (***)/2019”, i bazuar në nenin 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale që parashikon se *“Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, “... kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston”*. Subjekti ka paraqitur kopje të këtij vendimi, pjesë e shpjegimeve të saj, ku ndër referencat e

⁸⁹ Vendimi nr. (***) , datë 31.10.2019, që i përket çështjes “I. D. S.” sh.p.k. vs. Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj etj., me objekt shfuqizimin e njoftim-vlerësimit nr. (***) prot., datë 17.8.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj; vendimi nr. (***) (282), datë 7.2.2020 që i përket çështjes: “A. K.” sh.p.k. vs. Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj etj., me objekt shfuqizimin e njoftim-vlerësimit nr. (***) , datë 9.8.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj.

⁹⁰ Vendimi nr. (***) , datë 12.9.2019, që i përket çështjes së shtetases R. B. vs. Ministria e Punëve të Brendshme, me objekt “shfuqizimi i vendimit nr(***) prot., datë 4.9.2015, ‘për lirim nga detyra’”.

⁹¹ Urdhri nr. (***) , datë 3.8.2017, i titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, nëpërmjet të cilit rezultojnë se kompetencat e këtij të fundit t’i jenë deleguar një vartësi të tij për periudhën 4.8.2017 – 15.8.2017 dhe ky akt rezultojnë të jetë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 7.8.2017; urdhri nr. (***) , datë 3.11.2017, i titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, nëpërmjet të cilit rezultojnë se kompetencat e këtij të fundit t’i jenë deleguar një vartësi të tij për periudhën 3.11.2017 – 31.12.2017 dhe ky akt rezultojnë të jetë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 8.11.2017.

⁹² “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”.

⁹³ “Kolegji Administrativ çmon se Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë nuk ka respektuar afatet procedurale të parashikuara në nenin 83, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 dhe në pikën 83.1, të udhëzimit nr. (***) , datë 2.9.2008, gjatë nxjerrjes së aktit administrativ, raport kontrolli datë 29.3.2011. Mosrespektimi i procedurës e bën aktin absolutisht të pavlefshëm në këndvështrim të nenit 116, të Kodit të Procedurës Administrative.

*Në mbështetje të kësaj dispozite, kolegji çmon se gjykata ka arsyetuar drejt, ku ka konstatuar kryesisht se akti administrativ, raport kontrolli datë 29.3.2011 është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm për shkak se është nxjerrë nga pala e paditur në shkellje të procedurës së parashikuar në nenin 83, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 dhe pika 83.1, e Udhëzimit nr. (***) , datë 2.9.2008, duke qenë se aktet administrative Njoftim-Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 25753/6 prot., datë 30.3.2011 dhe urdhër bllokimi nr. (***) prot., datë 4.10.2013 kanë dalë në bazë të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, siç është raport kontrolli datë 29.3.2011, atëherë gjykata konkludon se edhe këto akte administrative janë absolutisht të pavlefshëm.*

Ky konkludim gjen mbështetje në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen”.

tjera arsyetuese përshkruhen edhe rrethana të tilla: “...për sa i përket vendimmarrjes së gjykatës çmohet se prokuroria nuk mund të hetojë gjyqtarë të kallëzuar për shkak të vendimmarrjes së tyre, pasi kontrolli i ligjshmërisë së vendimeve të gjykatës është kompetencë e gjykatave më të larta të sistemit gjyqësor...”.

1.17 Sipas subjektit, edhe DSIK-ja duhej të kishte konsideruar në kontrollin për figurën, vendimin e disponuar nga prokurori ku arsyetohej se informacioni i përcjellë në prokurori nuk përbënte *indicie* për të krijuar dyshimin e arsyeshem për ekzistencën e kryerjes së veprës penale. Në këtë drejtim, DSIK-ja jo vetëm ka dalë në përfundimin se, në këtë rast, është konsumuar prej subjektit të rivlerësimit vepra penale e korrupsionit, por ka zbuluar edhe një vepër tjetër që prokurori nuk e kishte identifikuar, konkretisht, shpërdorimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Rrjedhimisht, subjekti shprehet se figura e saj nuk ishte vlerësuar në bazë të asaj çka rezultonte, por në bazë të asaj që DSIK-ja supozohet se i rezultonte nga të dhënat e marra prej saj. Gjithashtu, subjekti është shprehur se ka një qëndrim flagrant të DSIK-së në rastin e saj, i cili konsistonte edhe në faktin se pavarësisht se përfundimet e saj lidhur me pastërtinë e figurës kufizohen brenda një periudhe të caktuar me ligj, ky detyrim ligjor nuk është respektuar, pasi kallëzimi në prokurori datonte më 9.5.2019 dhe kishte të bënte me një vendimmarrje të disponuar në datën 6.7.2017 dhe gjithçka lidhur me këtë rast përbënte objekt shqyrtimi nga prokuroria nga njëra anë dhe nga ana tjetër kishte përbërë pengesë për t’u përdorur si e dhënë e re, lidhur me raportin e figurës. Ky institucion kishte përpiluar këtë raport sipas një standardi krejt të ndryshëm dhe antiligjor, krahasuar me raportin e parë pozitiv, për sa kohë sipas subjektit: (1) tejkalonte periudhën e kontrollit; dhe (2) nuk i referohej informacionit të përcjellë nga organet ligjzbatuese lidhur me këtë periudhë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.18 Trupi gjykues, nisur nga konstatimet e bëra në rezultatet e hetimit, konkluzionet në raportin e DSIK-së, në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti për vlerësimin e këtij kriteri, çmon të vlerësojë këtë çështje në dy aspekte:

A) Në aspektin e vlerësimit të një analize juridike të çështjes profesionale mbi të cilën autoritetet ligjzbatuese, të ngarkuara me ligj kishin ngritur dyshime për veprime korruptive në zbatim të dispozitave ligjore të çështjes në fjalë, e cila iniciohej sipas Kodit të Procedurës Administrative dhe legjislacionit tatimor, në raport me dispozitat ligjore, që i japin kompetencë Komisionit për shqyrtimin e tyre sipas neneve 71 e në vijim, të ligjit nr. 96/2016.

B) Në aspektin e rivlerësimit të figurës së subjektit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe duke iu referuar dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me aspektin e parë, trupi gjykues, në vlerësim të akteve të administruara në dosjen gjyqësore, si dhe të qartësisimit të subjektit në parashtrime se nga pala paditëse ishte depozituar kërkesë për përshpejtimin e çështjes gjyqësore, nën pretendimet dhe arsyet e paraqitura nga kjo e fundit, por edhe në konsideratë të faktit se Komisioni në rezultatet e hetimit kishte pasqyruar pozicionin e subjektit në cilësinë e anëtarit, e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit se procedura e përshpejtimin të gjykimit të çështjes kishte qenë e bazuar.

Gjithashtu, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti, në gjykimin e çështjes, ka mbajtur në konsideratë krahas objektit të kërkimit në padi edhe përmbajtjen e saj, bazuar në vendimin nr. (***) , datë 28.2.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, depozituar prej saj.

Po ashtu, trupi gjykues ka vërejtur se pala e paditur nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për depozitim të aktit/eve të përfaqësimit të personit/zyrtarit zëvendësues për nënshkrimin e aktit të njoftim-vlerësimit tatimor, me qëllim që gjykata të vlerësonte në kushte dhe rrethana të tjera.

Në vijim, për sa arsyetohet, trupi gjykues e vlerëson këtë çështje objekti hetimi administrativ për efekt të këtij procesi edhe në konsideratë të faktit, që të gjitha pretendimet e palës rekursuese aktualisht janë objekt gjykimi në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, çmohet se Komisioni nuk ka kompetencë të vlerësojë më tej këtë çështje, referuar pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016 dhe, për rrjedhojë, konkludon se nuk mund të arrihet në një përfundim lidhur me dyshimet e DSIK-së.

Lidhur me aspektin e dytë, vlerësimin e kriterit të figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në kreun V të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arsyeton:

1. Ligji nr. 84/2016, në nenin 34 të tij parashikon se kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

2. Bazuar në pikat 4 dhe 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në kryerjen e verifikimeve të nevojshme në dy drejtime: (a) në konstatimin e ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm; dhe (b) në konstatimin e plotësisë dhe besueshmërisë së deklaratimit, në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës për çdo subjekt rivlerësimi.

3. Lidhur me konstatimin e përshkruar në germën (a), trupi gjykues vlerëson se referuar konkluzioneve të DSIK-së, por edhe hetimit të Komisionit, ka rezultuar se subjekti ka plotësuar me vërtetësi deklaratën e figurës pasi në asnjë rrethanë nuk janë konstatuar elemente në kuptim të kriterëve që kërkon neni 38 lidhur me konstatime për ekzistencën e ndonjë kontakti të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, sipas standardeve që kërkon kontrolli i këtij kriteri.

4. Lidhur me konstatimin e përshkruar në germën (b), trupi gjykues vlerëson se raporti i DSIK-së, si dhe hetimi i Komisionit i referohet verifikimit të figurës mbi dyshimet e ngritura sipas pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 apo verifikimit të të dhënave për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e saj funksionale, sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë që të vlerësohet pastërtia e figurës së subjektit dhe shkalla e besueshmërisë së tij.

Për sa më sipër, Komisioni, në analizën ligjore dhe rrethanat faktike, çmon se dyshimet e ngritura për veprime korruptive kundrejt subjektit nuk janë të mbështetura në prova dhe, për rrjedhojë, nuk gjen vend zbatimimi i dispozitave ligjore për masë penalizuese lidhur me këtë kriter. Ky vlerësim i trupit gjykues është i mbështetur jo vetëm në analizën juridike të çështjes së referuar dhe arsyetuar më sipër, por edhe për sa kohë disponohet vendimi datë 23.5.2019

për “Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. (***)/2019”, i prokurorit, që ka hetuar dhe shqyrtuar këtë çështje për të njëjtat dyshime apo që mund të lidhen me vlerësime të ndryshme të një vendimmarrjeje të caktuar, kontrolli i ligjshmërisë së të cilave është kompetencë e gjykatave më të larta të sistemit gjyqësor.”

5. Nga ana tjetër, pavarësisht pretendimit të subjektit se raporti i dytë i DSIK-së ishte konkluzion i përditësimit të figurës së saj pas periudhës së rivlerësimit, në të cilën për të njëjtat dyshime ishte shprehur organi i Prokurorisë dhe se ky institucion duhej ta kishte verifikuar këtë fakt, trupi gjykues çmon se është kompetencë e Komisionit që kryen rivlerësimin përfundimtar të kontrollit të figurës dhe procesin përfundimtar të rivlerësimit për efekt të ligjit nr.84/2016. Në përputhje me parimin e objektivitetit, trupi gjykues çmon se raporti i DSIK-së, për subjektin e rivlerësimit, duhet të ishte i mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit për ndikueshmëri në veprime korruptive, lidhje këto që mund të provonin çdo dyshim të arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës që mund ta passillnin cenimin e pastërtisë së figurës apo mund ta bënin subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm.

6. Në rrethanat e kësaj çështjeje objekt vlerësimi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se nuk arrihet të provohen dyshimet e ngritura, si dhe nuk ka rrethana që të ngarkohet me përgjegjësi subjekti dhe, për rrjedhojë, të aplikohet ndonjë masë penalizuese ndaj saj, brenda përcaktimeve ligjore të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë nga hetimi i tij, nuk evidentoi ndonjë *indicie* apo fakt tjetër që mund të mbështeste këto dyshime dhe, si rrjedhojë e këtij vlerësimi, arrin në përfundimin për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, se:

- ✓ Nuk vërtetohen dyshimet mbi përfshirje në veprimtari korruptive në pozicionin e anëtares së trupit gjykues për çështjen e referuar, shpjegimet e saj ishin bindëse, si dhe ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës sipas parashikimeve ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin⁹⁴ e përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj) si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë raport nuk janë evidentuar problematika ndaj subjektit të rivlerësimit në lidhje me aftësitë organizative, ku përfshihen: (a) aftësia për të përballuar ngarkesën në punë; (b) aftësia për të kryer procedurat gjyqësore; si dhe (c) aftësia për të administruar dosjet. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, ku përfshihen: (a) etika në punë; (b) integriteti; si dhe (c) paanësia. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, ku përfshihen: (a) aftësitë e komunikimit; (b) aftësia për të bashkëpunuar; si dhe (c) gatishmëria për t’u angazhuar. Raporti është bazuar në tri dokumentet

⁹⁴ Raport nr. (***) prot., datë 8.4.2019.

ligjore dhe në pesë dokumentet ligjore/çështje gjyqësore të shortuara, si dhe në të dhënat nga ankesat e depozituara në ish-KLD-në. Lidhur me këto të fundit, sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, “8.10.2013 – 8.10.2016”, për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 9 ankesa (3 në vitin 2014, 3 në vitin 2015 dhe 3 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së, nga ku dy ankesa të vitit 2015 referohen se janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 1 me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 1 me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më parë, ndërsa 7 ankesa ishin verifikuar nga ku: 2 ankesa (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2016), të verifikuara për mosrespektim formal të ligjit, janë në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në shkallët më të larta; 2 ankesa (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015), bazuar mbi informacionin periodik ardhur nga kryetari i gjykatës, verifikuar për mosdorëzimin në afat të vendimeve të arsyetuara i janë regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik; 1 ankesë e vitit 2014, e verifikuar për moszbardhje vendimi, i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik; 1 ankesë e vitit 2016 e verifikuar bazuar në informacionin periodik të ardhur nga kryetari i gjykatës për mospërdorimin e sistemit audio i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik, si dhe 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për shkelje formale ligji është në proces verifikimi shtesë nga Inspektorati.

C/1 RIVLERËSIMI PROFESIONAL

1. Edhe Komisioni, nga studimi i raportit dhe verifikimi i dokumentacionit shoqërues, sikurse i ka rezultuar edhe KLGj-së në raportin e tij, nuk ka konstatuar problematika për sa i përket aftësive profesionale, etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, KLGj-ja, nga korrespondenca e mbajtur, ka konfirmuar⁹⁵ se nuk ka pasur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor nga ministri i Drejtësisë apo të jetë dhënë ndaj saj ndonjë masë disiplinore nga Këshilli.

2. Në vijim, në lidhje me tri dokumentet ligjore⁹⁶ ashtu sikurse ka cituar edhe raporti i KLGj-së, nga përmbajtja e vendimeve është konstatuar se nuk jepeshin të dhëna në lidhje me datën e regjistrimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit dhe, për rrjedhojë, nuk identifikoheshin kohëzgjatja e gjykimit, si dhe nuk kishte të dhëna nëse palët kishin ushtruar të drejtën e rekursit.

2.1 Komisioni, për qartësimin e tyre, i kërkoi subjektit të depozitonte dokumentacionin përkatës për të pasqyruar se kur ishin regjistruar tri çështjet e përfunduara me vendimet përkatëse.

3. Komisioni, po ashtu, nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatoi se vetëm për 2 prej tyre ishte ushtruar e drejta e rekursit në Gjykatën e Lartë, e cila pas shqyrtimit, për njëjërën kishte vendosur

⁹⁵ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 30.4.2019, në dosjen e Komisionit.

⁹⁶ Dokumenti nr. 1/vendimi nr. (***), datë 27.1.2016; dokumenti nr. 2/vendimi nr. (***), datë 26.5.2014; dokumenti nr. 3/vendimi nr. (***), datë 16.11.2015.

mospranimin e rekursit (shihni dosjen 5), ndërsa për tjetrën nuk është shprehur me vendim (shihni dosjen 2).

4. Komisionit, në lidhje me komponentët e tjerë, sikurse ka evidentuar raporti i KLGj-së, nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, i rezultuan problematika lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve, me vonesat në arsyetimin e vendimeve dhe për këtë i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me respektimin e afatit ligjor (7 ditë) të parashikuar nga neni 55/3 i ligjit nr. 49/2012.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

5. Mbi kërkimin e Komisionit subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar rrethanat faktike dhe ligjore për çdo rast, sikurse përshkruhen në vijim:

- Lidhur me problematikat e pasqyruara mbi mospërlllogaritjet e kohëzgjatjes së gjykimeve për shkak të mosdhënies së të dhënave për datën e regjistrimit të çështjeve, subjekti ka qartësuar se data e regjistrimit të secilës çështjeje është referuar qartësisht në pjesën hyrëse të vendimit, duke depozituar edhe vendimet përkatëse.

- Subjekti ka sqaruar se për çështje me objekt kundërshtimin e një akti nënligjor normativ, sikurse padia me paditës shoqëria tregtare “A.” sh. a., i paditur Këshilli i Bashkisë Sarandë, me objekt “shfuqizim (anulim) i vendimit nr(***), datë 5.2.2015, të Këshillit të Bashkisë Sarandë, në kushtet e një padie të dorëzuar drejtpërdrejt në Gjykatën e Apelit Administrativ si juridiksion fillestar (pika 2/b)”, nuk zbatohet afati 30-ditor i parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

- Subjekti ka qartësuar të gjithë problematikat e prezantuara në rezultatet e hetimit administrativ duke dhënë detaje dhe duke zgjeruar informacionin për secilin prej tri dokumenteve ligjore të natyrës “vendime”, por edhe për problematikat e konstatuara mbi 5 dosjet gjyqësore.

- Gjithashtu, subjekti ka qartësuar lidhur me veprimet e ndërmarra prej saj prej shortimit të çështjeve, kalimit të tyre në dhomë këshillimi dhe kryesisht duke sqaruar se në këto raste përfundimi i tyre është realizuar brenda afatit 30-ditor, ka vijuar të argumentojë edhe mbi pamundësitë objektive të ndjekjes së afateve për rastet e kalimit të çështjeve në seancë gjyqësore, vendimmarrjet e ndërmjetme, mbi rekursit e ushtruara dhe përfundimin e tyre. Më konkretisht, ka pasqyruar se: për çështjen që i përket paditëses L. P., Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2017-2363, datë 31.10.2017, ka vendosur mospranimin e rekursit të paditëses kundër vendimit nr. (***), datë 26.5.2014, të Gjykatës së Apelit Administrativ; për çështjen që i përket shoqërisë “B.P. A.” kundër DRTTM-së (përfunduar me vendimin nr. (***), datë 16.11.2015, masë sigurimi padie), nuk është ushtruar rekurs duke depozituar për këtë rast edhe vërtetimin nr(***)prot., datë 3.6.2020, lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë; për dosjen nr. (***), T. M. kundër të paditurit ZVRPP-ja Shkodër, palët ndërgjyqëse nuk e kanë ankimuar vendimin dhe, për pasojë, çështja rezulton e mbyllur me vendim gjyqësor të formës së prerë; për dosjen (***), Th. Dh. kundër të paditurve KRRT-ja, Bashkia Himarë etj., referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, kjo çështje rezulton e regjistruar në gjykatë në datën 20.2.2015 dhe është ende në pritje të gjykimit; për dosjen (***), “M.” sh.p.k., kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës etj., pala paditëse nuk e ka ankimuar vendimin e apelit, çështja rezulton e mbyllur me vendim gjyqësor të formës

së prerë; për dosjen (***), T. G. kundër të paditurve Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit etj., pala paditëse nuk e ka ankimuar vendimin e apelit, çështja rezulton e mbyllur me vendim gjyqësor të formës së prerë; për dosjen (***), shtetasja F. Gj. kundër të paditurit Drejtoria Spitalore Kavajë, pala e paditur e ka rekursuar vendimin dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2018-771, datë 11.7.2018, ka vendosur mospranimin e rekursit të palës së paditur Drejtoria Spitalore Kavajë, kundër vendimit nr. (***), datë 16.11.2015 (bashkëngjitur).

- Subjekti ka sqaruar se me nisjen e veprimtarisë gjykatat administrative u përballën me dy fakte që binin ndesh me qëllimin e miratimit të ligjit nr. 49/2012, në bazë të të cilit organizoheshin dhe funksionin. Konkretisht, në zbatim të vendimit nr. 3/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të gjitha gjykatat civile në Republikën e Shqipërisë shpallën moskompetencën në gjykimin e çështjeve administrative që kishin në shqyrtim, duke urdhëruar njëherësh dërgimin e tyre gjykatave kompetente administrative dhe ndihmësit ligjorë u emëruan vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2015.

- Subjekti ka informuar se ndihmësi ligjor i është caktuar për herë të parë me urdhrin nr. (***) prot., datë 9.6.2015, të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Administrativ dhe, rrjedhimisht, përgjatë periudhës 4.11.2013 – 9.6.2015 çdo akt lidhur me dosjen gjyqësore ka qenë produkt i punës individuale të saj. Gjithashtu, subjekti është shprehur edhe mbi numrin e lartë të çështjeve të shortcutuara dhe mbingarkesën e tyre për gjykim. Ka evidentuar faktin se në raportin e analizës vjetore të vitit 2015 ka rezultuar si gjyqtari me numrin më të ulët të çështjeve të gjykuara për një afat më të gjatë se një muaj. Subjekti, së bashku me parashtrimet, ka depozituar vendime, urdhra dhe akte të tjera provuese në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6. Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve⁹⁷ të hollësishme të subjektit, në raport me ligjin e zbatueshëm, si dhe verifikimit të bërë dokumentacionit të depozituar, kronologjikisht çmon se shpjegimet e subjektit:

a) lidhur me mospasqyrimin e datës së regjistrimit pothuajse të të gjitha çështjeve, me pasojë mosevidentimin e kohës së mbajtur për shqyrtim dhe gjykim, janë të plota dhe se nga verifikimet janë vërejtur se data e regjistrimit evidentohet në pjesën hyrëse të vendimit dhe për pasojë, ky konkluzion mbështet sqarimet e subjektit;

b) lidhur me kohëzgjatjen e gjykimin të një çështjeje me juridiksion fillestar janë bindëse dhe gjejnë referim në dispozitat ligjore të ligjit nr. 49/2012, specifikisht detyrimit të përmbushjes së kërkesave të nenit 25, për të cilën ligjvënësi referon në nenin 3/1.

Në vijim, trupi gjykues ka konstatuar se çështjet e gjykuara në dhomë këshillimi janë përmblyllur brenda afatit ligjor 30 ditë nga data e regjistrimit, sipas parashikimit të bërë në nenin 48 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Po ashtu, trupi gjykues vlerëson objektivitetin dhe angazhimin e subjektit për të gjykuar çështjet në afat nisur edhe nga vështirësitë e krijuara prej numrit të lartë të dosjeve gjyqësore

⁹⁷Referojuni shpjegimeve të detajuara të analizuara ligjërisht nga subjekti, dërguar në datën 11.6.2020 me termin “Observacione për vlerësimin profesional”.

të rishpërndara nga gjykatat civile me miratimin e ligjit nr. 49/2012 dhe vendimin e Kolegjeve të Bashkuara.

Trupi gjykues, në vlerësimin e subjektit lidhur me konstatimet e bëra, përveçse merr në konsideratë mbingarkesën e çështjeve për gjykim, vlerëson në kohëzgjatjen e gjykimeve edhe diktimin e disa kushteve në adresë të saj, ku përfshihet edhe koha kur i është caktuar ndihmësi ligjor apo edhe fakti⁹⁸ se sekretarja gjyqësore ka mbajtur edhe detyrën e magazinierit.

Trupi gjykues vlerëson edhe zgjidhjet e dhëna nga Gjykata e Lartë pas rekurseve të ushtruara nga palët ndërgjyqëse për të gjithë çështjet gjyqësore, mbi të cilat është vlerësuar subjekti në raportin përkatës, të cilat kryesisht kanë pasqyruar lënien në fuqi të vendimit gjyqësor të subjektit apo mospranimin e rekursit, sikurse ka edhe raste që janë ende në gjykim.

Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson nivelin e arsytimit të vendimeve, pasi në tërësi ato përmbajnë të gjithë komponentët, duke nisur nga parashtrimi i saktë i fakteve, deri në referencat në praktikën e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, duke i kushtuar vëmendje dhe analizuar të gjitha shkaqet e ngritura në ankim.

Pra, në një panoramë përmbledhëse trupi gjykues paralelisht me çdo shpjegim të detajuar të subjektit, çdo dokument mbështetës, përballur me një tërësi referencash ligjore ku gjejnë bazë sjelljet dhe veprimet e ndërmarra prej saj përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës, krijon gjithashtu edhe bindjen se parashtrimet e subjektit në lidhje me konstatimet e kontrollit të aftësive profesionale janë të drejta, të argumentuara dhe me bazueshmëri ligjore.

Në lidhje me denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se janë depozituar 18 denoncime, prej të cilave disa prej denoncuesve kanë depozituar më shumë se një denoncim (siç identifikohen dhe analizohen më poshtë) për të njëjtën çështje dhe subjekt rivlerësimi.

1. Denoncim⁹⁹ i shtetasit H. R. dhe shtetasit S. R.¹⁰⁰, që rezultuan më përmbajtje të njëjtë. Denoncuesit ankohen lidhur me veprime të padrejta të dhëna në kundërshtim me ligjin, për sa i përket një ish-prone të administruar nga i ndjeri S. R., përpara viteve 1990 dhe që ka vijuar në procese gjyqësore pas këtij viti, me objekt “lirim dhe dorëzim banese”. Më tej, ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor ndaj një ankimi të veçantë të bërë për një vendim të ndërmjetëm, i cili sipas denoncuesit i ishte caktuar për shqyrtim subjektit të rivlerësimit.

1.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit pas kërkesës së Komisionit për dhënie shpjegime subjekti ka parashtruar se në Gjykatën e Apelit Administrativ ishin regjistruar dy çështje, një në bazë ankimi të zakonshëm (nr. (***)-2015) dhe një në bazë ankimi të veçantë (nr. (***)-2015). Lidhur me ankimin e veçantë, dosja nr. (***)-2015 dhe pretendimit për heqjen dorë të gjyqtarës nga gjykimi i çështjes nr. (***)-2015, subjekti ka bërë me dije se kjo çështje me shortin e datës 22.9.2015 i kishte kaluar për shqyrtim në cilësinë e relatores, por më tej, në bazë të urdhrit nr. (***) prot., datë 18.4.2016, të kryetarit të Gjykatës së Apelit Administrativ, për rishortimin e çështjeve të ardhura gjatë periudhës 2015 – 17.3.2016, çështja ishte rishortuar

⁹⁸ Referojuni urdhrit nr. (***) datë 3.12.2013, të kancelarit të Gjykatës Administrative të Apelit.

⁹⁹ Denoncim nr. (***) prot., datë 22.1.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁰ Denoncimet nr. (***) prot., datë 7.2.2019, i depozituar me CD dhe nr. (***) prot., datë 20.4.2018, në dosjen e Komisionit.

në datën 25.4.2016, pra, nuk kishte dhënë dorëheqjen, por dosja kishte kaluar nga subjekti si relatore tek një tjetër gjyqtar i caktuar me short, në cilësinë e relatorit.

1.2 Lidhur me pretendimin për zvarritje të procesit gjyqësor ndaj një ankimi të veçantë të bërë për një vendim të ndërmjetëm, sipas subjektit në rastin konkret bëhej fjalë për ankim të veçantë ndaj një vendimi jopërfundimtar (sikurse është vendimi për pushimin e gjykimit, sipas nenit 127 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 39/1 të ligjit nr. 49/2012)¹⁰¹, ku paditësit R. kishin qenë të përfshirë në disa gjykime në disa gjykata, njëri ndër të cilët përfunduar me vendimin datë 19.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që konsistonte në pushimin e gjykimit. Në Gjykatën Administrative të Apelit ndiqet praktika sipas së cilës çështjet e mbyllura me vendim jopërfundimtar pushim gjykimi (sikurse dosja (***)-2015, datë 21.9.2015), regjistrohen si çështje themeli dhe, si e tillë, në kohën e regjistrimit të kësaj çështjeje, kjo gjykatë kishte shqyrtuar çështje themeli të regjistruara në periudhën maj - qershor 2014, sipas rendit kronologjik në raport me datën e regjistrimit.

1.3 Lidhur me pretendimin e denoncuesit për disponimin e vendimit në bazë të veprimeve të padrejta dhe në kundërshtim me ligjin, subjekti ka parashtruar se gjykata administrative ka disponuar me vendimin nr. (***), datë 6.2.2019, që kishte konsistuar në lënien në fuqi të vendimit datë 19.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Çështja aktualisht është në proces në Gjykatën e Lartë, investuar mbi ankimin e paditësve R. kundër këtij vendimi. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar në cilësinë e provave urdhrin nr. (***)prot., datë 18.4.2016, të kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, fletët përkatëse të shortit, printimin nga faqja e Gjykatës së Lartë, vendimin nr. (***), datë 6.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave, çmon se shpjegimet e dhëna prej saj janë bindëse, duke iu dhënë përgjigje pretendimeve të denoncuesit të bazuara ligjërisht dhe me prova dhe se nuk rezultuan elemente që të kishin cënuar anën procedurale të procesit, ndërsa ligjshmëria e vendimmarrjes lidhur me themelin e çështjes vendoset nga shkallët më të larta gjyqësore, për sa kohë që denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit.

2. Denoncim¹⁰² i shtetases J. B., e cila kishte qenë në cilësinë e këshilltares ligjore të subjektit të rivlerësimit. Ndër të tjera, denoncuesja ankohet për sjellje joetike të treguara nga subjekti në adresë të saj, të cilat sipas ankueses kanë arritur deri në fyerje dhe denigrim të personalitetit. Për këtë, denoncuesja sqaron se i është drejtuar në rrugë zyrtare edhe kryetarit të gjykatës. Denoncuesja bën me dije se për shkak të kësaj situate, për të është krijuar situatë trysnie dhe presion psikologjik dhe, për pasojë, sqaron se po cenohet ushtrimi i detyrës së saj si këshilltare në kushte normale. Kryesisht, bën me dije se gjyqtarja shkruan fjalë fyese mbi aktet e përgatitura prej saj si këshilltare (vendime, projekt-vendime, relacione, etj.). Për këto fakte kishte bërë me dije edhe KLD-në.

¹⁰¹ që parashikojnë respektivisht se: “Vendimet jopërfundimtare janë vendimet e pushimit të çështjes, me të cilët gjykata ose gjyqtari në rastet e parashikuara në këtë kod i japin fund procesit gjyqësor civil pa e zgjidhur çështjen në themel, si edhe çdo vendim tjetër që pa e zgjidhur çështjen në themel i jep fund procedimit gjyqësor të filluar”, dhe “1. Gjykata Administrative jep vendime jopërfundimtare vetëm në rastin e mospranimit të padisë dhe të pushimit të gjykimit”.

¹⁰²Denoncim nr. (***) prot., datë 8.2.2018, në dosjen e Komisionit.

2.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit pas kërkesës së Komisionit për dhënie shpjegime, ndër të tjera, subjekti ka parashtruar se shtetasja J. B., në bazë të urdhrit nr. (***)prot., datë 1.7.2016, të kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit kishte punuar si ndihmëse ligjore pranë saj: me shkresat nr. (***) prot., datë 23.2.2017, nr. (***) prot., datë 23.3.2017 dhe nr. (***)prot., datë 3.4.2017, dhe me shkresën nr(***)prot., datë 1.2.2018, kishte vënë në dijeni Kryetarin e Gjykatës së Apelit Administrativ mbi problemet e reflektuara në punën e ndihmësës ligjore, si dhe lidhur me faktin e braktisjes së detyrës nga ndihmësja ligjore. Në funksion të kërkesave të paraqitura kishte marrë përgjigje me shkresën nr. (***) prot., datë 2.2.2018, nga kancelari, që sipas saj të pakuptuara prej këtij të fundit, për të cilën i ishte dashur t'i drejtohej sërish nëpërmjet shkresës nr. (***)prot., datë 8.2.2018 dhe për dijeni kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë datë sipas subjektit denoncuesja kishte paraqitur denoncimin e saj. Sipas subjektit kjo shtetase në materialin e dorëzuar në Komision do të duhej të kishte dorëzuar edhe projekt-vendimin lidhur me çështjen administrative nr. (***)Akti, datë 12.11.2014, ku pasqyrohej një fjalor joetik¹⁰³ nga denoncuesja kundrejt subjektit, e cila, ndër të tjera, ka referuar disa akte ku vërehen komunikime joetike mes tyre, që sipas subjektit nuk shpjegohej arsyeja përse ndihmësja nuk reagoi në kohë reale, por indinjata së saj kishte ardhur në kohën kur gjyqtari A. M. kishte mbetur pa ndihmës ligjor. Sipas subjektit, denoncuesja përfaqësonte një individ që për shkak të mbështetjes që gëzonte sfidonte çdo institucion dhe për të njëjtat shkaqe ka krijuar bindjen se mënyra si punon dhe komunikon me gjyqtarin është aq e lavdërueshme, saqë i shkakton stres dhe trysni të bërit të vërejtjeve nga persona që ka për detyrë t'i asistojë, pavarësisht se vërejtjet bazohen në konstatime.

Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave, çmon se:

- a) shpjegimet e dhëna nga subjekti duket se referojnë të dhëna që janë pasojë e një marrëdhënieje me problematika në punë, mes saj dhe denoncueses në pozicionin e ndihmësës ligjore;
 - b) faktet e dala nga provat e administruara¹⁰⁴ tregojnë përpjekjet maksimale të subjektit mbi ndërmarrjen prej saj të një sërë veprimesh për adresimin e këtyre problematikave në organet më të larta dhe kompetente për marrjen e masave, duke përmendur këtu edhe vendimin nr. (***) prot., datë 4.12.2018, të inspektimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
- ✓ Në vlerësimin tërësor të rrethanave të paraqitura, trupi gjykues konkludon se pavarësisht rrethanave të krijuara në dukje konfliktuale mes tyre, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe e dëgjoi në seancë dëgjimore, çmon se subjekti, si magjistrate në sistemin e drejtësisë, duhet të evitojë çdo fjalor joetik, pavarësisht rrethanës që e dikton, pasi ajo duhet të demonstrojë sjellje që i shërben figurës së magjistratit.

3. Denoncim¹⁰⁵ i shtetasit H. M., i cili pretendon për zvarritje të procesit gjyqësor për çështje pronësie ku ai ka qenë palë paditëse. Ndër të tjera, denoncuesi ankohet edhe ndaj subjektit të rivlerësimit, nën argumentin se ndërsa ishte në pritje të zhvillimit të procesit në dhomë

¹⁰³ Referojuni shpjegimeve të subjektit, pas kalimit të barrës së provës datë 11.6.2020.

¹⁰⁴ Depozituar nga subjekti në observacionin e saj datë 11.06.2020, lidhur me kriterin profesional.

¹⁰⁵ Denoncim nr. (***) prot., datë 16.7.2018, në dosjen e Komisionit.

këshillimi me relatore subjektin e rivlerësimit kishte mësuar se relatorja kishte hequr dorë nga gjykimi i çështjes. Më tej, nga dokumentet bashkëngjitur denoncimit rezulton se megjithëse kjo kërkesë nuk ishte pranuar nga kryetari i gjykatës, përsëri në seancën e radhës pala e paditur kishte kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga procesi gjyqësor. Denoncuesi, ndër të tjera, ka depozituar dy kërkesa drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, përkatësisht datë 27.4.2018 dhe datë 22.6.2018, me të cilat ka kërkuar zhvillimin e shpejtë të procesit gjyqësor, gjithashtu me dyer të hapura, për shkak të qenies së tij në pritje për t'u gjykuar prej tri vitesh.

3.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit pas kërkesës së Komisionit për dhënie shpjegime, ndër të tjera,¹⁰⁶ subjekti¹⁰⁷ ka parashtruar se pas rishortimit të të gjitha dosjeve të vitit 2016, kjo dosje kishte kaluar te subjekti me shortin e datës 21.4.2016, pasi nuk ka rezultuar që denoncuesi të kishte paraqitur ndonjë kërkesë për zhvillimin e gjykimit me procedurë të përshpejtuar. Lidhur me këtë çështje ishin planifikuar 4 dhoma këshillimi, ku e para, e datës 26.4.2018, ishte shtyrë për shkak të dorëheqjes së kërkuar nga subjekti, për të shmangur çdo dyshim të paditësit mbi paanësinë e saj. Me kërkesat e datave 22.6.2018, 25.6.2018, 26.6.2018 dhe 14.7.2018 denoncuesi kishte pretenduar për mbajtje qëndrim të subjektit kundër pronarëve, ndërkohë që bashkë me urdhrin e datës 10.4.2018 për planifikimin e dhomës së këshillimit, subjekti kishte dorëzuar edhe relacionin e çështjes, me opinionin e saj për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

3.2 Sipas subjektit, duke mos pasur asnjë ndërhyrje lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, pretendimet e ngritura nga denoncuesi i kishin shërbyer këtij të fundit si mjet për të ushtruar presion dhe për të intimiduar relatorin e çështjes, për sa kohë që, ndërsa dy muaj para vendimit mendonte se reputacioni i gjykatës po njollosej nga veprimet e saj, dy muaj pas vendimit shprehet për paanësinë dhe objektivitetin e subjektit në zgjidhjen e çështjes, duke kërkuar që vendimi të lihej në fuqi.

3.3 Në kushtet kur thelbi i denoncimit kishte zvarritjen, subjekti ka parashtruar se para zgjidhjes së çështjes në apel paditësi e kishte akuzuar për zvarritje, ndërsa pas vendimit të Gjykatës së Apelit, pala e paditur e kishte akuzuar gjithashtu për zvarritje, që supozohej sipas denoncuesit/paditësit të kishte ushtruar suksesshëm presion mbi të.

✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit, në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave, çmon se janë bindëse dhe të provuara, sa i takon fakteve për zbatimin e afateve në gjykimin e kësaj çështjeje, si dhe nuk ka rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

4. Denoncim¹⁰⁸ i shtetasit A. L., i cili në cilësinë e administratorit të shoqërisë "L." sh.p.k., me NIPT (***) , ndër të tjera, ankohet për subjektin e rivlerësimit për vendimin nr. (***) , datë 1.3.2018, dhënë në kundërshtim me ligjin mbi prova dhe fakte të pavërteta. Nga aktet bashkëngjitur denoncimit rezulton se ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nr. (***) prot., datë 18.4.2018, në Gjykatën e Lartë. Nga parashtrimet duket se denoncuesi ankohet për themelin e çështjes. Po ashtu, rezulton se çështja aktualisht i është nënshtruar gjykimit të mëtejshëm në shkallët më të larta të gjyqësorit, ndër të tjera, ankohet për subjektin e

¹⁰⁶ Referojuni shpjegimeve të detajuara të subjektit datë 11.6.2020.

¹⁰⁷ Subjekti ka dhënë dorëheqje.

¹⁰⁸ Denoncim nr. (***) prot., datë 27.7.2018, në dosjen e Komisionit.

rivlerësimit, për vendimin nr. (***) , datë 1.3.2018, dhënë në kundërshtim me ligjin, mbi prova dhe fakte të pavërteta. Nga aktet bashkëngjitur denoncimit rezulton se ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nr. (***) prot., datë 18.4.2018, në Gjykatën e Lartë. Nga parashtrimet duket se denoncuesi ankohet për themelin e çështjes. Po ashtu rezulton se çështja, aktualisht, i është nënshtruar gjykimit të mëtejshëm në shkallët më të larta të gjyqësorit.

Gjithashtu, ky denoncues, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “L.” sh.p.k., me NIPT (***) , ndër të tjera ankohet për subjektin e rivlerësimit, për vendimin nr. (***) , datë 1.3.2018, dhënë në kundërshtim me ligjin, mbi prova dhe fakte të pavërteta. Nga aktet bashkëngjitur denoncimit rezulton se ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs me nr. (***) prot., datë 18.4.2018, në Gjykatën e Lartë.

4.1 Subjekti, për këtë denoncim, ka parashtruar se çështja është aktualisht në Gjykatën e Lartë, investuar mbi rekursin e shoqërisë “L.” sh.p.k., kundër këtij vendimi duke bashkëlidhur shpjegimeve të saj edhe vendimin nr. (***) datë 1.3.2018, të Gjykatës së Apelit Administrativ dhe printimin nga faqja e Gjykatës së Lartë.

✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit, vlerëson se ky i fundit ankohet për themelin e çështjes. Po ashtu rezulton se çështja, aktualisht, i është nënshtruar gjykimit të mëtejshëm në shkallët më të larta të gjyqësorit dhe nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

5. Denoncim¹⁰⁹ i shtetases D. Z., e cila ankohet për zvarritje (në kundërshtim me germen “a”, të pikës 1, të nenit 399/2, të Kodit të Procedurës Civile) në gjykim të procesit gjyqësor me relatores subjektin e rivlerësimit. Më konkretisht pretendon se ka kërkuar përsheptimin e gjykimit në Apelin Administrativ, të ankimit datë 19.9.2017, të depozituar lidhur me çështjen gjyqësore administrative përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 18.7.2017, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë (për këtë vendim denoncuesja sqaron se ka depozituar dy ankime me objekte gjykimi të ndryshme, në gjykata të ndryshme, ku njëri prej tyre është rasti i këtij denoncimi). Denoncuesja ka depozituar edhe kërkesën “Për përsheptimin e gjykimit të ankimit”, datë 2.7.2018, drejtuar kryetarit të gjykatës dhe, njëkohësisht, edhe subjektit të rivlerësimit (relatores së çështjes), duke sqaruar gjithashtu në denoncim se vijon zvarritja e pajustificuar e gjykimit të ankimit (bazuar në parashtrimet e denoncueses).

5.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit pas kërkesës së Komisionit për dhënien e shpjegimeve, subjekti ka parashtruar kronologjinë e veprimeve të ndjekura të pretendimeve të denoncueses, të tilla si:

5.1.i Çështja ishte regjistruar në Gjykatën e Apelit Administrativ në datën 19.9.2017 dhe subjekti kishte cilësinë e relatorit.

5.1.ii Në datën 29.10.2018 ishte njohur me shkresën nr. (***) prot., datë 25.10.2018, të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet së cilës ishte informuar se sipas kërkesës datë 22.8.2018, të denoncueses, kërkohej dërgimi i akteve që i bashkëlidheshin kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjykimit.

¹⁰⁹ Denoncim nr(***) prot., datë 29.10.2018, në dosjen e Komisionit.

5.1.iii Lidhur me këtë kërkesë, subjekti ka shpjeguar se me shkresën nr. (***) prot., datë 31.10.2018, kishte informuar Gjykatën e Lartë mbi faktet e lidhura me këtë çështje dhe konkretisht: (a) ngarkesa (në vitin 2018, pasi gjykoheshin çështjet e vitit 2015); (b) mungesa e shkaqeve për shqyrtimin e saj me procedurë të përsheptuar.

5.2. iv Subjekti ka parashtruar se kërkesa datë 22.8.2018 e denoncueses D. Z. (Ç.) ende nuk është shqyrtuar në Gjykatën e Lartë, fakt i konfirmuar me shkresën nr. (***) prot., datë 29.5.2020 (bashkëngjitur). Po në këtë drejtim, subjekti ka depozituar në cilësinë e provës edhe vendimin datë 23.4.2019, të Gjykatës së Lartë, lidhur me ankuesin A. Ç. me të njëjtat argumente, për të cilin Gjykata e Lartë ka disponuar me rrëzimin e kërkesës së tij.

✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit, vlerëson se çështja, aktualisht, i është nënshtruar kërimit në shkallët më të larta të gjyqësorit dhe se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me pretendimet e denoncueses, si dhe nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

6. Denoncim¹¹⁰ i shtetasit V. Q., në cilësinë e administratorit të firmës “F.” sh.p.k., i cili ankohet ndaj vendimit nr. (***), datë 20.9.2018, që i përket palëve ndërgjyqëse: paditës shoqëria “F.” sh.p.k. dhe të paditur KPP-ja dhe Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, etj., me objekt “sigurim i padisë”, etj. Denoncuesi ka depozituar vendimin gjyqësor, ku rezulton se subjekti i rivlerësimit mban cilësinë e anëtarit të trupës gjyqësore dhe, njëkohësisht, ka depozituar edhe rekursin e depozituar ndaj kësaj vendimmarrjeje, pasi me këtë vendim është vendosur ndryshimi i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe, konkretisht, është vendosur rrëzimi i padisë. Në këtë proces gjyqësor, pala paditëse shoqëria “F.” sh.p.k., cilësohet me përfaqësues ligjor denoncuesin. Ndër të tjera, denoncuesi ankohet se përfaqësuesi i personit të tretë, shoqëria “E.” s.r.l., përfaqësuar nga av. O. K., është përfaqësuar në procesin gjyqësor me autorizim datë 10.4.2017, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë z. C. G., i cili sipas dokumentit që ka depozituar denoncuesi dhe atë çfarë citohet në parashtrimet e tij në denoncim, kishte ndërruar jetë që prej datës 22.11.2014.

6.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, pas kërkesës së Komisionit për dhënie shpjegimesh, subjekti ka parashtruar se kishin marrë përgjigje me vendimin nr. (***), datë 20.9.2018, të Gjykatës së Apelit Administrativ, në pikat 31 dhe 32 të këtij vendimi¹¹¹:

✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit vlerëson se, në vendimin e gjykatës administrative, ku subjekti ka qenë pjesë e trupit gjykues, janë verifikuar dhe analizuar pretendimet e denoncuesit, çështja aktualisht i është nënshtruar rekursit, dhe nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

7. Denoncim¹¹² i shtetasit M. G., i cili në ankimin e tij, ndër subjekte të tjerë, denoncon edhe subjektin e rivlerësimit objekt i këtij hetimi administrativ, për zvarritje në gjykim dhe vendimmarrje të padrejtë. Por, subjekti nuk jep të dhëna të sakta të vendimmarrjeve, nuk paraqet asnjë proces gjyqësor konkret, palë ndërgjyqëse, pozitën e tij në procese gjyqësore, etj. Po ashtu, nuk ka bashkëngjitur asnjë dokument provues mbi denoncimin e tij.

¹¹⁰ Denoncim nr. (***) prot., datë 1.11.2018, në dosjen e Komisionit.

¹¹¹ Referojuni shpjegimeve të subjektit në parashtrimet e dërguara në datën 11.6.2020.

¹¹² Denoncim nr. (***) prot., datë 21.3.2019, në dosjen e Komisionit.

- ✓ Në kushte të tilla, trupi gjykues ka vlerësuar se në nivelin që është depozituar dhe parashtruar ankimi, nuk përmbush elementët e një shqyrtimi të mëtejshëm dhe, për pasojë, nuk bëhet pjesë e vlerësimit të kriterit profesional.

8. Denoncim¹¹³ i shtetasit P. R., i cili në ankimet e tij ankohet për zvarritje të gjykimit prej 3 vite e gjysmë të çështjes administrative në Apelin Administrativ, duke identifikuar si të dhëna në ankimin e tij, vendimin nr. (***) të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, që i përket dosjes nr. akti (***) dhe, njëkohësisht, pretendon edhe për paaftësi.

8.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, pas kërkesës së Komisionit për dhënie shpjegimesh, subjekti ka parashtruar¹¹⁴ një analizë ligjore dhe faktike të arsyetuar edhe në vendimin përkatës.

- ✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit në raport me shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë të lidhura tërësisht me themelin e çështjes, e cila aktualisht ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, si dhe nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

9. Denoncim¹¹⁵ i shtetasit H. T., i cili në të katër denoncimet e tij prezanton të njëjtat shkelje për subjektin e rivlerësimit, në drejtim të vendimmarrjeve të padrejta dhe të paligjshme duke bërë kompromis me Bashkinë Tiranë. Denoncuesi ka depozituar, bashkëngjitur denoncimit, disa kërkesa ankimore në adresë të institucioneve publike, vendimin gjyqësor nr(***) datë 15.3.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku identifikohet në cilësinë e palës paditëse kundër Bashkisë Tiranë, me objekt detyrimin e palës së paditur të trajtojë paditësin me programin e strehimit “banesa sociale”, vendim i cili është rrëzuar. Po ashtu, ka depozituar edhe regjistrimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, nga ku rezulton se relator i çështjes nuk është subjekti i rivlerësimit. Në kushte të tilla, megjithëse denoncuesi kishte përfshirë në denoncim edhe subjektin e rivlerësimit, roli i këtij të fundit (p.sh., me cilësinë e anëtarit të trupës) nuk pasqyrohet në asnjë prej dokumenteve të depozituara.

9.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, pas kërkesës së Komisionit për dhënie shpjegimesh, subjekti ka parashtruar¹¹⁶ se për këtë çështje me paditës shtetasin H. T., Gjykata Administrative e Apelit, në trup gjykues të përbërë nga relatore L. S., anëtare Blerona Hasa dhe R. S., kishte disponuar vendimin nr. (***) datë 14.11.2019, që kishte lënë në fuqi vendimin nr. (***) datë 15.3.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti ka parashtruar analizën ligjore dhe faktike të çështjes objekt gjykimi, të arsyetuar edhe në vendimin përkatës, që duken se lidhen me themelin e çështjes. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë nuk ka të dhëna të regjistruara për këtë dosje.

- ✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit në raport me shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë të lidhura tërësisht me themelin e çështjes, si dhe nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

¹¹³ Denoncim nr. (***) prot., datë 17.6.2019 dhe (***) prot., datë 17.6.2019, në dosjen e Komisionit.

¹¹⁴ Referojuni parashtrimeve ligjore të subjektit.

¹¹⁵ Denoncimet nr. (***) prot., datë 20.11.2019; nr. (***) prot., datë 25.11.2019; nr. (***) prot., datë 4.12.2019; nr. (***) prot., datë 9.1.2010, në dosjen e Komisionit.

¹¹⁶ Referojuni parashtrimeve ligjore të subjektit, datë 11.6.2020.

10. Denoncim¹¹⁷ i shtetases V. V., në KLSH, në të cilin denoncuesja parashtron se Kontrolli i Lartë i Shtetit, i vënë në lëvizje nga ankesa e saj, që më parë e kishte depozituar edhe në Ministrinë e Drejtësisë, ka adresuar çështjen në Komision, i orientuar nga kjo e fundit (MD). Kjo shtetase, ndër të tjera, ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë prej dy vitesh, në lidhje me të drejtën e pronësisë së një hoteli në zonën “Uji i ftohtë” Vlorë, megjithëse ka paraqitur kërkesë për përsheptimin e gjykimit për arsye madhore të gjendjes shëndetësore të vajzës së saj. Nga aktet bashkëngjitur denoncimit konstatohet i depozituar vendimi gjyqësor nr. (***) , datë 7.12.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, vendim i cili nuk konfirmohet se ka marrë formë të prerë. Në këto kushte, pa paragjykuar rastin, por duke marrë në konsideratë se denoncuesja ka drejtuar disa ankesa në disa institucione të ndryshme, si dhe duke parë që ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor, çmon të investohet lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor të ezauruar me vendimin gjyqësor të sipërcituar, me palë ndërgjyqëse paditësin E. V., të paditurin D. S., etj., me objekt deklarimin e falsifikuar të dokumentit “akt i marrjes së tokës në pronësi”, si dhe “konstatimin e pavlefshmërisë absolute të AMTP-së nr. (***) , lëshuar nga Bashkia Vlorë.”

10.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, pas kërkesës së Komisionit për dhënie shpjegimesh, subjekti ka parashtruar se shtetasja V. V. nuk kishte gëzuar cilësinë e palës ndërgjyqëse në këtë çështje. Për këtë shkak, kërkesat për përsheptim gjykimi nga një person që nuk gëzonte cilësinë e palës ndërgjyqëse, nuk ishin pranuar. Subjekti ka parashtruar edhe rendin kronologjik, që kishte ndjekur kjo çështje në raport me datën e regjistrimit, i cili kishte përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 18.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke depozituar edhe kopje të tij.

✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit në raport me shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

11. Denoncim¹¹⁸ i shtetasit R. K. me cilësinë e të interesuarit (sipas pretendimit të tij si zotërues i ½ i kuotave të shoqërisë “I. A.” sh.p.k. Marikaj, Vlorë,) për procesin gjyqësor të zhvilluar, të përfunduar në Gjykatën Administrative të Apelit, me vendimin nr. (***) , datë 28.3.2019 (çështje e regjistruar në datën 30.1.2018), ankohet se procesi gjyqësor është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit me cilësinë e relatores, jashtë radhe, ndërsa në maj kjo gjyqtare po gjykonte çështjet e muajit shkurt 2016. Po ashtu, denoncuesi ankohet se ka paraqitur një kërkesë në datën 18.3.2018 që çështja të kthehej për rigjykim dhe, më tej, të kishin mundësinë e përfshirjes në procesin gjyqësor si palë ndërgjyqëse, ndërsa bëhen me dije mbi vendimmarrjen vetëm pasi konstatohet në korrik të vitit 2019, në ekstraktin e shoqërisë “I. & B.” sh.p.k., sot shoqëria “I. A.” sh.p.k., se ishte depozituar, pikërisht, vendimi gjyqësor i sipërcituar.

11.1 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, pas kërkesës së Komisionit për dhënie shpjegimesh, subjekti ka parashtruar rendin kronologjik që kishte ndjekur kjo çështje, ku konstatohet se fillimisht me kërkesëpadinë e paditësit “I.& B.” sh.p.k., kundër të paditurit Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ishte investuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 26.9.2012 dhe pasi

¹¹⁷ Denoncim nr. (***) prot., datë 18.12.2019, në dosjen e Komisionit.

¹¹⁸ Denoncim nr. (***) prot., datë 16.1.2010, në dosjen e Komisionit.

janë ndjekur në shkallët e tjera duke disponuar vendimet përkatëse dhe, konkretisht: (1) vendimi nr. (***) datë 11.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (2) vendimi nr. (***), datë 28.1.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; (3) vendimi nr. (***) datë 21.11.2017, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në datën 30.1.2018 çështja ishte regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit. Pala paditëse ka rezultuar se në datën 13.2.2019 kishte dorëzuar kërkesën nr. (***) prot., datë 13.2.2019 me objekt “përshpejtim i gjykimit”, e cila ishte marrë në konsideratë dhe, në përfundim, Gjykata Administrative e Apelit ka disponuar me vendimin nr. (***), datë 28.3.2019.

11.2 Sipas subjektit, Këshilli i Lartë Gjyqësor rezulton të ketë disponuar dy muaj më pas vendimin nr. (***), datë 30.5.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, duke parashikuar rregullat¹¹⁹ për përshpejtimet e shqyrtimeve të çështjeve, ku ishte përcaktuar edhe rregulli për çështje, për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin/dërgimin për rigjykim në Gjykatën e Apelit, sikurse ishte rasti për të cilin denoncon shtetasi R. K. . Subjekti ka parashtruar edhe analizën ligjore dhe faktike të çështjes objekt gjykimi, të arsyetuara edhe në vendimin përkatës.

- ✓ Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit në raport me shpjegimet e subjektit, vlerëson se në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, ku subjekti ka qenë pjesë e trupit gjykues, i janë dhënë përgjigje pretendimeve të denoncuesit, pra i gjen ato të arsyetuara edhe në vendim dhe, për rrjedhojë, çmon se nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues i Komisionit

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, në shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Blerona Hasa:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cënuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

¹¹⁹ “Kreu II. Përshpejtimi i shqyrtimit të çështjes mbi kërkesë të palëve, për shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes ose për shkaqe, veçanërisht, të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin. 1. Shqyrtimi i një çështjeje, për të cilën Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë nuk ka përcaktuar afat për gjykimin e saj, mund të përshpejtohet vetëm mbi kërkesë të palëve, për shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes ose për shkaqe, veçanërisht, të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin. 3.2 Çështje të tilla, sipas kategorisë, janë: (a) çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin/dërgimin për rigjykim në Gjykatën e Apelit”.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/a të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel të arrirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 27.7.2020.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Olsi KOMICI

Kryesues

Brunilda BEKTESHI

Relatore

Xhensila PINE

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Denisa Kosta